

**MUHAM'MEDI,
I DËRGUARI I ALLAHUT
(JETËSHKRIM)**

Titulli i librit: *Muham'medi, i Dërguari i Allahut (Jetëshkrim)*

Autori: *Sej'jid Hàshim El-Mùsauij*

E përktheu nga arabishtja: *Haxhi Selim STAFA*

E redaktoi: *Hajri Shebu*

Korrektura teknike: *Rudina Iela*

Kapaku: *T.Chorbani*

Përkujdesja grafike: *Kozeta Laperi*

E botoi: *Fondacioni i Kur'anit*

ISBN:

PARATHËNIA

Duke mbështetur dëshirën e theksuar të shumë institucioneve, qendrave dhe shkollave islame të disa vendeve të botës islame për botimin e një serie librash fetarë mësimorë, në ndihmë të nxënësve myslimanë, për edukimin dhe për pajisjen e tyre me kulturën e mirëfilltë islame, u vendos përgatitja e një programi mësimor për të tria kategoritë e shkollave (fillore, unike dhe të mesme). Shpresojmë të kemi përputhje mendimesh me vëllezërit tanë mësues e me motrat tona mësuese për zbatimin e këtij programi me përpikëri, si dhe për orientimin e nxënësve në atë çka është më e mirë dhe më e dobishme për ta. Luten të gjithë mësuesit të na shkruajnë për çdo vërejtje a kritikë konstruktive që mund të kenë dhe të japin ndihmesën e tyre të vyer në pasurimin e në zhvillimin e kësaj përvoje. Lusim Krijuesin e lartësuar ta bëjë mbarë botimin e librave të tjerë të kësaj serie në një kohë sa më të afërt, sepse vetëm Allahu është miku e ndihmuesi më i mirë.

Botuesi

*Organizata e Informacionit Islam
në
Republikën Islamike të Iranit*

PËRSE E STUDIOJMË JETËSHKRIMIN E PROFETIT [a.s]

«Ju keni shembullin më të bukur në të Dërguarin e Allahut, për atë që shpreson shpërblimin e Allahut, (beson) në Botën tjetër dhe e përmend shumë Allahun.»
(“El Abzàb”,21).

Jetëshkrimi i Profetit [a.s.] (es’sijretun nebuijeh) është rruga e tij në jetë, ose historia e jetës së tij.Studimi i jetëshkrimit të Profetit [a.s.] dhe njohja me jetën e tij, me sjelljet e tij, si ka bashkëvepruar ai me ithtarët e tij, me familjen e tij (Ehli Bejtin), me armiqtë e tij, mënyra si e ka bërë ai thirrjen islame, si dhe njohja me mënyrat e rrugët që ai ndoqi - të gjitha këto janë burimi ku mësojmë fenë tonë dhe Sheriatin e fesë sonë.Jetëshkrimi i Profetit [a.s.] është burim themelor për të nxjerrje dispozitat dhe ligjet e Islamit. Nga jetëshkrimi i tij juristët e fesë nxjerrin të gjitha dispozitat e ligjet që sistemojnë jetën tonë personale dhe shoqërore.Studimi i jetëshkrimit të të Dërguarit [a.s.] do të thotë studim i pjesës më të rëndësishme të bashkësisë sonë në veçanti dhe i të gjithë njerëzimit në përgjithësi, sepse jeta e tij është udhëzimi në rrugën e drejtë, kundër shkarjes në rrugën e humbjes, sepse ajo është e vërteta kundër së gabuarës.

Nga jetëshkrimi i Profetit [a.s.] mësojmë se thirrja islame filloi e dobët, për shkak se pasuesit e të Dërguarit të Allahut ishin të varfrit e të pafuqishmit, ishin ata që nuk kishin mbrojtje, nga jetëshkrimi i tij mësojmë gjithashtu, se si triumfoi e vërteta dhe si u përhap udhëzimi për në rrugën e drejtë.

Nga jetëshkrimi i të Dërguarit [a.s.]:

1. Njihemi me madhësinë e të Dërguarit të nderuar; ër këtë flasin veprimet e tij, qëndrimet që ai mbajti dhe gjurmët të tij pashlyeshme që la; për pasojë, na shtohet dashuria ndaj e tij e ndaj thirrjes së tij të bekuar, e kështu, ndjekim shembullin e tij dhe ecim në hullinë e udhëzimit të tij për në rrugën e drejtë.

2. Mësojmë se ai është ndër burimet e dispozitave të Islamit, se juristët e fesë nxjerrin dispozitat e ligjet që kanë të bëjnë me anë të ndryshme të jetës fetare, politike, ushtarake, ekonomike, rituale etj, duke u mbështetur gjithnjë në fjalën e të Lartit: «...**ka ju urdhëron Profeti, zbatojeni dhe hiqni dorë nga ajo që ai ju ndalon ...**» (“El Hashr”, 7) Dhe: «**Ai nuk flet nga mendja e tij.**» Dhe: «**Ai (Kur’ani) është vetëm Zbulesa që i shpallet**» (“En’Nexhm”, 3-7).

3. Mësojmë historinë e thirrjes islame e të myslimanëve të parë, si duruan e luftuan ata, si patën fuqinë që të arrinin fitoren. Këto mësimë i kemi model për t’i ndjekur.

4. Mësojmë rrugët e thirrjes islame, mënyrën e kumtimit të saj dhe se si arriti kjo thirrje tek të gjithë njerëzit.

5. Mësojmë se si zbatohet Islami, si ndërtohet shoqëria islame dhe shteti islam, që edhe ne të ndërtojmë sistemin tonë shoqëror mbi bazat e islamit, duke marrë si shembull shtetin e pavdekshëm të të Dërguarit të Allahut.

Jetëshkrimi i të Dërguarit [a.s.] është pasuria më e vyer në historinë tonë islame dhe në historinë e mbarë njerëzimit, sepse Profeti [a.s.] dha përgëzimin me mesazhin e Allahut për shpëtimin e njerëzisë dhe për shkatërrimin idhujve, sepse zhdukuri padijen, mohimin, varfërinë, sëmundjet dhe shkatërrimet e ngatërresat. Për të gjitha këto, studimi i jetës së këtij njeriu të madh na ndihmon të përmirësohemi, shpirtërisht e fizikisht, na qartëson rrugën e vërtetë dhe na mëson parimet madhështore të Islamit. Për të gjitha këto, Kur’ani na urdhëron që të kemi si shembull të Dërguarin [a.s.] dhe të marrim prej tij çdo gjë me të ciliën ai erdhi te ne dhe që e kumtoi për ne, sepse vetëm kështu do të kemi mundësi të jemi myslimanë të dobishëm, që ndërmarrim përmirësime, kryejmë transformime e luftojmë ngatërresat e shkatërrimet, sipas shembullit të përmirësuesit më të madh, Muham’medit [a.s.]. Kjo është rruga për të triumfuar mbi mohimin e padrejtësinë dhe për ta çliruar njeriun prej skllavërisë së idhujve e të shtypësve.

GJENDJA E BOTËS PARA ARDHJES SË TË DËRGUARIT TË NDERUAR[a.s.]

Allahu e dërgoi Profetin tone, Muham’medin [a.s.] për t’i shpëtuar të gjithë njerëzit prej padijes, padrejtësisë, mohimit dhe shkatërrimit e ngatërresave, për t’i përmirësuar punët e njerëzve dhe për t’i udhëzuar ata në Rrugën e drejtë. Profeti ynë u dërgua afërsisht pas më shumë se pesë shekujve të mbarimit të

profetnisë së Mesijhut, Ijsàit, birit të Merjemes [a.s.]. Muham'medi [a.s.] u dërgua profet në Mek'kën e nderuar, në Gadishullin Arabik. Në atë kohë, arabët jetonin në padije dhe bënë jetë endacake, të mbushur me ngatërresa, padrejtësi e prapambetje. Padija është shprehje e mohimit të fjalës së Allahut e të ligjit të fesë së Tij, është ndjekja e idhujve dhe ligjeve që janë në kundërshtim me ligjin e drejtë të Allahut.

Kjo ishte gjendja në të cilën jetonin popujt që kishin shkarë në rrugën e humbjes, ashtu siç jetojnë edhe në kohën e sotme disa popuj në rrugën e humbjes. Është njeri që nuk beson në fenë e Allahut dhe nuk zbaton ligjin e Tij të drejtë, është bartës i mendësisë së kohës së padijes. Jeta e kohës së padijes sundonte në mbarë njerëzimin dhe jo vetëm në Gadishullin Arabik; në atë gjendje ishin edhe trevat e Persisë, vendet e Bizantit dhe vende të tjera të botës.

Arabët adhuronin idhujt prej guri, prej metali ose prej druri që ata vetë i punonin me duart e tyre. Me të atillë idhuj ata kishin mbushur Qaben; numri i idhujve të vendosur në Qabe kishte arritur në treqind e gjashtëdhjetë. Ndër idhujt më të përmendur të arabëve ishin: Uzzà, Lât, Hubel dhe Menât. Është ditë, njerëzit vinin të kryenin vizitën e adhurimit ndaj atyre idhujve dhe u sillnin atyre të taksura e flijime, duke besuar se i afronin pranë Allahut dhe u plotësonin nevojat që kishin. Disa nga arabët adhuronin xhindet e melekët dhe nuk adhuronin Allahun; një pakicë prej tyre vazhdonin në fenë e Ibrahimit e të Ijsàit – paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi ata të dy! Në jetën e arabëve të asaj kohe ishin të përhapur padija, analfabetizmi dhe shkarja në rrugën e humbjes; ndër ta nuk kishte as dituri e as njoftime të vërteta; ata që dinin shkrim e lexim ishin shumë pak; për më tepër, ata sulmonin njëri-tjetrin; i fuqishmi sulmonte të pafuqishmin; luftërat, gjakderdhja, vjedhjet dhe grabitja e pasurive ishin gjëra të zakonshme ndër ta. Shoqëria e Mekkes përbëhej prej dy klasave: klasa e zotërinjve të pasur dhe klasa e të varfërve dhe e skllëvërve, të dhunuar nga padrejtësitë.

Nga varfëria e tejskajshme, arabët vrisnin edhe fëmijët e vet. Ata i varrosnin të gjalla vajzat e tyre të vogla, nga frika se mos ato binin robëresha në luftë dhe se mos i njollosnin me turp.

Kur'ani Kerimi e përshkruan gjendjen e tyre me këto fjalë: «**Le të adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie**». «**I Cili i ushqeui ata pas urisë dhe i siguroi ata prej çdo frike**» (“Kurejsh”, 3-4); dhe: «**Dhe kur të pyeten vajzat e varrosura për së gjalli**» «**Për çfarë mëkati janë vrrarë**» (“Et Tekvijr”, 8-9); dhe: «**Dhe mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, Ne ju japim ushqim juve dhe atyre...**» (“El Isràë”, 31).

Xha'fer bin Ebij Tàlibi
përshkruan gjendjen para Islamit

Xha'fer bin Ebi Tàlibi, kreu i mërgimtarëve në Abisini, kur u pyet prej mbretit të Abisinisë për ithtarët e të Dërguarit të nderuar, ai i përshkroi gjendjen e padijes me këto fjalë:

«O mbret, ne jemi një komb i paditur që adhurojmë idhujt, hamë coftina, mëkatojmë sheshit dhe fshehtas, presim marrëdhëniet me njerëzit e gjakut, i bëjmë keq fqinjët, i fuqishmi ynë ha të pafuqishmin; të tillë ishim ne derisa Allahu çoi ndër ne një të dërguar prej njerëzve tanë, të cilit ia njohim trungun e familjes, njohim drejtësinë, besnikërinë e nderin e tij; ai na bëri thirrje të besojmë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, të adhurojmë vetëm Allahun dhe të heqim dorë njëherë e përgjithmonë nga gurët e shtatoreve që adhuronim ne e të parët tanë, përveç Allahut; ai na urdhëroi të themi vetëm të vërtetën; ai na ndaloi nga mëkatet e punët e këqija që bëhen hapur e fshehtas; ai na urdhëroi ta dorëzojmë gjënë e lënë në mirëbesim, të mbajmë lidhje me njerëzit e gjakut e të shkojmë mirë me fqinjët, të heqim dorë nga veprimet e ndaluara dhe gjakderdhja; ai na ndaloi punët e liga, fjalën rrenë, ngrënien e pasurisë së jetimit, sharjen në nder të grave të ndershme; ai na urdhëroi të adhurojmë vetëm Allahun dhe të mos i bëjmë Atij shok në adhurim askënd e asgjë; ai na urdhëroi të falim namaz, të japim zeqat dhe të agjërojmë... dhe ne e vërtetësuam atë, i besuam atij dhe e pasuam atë në atë me të cilën ai kishte ardhur te ne prej Allahut; prandaj adhuroam vetëm Allahun pa i bërë Atij shok në adhurim askënd e asgjë, ne e kemi të ndaluar atë që është e ndaluar për ne dhe e kemi të lejuar atë që është e lejuar për ne...» (Ibni Hishàm, "Es'sijretu-n'nebenij'jeh", vëll. 1, f. 361).

Ligjërata e Xha'fer bin Ebi Tàlibit, si dhe përshkrimi që ai i bëri gjendjes së arabëve të kohës para Islamit shpjegon fare qartë për ne se si i Dërguari i Allahut i shpëtoi e i udhëzoi ata në rrugën e drejtë të moraleve më të larta dhe se ai erdhi tek ata me besimin monoteist, për të adhuruar vetëm Allahun, Zotin Një e të Vetëm, se ai erdhi me ligjin e Allahut dhe i çliroi njerëzit prej skllavërisë së idhujve, prej padijes e prej adhurimit të shtatoreve dhe prej atyre ai formoi një popull të fuqishëm e besimtar në Allahun, të përparuar në shkencë, në dituri dhe në qytetërim, formoi një popull që mbajti barrën e thirrjes islame, përhapri kulturën islame në mbarë botën dhe i udhëzoi njerëzit në rrugën e besimit të vërtetë e të përparimit. I Dërguari i Allahut, Muham'medi [a.s.] e shpëtoi të gjithë njerëzimin nga errësirat dhe e nxori atë në dritë. Mësuam se arabët ishin idhujtarë, adhures të idhujve, kurse në Persi njerëzit ishin mexhusë, adhures të zjarrit, ndërsa rumët (bizantinët) në trevat e Shamit ishin të krishterë, por që e kishin revizionuar Ungjillin, e kishin tjetërsuar ligjin e fesë me të cilën kishte ardhur Mesijhu dhe ishin bërë idhujtarë, sepse besonin se Mesijhu ishte bir i Zotit, e në shoqërinë e tyre ishin shtuar shumë shkatërrimet, ngatërresat dhe degjenerimi. Jehudët, nga ana e tyre kishin revizionuar Teuràtin dhe e kishin tjetërsuar e devijuar ligjin e fesë së Mùsàit [a.s.], i bënë shok Allahut në adhurim dhe thoshin se Uzejri ishte bir i Allahut; në mesin e tyre kishin marrë përhapje të gjerë krimi, shkatërrimi, ngatërresat,

akaparimi i parave dhe veset më të liga. Kështu njerëzit jetonin në batakun e mohimit, të idhujtarisë, të padijes, të shkatërrimeve, të padrejtësisë, të varfërisë, të luftimeve, të shpifjeve e të ngatërresave. Njerëzit jetonin në prapambetje dhe në mundime të mëdha, duke pritur shpëtuesin për një jetë të lumtur e të sigurt. Në këto kushte, Allahu i lartësuar e ngarkoi Muha'medin [a.s.] me detyrën e profetnisë dhe e çoi atë mëshirë për të gjitha botët.

Allahu thotë në librin e Tij të lavdishëm: «**Ne të dërguam ty mëshirë për të gjitha botët**» ("El Enbijà", 107). Prandaj njerëzit e kanë detyrë të falënderojnë për këtë mirësi dhe të ndjekin fenë e këtij Profeti madhështor, që të jetojnë në mirësi e në paqë.

Përmbledhje

Tani le të bëjmë një përmbledhje rreth gjendjes së njerëzimit para se Muham'medi [a.s.] të ngarkohej me detyrën e profetnisë:

1. Në Gadishullin Arabik dhe në vende të tjera të botës njerëzit adhuronin idhujt, shtatoret, zjarrin, xhindet, melekët etj.

2. Shpalljet me të cilat erdhën profetët (Teurati e Ungjilli), si dhe libra të tjerë ishin revizionuar prej dijetarëve jehudë e të krishterë; për më tepër, ata i bënë Allahut të lartësuar shok në adhurim.

3. Degjenerimi moral në përmasa të mëdha dhe veset si vjedhja, gënjeshtria, batakçillëku, padrejtësia, vrasjet, agresioni, frika, pirja e verës, bixhozi, kriminaliteti, urrejtja, armiqësia etj. kishin marrë përhapje shumë të gjerë.

4. Ishte shumë e përhapur padija, analfabetizmi dhe varfëria.

5. Në trevat arabe nuk kishte as sistem, as ligj e as shtet që të sundonte dhe ata jetonin në anarki, bënë jetën e barinjve endacakë, duke u shpërnguluar nga një vend në tjetrin.

6. Islami shembi përfundimisht mizorinë, idhujt, adhurimin e shtatoreve, e udhëzoi dhe e udhëhoqi njerëzimin në rrugën e diturisë, të përparimit, përhapjes së drejtësisë e të mëshirës ndër të gjithë njerëzit.

PROFETI YNË MUHAM'MEDI [a.s.]

Trungu gjenealogjik dhe lindja e tij

Ai është Muham'med bin Abdullah, bin Abdul-Mut'talib, bin Hàshim, bin Abdi Menàf, bin Kusaj, bin Kilàb, bin Murr'rreh, bin Ka'b, bin Luej, bin Gàlib, bin Màlik, bin Nadr, bin Kenàneh, bin Khuzejmeh, bin Mudrekeh, bin Nizàr. Trungu i tij gjenealogjik arrin deri te pasardhësit e profetit Ismail [a.s.] dhe Profeti Muham'med [a.s.] është nga fisi Kurejsh. Nëna e tij quhet òmine binti Vehb, bin Abdi Menàf, bin Zehreh, bin Kilàb. Edhe ajo është nga fisi Kurejsh. Muham'medi [a.s.] është lindur në Mek'kë në Vitin e Elefantit, vit në të cilin abisinasi Ebrehe erdhi për të shembur Qaben, hipur mbi një elefant; ai qe komandanti i asaj ushtrie, të cilën Allahu e shkatërroi dhe kështu shpëtoi Qaben prej së keqes dhe agresivitetit të tij. Në këtë vit, pesëdhjetë net para sulmit të ushtrisë së elefantit, lindi Profeti ynë, Muham'medi [a.s.], më 12 ose 17 të muajit Rebi'ul-eu'uel, në kohë mëngjesi, në shtëpinë e babës së tij, e cila ndodhet në një zonë të Mek'kës që quhet "Shuabi Ebij Tàlib". Babai i tij kishte ndërruar jetë në Medinen e ndritur tek dajat e tij, të fisit Beni Nexh'xhàr, qysh kur Profeti [a.s.] ishte gjashtë muajsh në barkun e së ëmës; por ka edhe thënie që njoftojnë se Profeti [a.s.] ka lindur para se të vdiste baba i tij.⁽¹⁾

Për lindjen e profetit tonë, Muham'medit [a.s.] u gëzua shumë gjyshi i tij i nderuar e bujar, Abdul-Mut'talib bin Hàshim,

(1) El Ja'kùbij'ju ka thënë se i Dërguari [a.s.] është lindur pas vdekjes së babait të tij; kurse edhe Et'Tabresij'ju ka përmendur në librin e tij "A'làmul-

uerà” se babai i të Dërguarit [a.s.] ka vdekur dy vjet e katër muaj pas lindjes së Profetit [a.s.].

i cili ishte nga zotëritë e kurejshëve e kryetar i tyre dhe ndiqte fenë e Ibràhimit, mikut të Allahut. Me rastin e lindjes së këtij djali, gjyshi i nderuar theri shumë bagëti, bëri gosti dhe ftoi shumë njerëz; natyrisht, edhe njerëzit e uronin gjyshin për të lindurin e ri. Nëna e Profetit Muham’med [a.s.], ‘mine bint Vehb, kur po lindte Profeti [a.s.], ka parë me sytë e saj një dritë të fortë që i mbushi gjithë shtëpinë. Nga mrekullitë e lindjes së tij [a.s.] është edhe fakti se kur ka lindur ai, është lëkundur froni i Kîrsasë, mbretit të persëve dhe mbi atë fron janë rrëzuar njëzet e katër ballkone; është shuar gjithashtu zjarri i mexhusëve, zjarradhuruesve, që mbahej i ndezur vazhdimisht qysh prej një mijë vjetësh.

Rritja e Profetit [a.s.]

Kur u lind Profeti ynë [a.s.], i ka dhënë gjyshi Thuvejbeja, e cila ishte skllave e xhaxhait të tij, Ebù Lehebit. Po kjo skllave kishte ushqyer me gjyshi edhe xhaxhanë e Profetit [a.s.], Hamza bin Abdul Mut’talibin, si dhe djalin e xhaxhait të tij Xha’fer bin Ebij Tàlibin. Paria e kurejshëve e kishin zakonin që pas lindjes, i çonin fëmijët e tyre ndër banorët e shkretëtirës, që të rriteshin atje. Kështu u veprua edhe me Profetin tonë [a.s.]; gjyshi i tij e la në dorën e një banoreje të shkretëtirës, e cila quhej Halijme Es’Sa’dijeh që ta ushqente me gjyshi, ta rriste e të kujdesej për të.

Kur erdhi ky fëmijë i bekuar, njerëzit e shtëpisë së Halimesë panë mbushulli të madhe (bollëk) në bagëtitë e tyre; bagëtitë u shëndoshën dhe e shtuan qumështin e pjellorinë. Kur Profeti [a.s.] u bë pesë vjeç, e kthyen pranë gjyshit të tij, Abdul Mut’talibit dhe nënës së tij, ‘mine binti Uehb. E ëma u gëzua pa masë dhe vendosi që ta merrte me vete në udhëtimin që do të bënte për në Jethrib (Medinë), për të vizituar dajat e saj, te fisit Beni Adij bin Nexh’xhàr. Në këtë kohë, Profeti [a.s.] ishte gjashtë vjeç. Këtu, Profeti [a.s.] ka mësuar të notojë në një pellg të Beni Adijve. Nëna dhe djali shoqëroheshin nga një grua abisinase, që quhej Umm Ejmen Bereke, e cila u shërbente në këtë udhëtim të gjatë. Pasi qëndroi në Jethrib tre muaj, ‘mineja u nis të kthehej në Mek’kë së bashku me djalin e saj të shtrenjtë e shumë të dashur, Muham’medin [a.s.], gjithnjë e shoqëruar prej shërbyeses Umm Ejmeni. Gjatë rrugës për në Mek’kë, mu në fshatin Ebuà, nëna e të Dërguarit të Allahut, ‘mineja u sëmur e ndërroi jetë dhe po në këtë fshat është varrosur, ku është varri i saj edhe sot e kësaj dite.⁽¹⁾ Um’m Ejmeni u kthye me djalin te gjyshi Abdul Mut’talib bin Hàshim, i cili e priti djalin me dashuri, e përkëdheli përzemërsisht dhe mori përsipër rritjen dhe edukimin e tij e të gjitha përkujdesjet që kërkon rritja e një fëmije. Kur Profeti [a.s.] mbushi tetë vjeç, vdiq edhe gjyshi i tij, Abdul-

Mut'talibi. Para se të vdiste, Abdul-Mut'talibi porositi djalën e vet, Ebû Talibin, xhaxhanë e Profetit [a.s.] që të kujdesej për Muham'medin, ta rriste, ta mbronte e ta ruante atë. Ebû Tàlibi e pranoi këtë detyrë dhe kështu, ai e mori Profetin [a.s.] në shtëpinë e vet. Në shtëpinë e xhaxhait, Profeti [a.s.] u rrethua jo vetëm nga kujdesi i tij, por edhe nga ngrohtësia e bashkëshortes së xhaxhait, Fatime binti Esed; ajo që për Profetin [a.s.] njënjë shumë e dhembshur, e ruante dhe kujdesej për të më shumë se për fëmijët e saj. Vetë i Dërguari i Allahut [a.s.] ka thënë: «Fatime binti Esed është nëna ime.» Për këtë dhembshuri që ai kishte ndaj saj, Profeti [a.s.] ka qarë shumë dhe është hidhëruar pa masë kur vdiq Fatime binti Esed, megjithëse Profeti në këtë kohë ishte burrë i pjekur e i ngarkuar me detyrën e profetnisë. Kur njerëzit e pyesnin për hidhërimin e madh që kishte për vdekjen e Fatime binti Esedit, i Dërguari [a.s.] thoshte:

(1) Kur i Dërguari erdhi në moshë madhore dhe kur Allahu e ngarkoi me detyrën e profetnisë, i kërkoi lejë Krijuesit të Madhëruar dhe Ai e lejoi që të vizitonte varrin e së ëmës; ka qëndruar ndenjor pranë varrit dhe ka qarë gjatë; së bashku me Profetin [a.s.] kanë qarë shumë edhe shokët që ishin me të. Këtë na e përcjell Muslimi në “Sahijhun” e tij, cituar prej Et’Tabresijit në librin “A’lâmul-uerâ”.

«Sot vdiq nëna ime, ajo me të vërtetë, ishte nëna ime; kur fëmijët e saj ishin të uritur, ajo më ngopte mua, nuk i krihte ata, por më krihte mua e më parfumonte kokën, ajo ishte nëna ime.»⁽¹⁾ Profeti ynë, Muham'medi [a.s.] jetoi në shtëpinë e xhaxhait, Ebû Tàlibit dhe të Fatime binti Esed derisa u martua me të madhen Hadixhe binti Khuuejlid (r.a.).

Përmbledhje

1. Profeti ynë [a.s.] u lind në Mek'kën e nderuar në Vitin e Elefantit, më 17, ose 12 të muajit Rebi'ul-Eu'uel.

2. Babai i tij është Abdullah bin Abdul-Mut'talib, i cili ka vdekur para se të lindte Profeti [a.s.].

3. Nëna e tij është ãmine binti Uehb. Ajo ka ndërruar jetë kur Profeti [a.s.] ishte gjashtë vjeç.

4. Gyshi i tij, sipas zakonis që kishte paria e kurejshëve, ia dorëzoi Profetin [a.s.] Halijme Es'Sa'dijes, që ta ushqente me qumësht gjiri dhe ta rriste në mjedisin e shkretëtirës. Gjyshi i Profetit [a.s.] Abdul Mut'talib bin Hâshim ka ndërruar jetë kur Profeti [a.s.] ishte tetë vjeç. Pas vdekjes së Abdul Mut'talibit, Profetin [a.s.] e mori nën kujdestari xhaxhai i tij, Ebû Tàlibi. Profeti [a.s.] ka qëndrur nën kujdesjen e xhaxhait e të gruas së tij, Fatime binti Esed derisa u martua.

5. Nga mrekullitë e lindjes së tij;
- a) Kur u lind ai, nëna e tij pa një dritë të fortë që mbushi gjithë shtëpinë.
 - b) U lëkund froni i mbretit të persëve dhe mbi të ranë njëzet e katër ballkone.
 - c) U shua zjarri i mexhusëve.

(1) El Ja'kùbij, vëll. 2, f. 14; Shtëpia Botuese: "Sàdir", Beirut. ٢٨ شتة e rëndësishme të theksohet se Fatime binti Esed është nëna e imamit Ali bin Ebij Talib (r.a.).

I DËRGUARI MARTOHET ME TË MADHEN HADIJXHE

E madhja Hadixhe ishte bija e Khuuejlid bin Esed bin Abdul-Uzzà bin Kusaj bin Kilàb. Ishte nga fisi Kurejsh. Ishte një grua e pasur që ushtronte tregtinë. Ishte e njohur për ndershmërinë e saj dhe gëzonte një pozitë të respektuar ndër banorët e Mek'kës, madje, aq shumë respektohej ndër kurejshët, sa ata e thërrisnin me epitetin "e pastra". Shumë njerëz ishin të punësuar në tregtinë e saj. Ajo dëgjoji për Muham'medin [a.s.]: djalë i ri, fisnik, me moral të lartë e me autoritet si njeri i ndershëm e besnik, madje vetë banorët e Mek'kës e thërrisnin "i drejti, besniku". Profetit [a.s.] i erdhi propozimi prej Hadixhes që ai të bënte tregti për të. Profeti [a.s.] e pranoi propozimin e saj.

Kështu, ai mori mallin e Hadixhes dhe së bashku me një shërbyes të saj, që quhej Mejsere, udhëtoi për tregti në Sham. Profeti [a.s.] fitoi shuma të mëdha dhe kur u kthyen, Mejsere i foli zonjës së vet për moralin e Profetit [a.s.]; i foli asaj edhe për drejtësinë e për besnikërinë e tij, si dhe për ndershmërinë e tij. Nga të gjitha këto, Hadixhja u ngazëllye dhe u mahnit aq shumë, sa vetë ajo i propozoi Profetit [a.s.] të martohej me të. Për këtë çështje Profeti [a.s.] njoftoi xhaxhallarët e vet. Ata pranuan dhe e uruan. Vetë Ebù Tàlibi, xhaxhai i Profetit [a.s.], bashkë me xhaxhallarët e tjerë shkuan të lidhnin fejesën e tij me Hadixhen dhe ajo para tyre shpalli miratimin e saj për martesën me të Dërguarin e Allahut.

Në këtë kohë Hadixhja ishte dyzet vjeçe, kurse Profeti [a.s.] ishte njëzet e pesë vjeç. Si shumë për kurorëzimin u dha një deve femër. Hadixhja është gruaja e parë me të cilën është martuar i Dërguari [a.s.] dhe ai nuk është martuar me grua tjetër derisa ajo që në këtë jetë. Hadixhja (r.a.) e ka dashur shumë të

Dërguarin e Allahut; ajo kishte ndaj tij një dashuri të çiltër dhe bëri me të një jetë shembullore e të lumtur.

Hadixhja është e para që i ka besuar Profetit [a.s.], është e para që e ka vërtetuar fjalën e tij dhe e ka ndihmuar në thirrjen për besimin në Allahun, siç e ka ndihmuar edhe në përpjektet e në luftën që ai bënte. Ajo vuri në shërbim të thirrjes islame shumë pasuri, madje e shpenzoi të gjithë pasurinë e vet, derisa mbeti aq e varfër, pa asnjë send. Së bashku me Profetin [a.s.], ajo vuajti edhe të gjitha mundimet e kurejshëve dhe bojkotin që ata u imponuan. Hadixheja është nëna e të gjithë fëmijëve të Profetit [a.s.], me përjashtim të Ibrâhijmit, nëna e të cilit është Mârije El-Kibtij'jeh. Fëmijët e Hadixhes janë: Kâsimi, Tâhiri, Zejneb, Rukija, Um'm Kulthûmi dhe Fatime Zehraja, e cila është nëna e dy nipave të Profetit [a.s.], Hasanit e Hysenit – Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve! Kâsimi e Tâhiri kanë vdekur para se Muham'medi [a.s.] të ngarkohej me detyrën e profetnisë. Kur u ngarkua me këtë detyrë, i patën mbetur vetëm vajzat, të cilat migruan së bashku me të për në Medinen e ndritur. Hadixhja ka vdekur në Mek'kë tre vjet para migrimit të Profetit [a.s.]. Hadixhja [r.a.] ka një pozitë të lartë pranë Allahut (xh.sh.) për ndihmesën e madhe që ka dhënë për Islamin me pasurinë e vet dhe me përkrahjen që i ka dhënë të Dërguarit të Allahut në thirrjen islame.

Për të gjitha këto virtyte, Profeti [a.s.] ka thënë: *«Gratë më të nderuara të banorëve të Xhen'netit janë: Hadixhe binti Khuuejlid, Fatime binti Muham'med, Merjem binti Imrân dhe «sija binti Mezâhim, gruaja e faraonit.»*⁽¹⁾ Me çiltërsinë e saj ndaj të Dërguarit [a.s.] dhe me luftën e saj në rrugën e Allahut, Hadixheja e meritoi këtë nderim të madh, ashtu siç meritoi edhe përshëndetjen nga ana e Allahut të lartësuar, së bashku me përgëzimin e saj me Xhen'net qyshkur ajo ishte gjallë.

(1) Muhib'bu-d'dijn Et'Tabresij, "Dhekhâirul-ukbâ fîj menâkibi dheuil-kurbâ", f. 42, 1967.

Është transmetuar se *«Xhibrijli [a.s.] erdhi te Profeti [a.s.] dhe i tha: O i Dërguar i Allahut, kejo Hadixhja po vjen dhe në dorë mban një enë me brumë buke, ose gjellë, ose ndonjë lëng. Kur ajo të vijë tek ti, bëji shumë selam prej Zotit të saj e prej meje dhe jepi asaj sibariqin se do të ketë një shtëpi prej floriri në Xhennet, në të cilën nuk dëgjohen as zëra të ngritur e as zhurma.»*⁽²⁾ I Dërguari i Allahut ka qenë besnik ndaj saj dhe kurrë nuk e harroi atë edhe pasi ajo kishte vdekur; madje në kujtim të respektit e të dashurisë që kishte për të, i respektonte shumë shoqet e saj. Një ditë, gruaja e Profetit [a.s.], «sijeja, dëgjo i që ai po e përmendte Hadixhen edhe me lavdërime, prandaj ajo i tha: «farë i kujton një plake me nofulla të skuqura, kur ty Allahu ta ka zëvendësuar me më të mira se ajo?» Profeti [a.s.] ndjeu dhimbje nga kjo fjalë dhe iu përgjigj: *«Allahu nuk ma ka zëvendësuar me ndonjë grua tjetër më*

*të mirë se ajo; ajo ishte nënë e fëmijëve, zonjë shtëpie; ajo më besoi mua kur të gjithë njerëzit më quanin gënjeshtar; ajo më ngrohu shpirtërisht me pasurinë e saj, kur njerëzit më privuan nga pasuria; prej saj unë kam fëmijë, nuk kam prej ndonjë gruaje tjetër përveçse prej saj.»⁽³⁾ Dashurinë ndaj Hadixhes [r.a.], Profeti [a.s.] e shprehte edhe në rastin kur therte ndonjë dele. Ai thoshte: «*hijuni atyre që ka dashur Hadixhja.*» Aisheja, e habitur e pyeste, por ai i thoshte: «*Sepse unë i dua ata që ajo ka dashur.*»*

Një ditë, i Dërguari [a.s.] ishte në dhomën e Aishes, kur erdhi një grua, për të cilën Profeti [a.s.] tregoi kujdes të veçantë dhe nxitoi t'i plotësonte asaj nevojën që ajo kishte. Aisheja u habit shumë nga kjo sjellje e Profetit [a.s.], por i Dërguari [a.s.] i tha: «*Kjo grua vinte te ne edhe kur ishte gjallë Hadixheja.*» Kështu e mësojmë ne madhësitinë e asaj gruaje të singertë ndaj Allahut e ndaj të Dërguarit [a.s.].

(2) “Sahijhu” i Bukhàriut, vëll. 5, f. 48.

(3) “Is’âfu-rr’râgibijn”, botuar në komentin e marxhinaturës së librit “Nûrul-eb’sâr”, f. 96.

Ne mësojmë gjithashtu edhe për ndihmën e saj ndaj Islamit e mbrojtjen që i bëri thirrjes islame. Ne njihemi edhe me respektin e të Dërguarit [a.s.], si dhe me urdhrin që kumton mesazhi islam për respektin e nderimin ndaj gruas. Mësojmë edhe për rolin e gruas në ndihmë të Islamit, të mbajtjes së barrës së thirrjes islame e të pjesëmarrjes së gruas në ndërtimin e shoqërisë islame e të përmirësimit të saj.

Përmbledhje

Profeti [a.s.] u martua me të madhen, zonjën Hadixhe binti Khuvejlid. Ajo qe mahnitur me besnikërinë e të Dërguarit të Allahut dhe me zgjuarësinë e moralin e tij të bukur. Prandaj ajo vetë i kërkoi Muham’medit [a.s.] që të martohej me të.

E madhja Hadixhe [r.a.] ishte një grua e njohur për ndershmëri dhe gëzonte një pozitë të respektuar shoqërore; ajo njihej ndër kurejshët me epitelin “e pastra”. Ajo është grua e parë me të cilën është martuar i Dërguari i Allahut dhe ai nuk ka marrë grua tjetër derisa ajo ishte në këtë jetë. Ajo është njeriu i parë që i ka besuar Profetit [a.s.] e kështu, ajo është grua e parë besimtare në Islam. Ajo e ka mbështetur shumë Profetin në rrugën e thirrjes dhe në ndihmë të Islamit ajo shpenzoi të gjitha pasuritë e saja të shumta. Nëna e besimtarëve, Hadixhja, ka qenë shembulli i gruas së mirë dhe modeli i gruas myslimane për t’u ndjekur.

Diskutim

1 - Plotësoni frazat vijuese:

a.Hadixhja u mahnit nga Muham'medi [a.s.],
sepse ai ishte i ri.....

b.Fëmijët e Hadixhes ishin:

c.Hadixhja[r.a.] ishte i pari.....dhe e para.....

2 - lfarë mësimi merr gruaja myslimane nga jeta e nënës së besimtarëve,
Hadixhes [r.a.]?

I DËRGUARI JEP NDIHMESËN E TIJ NË NDËRTIMIN E QABES

Pa dyshim, ju e dini se Qabja është Shtëpia e nderuar e Allahut dhe se atë e kanë ndërtuar profeti Ibrâhîm dhe djali i tij Ismâîl - paqja e shpëtimit i Allahut goftë mbi të dy! Ata të dy e ndërtuan këtë Shtëpi me urdhrin e Allahut e iu përgjigjën thirrjes së Tij. Edhe para Islamit arabët e respektonin dhe e nderonin Qaben; ata bënë Haxh'xh në Qabe. Porse, me kalimin e kohës, vendosën në Qabe idhujt e tyre, të cilët ia bënë shokë Allahut të lartësuar. Fisi Khuzàa që i pari që vendosi idhujt në Qabe. Pikërisht atë vit, kur i Dërguari [a.s.] mbushi tridhjetë e pesë vjeç dhe ende nuk ishte ngarkuar me detyrën e profetisë, një rrjedhë e furishme uji shembi muret e Qabes, madje e shembi fare. Në këto kushte, kurejshët u mblodhën dhe vendosën të rindërtonin Qaben dhe ta zgjeronin atë. Ata punuan për ndërtimin e Qabesë derisa muri u ngrit në lartësinë ku duhej vënë "GURI I ZI". Por pikërisht këtu filluan kundërshtimet në mes tyre, pasi secili fis kishte dëshirë të kishte nderin ta vinte "GURIN E ZI" në vendin e vet. Kundërshtimet u acaruan aq shumë, sa që po bëheshin gati të ngrinin armët e të luftonin njëri-tjetrin. Qëndruan në këtë gjendje katër-pesë ditë dhe pastaj i thirrën mendjes të uleshin e të këshilloheshin se si ta zgjidhnin mosmarrveshjen. U ngrit më i moshuari i tyre dhe foli: të bëjmë kështu, do të jetë arbitër ndër ju njeriu i parë që do të hyjë në portë për ardhur te ju. Të gjithë qenë të një mendimi me këtë zgjidhje. Dhe, ndërsa ata ishin ulur dhe po rrinin, hyri i Dërguari i nderuar, Muham'medi [a.s.]. Të gjithë u gëzuan dhe thirrën: ky është besniku, jemi të kënaqur, ky është Muham'medi. Dhe, ndërkaq e njoftuan për çështjen.

Dhe ai e zgjidhi konfliktin. I Dërguari [a.s.] u tha atyre: "Më sillni një rrobë!" E vuri "GURIN E ZI" mbi rrobë dhe pastaj u tha që çdo fis të kapte një anë të rrobës. Kështu, ata e ngritën "GURIN E ZI" e që të gjithë ishin pjesëmarrës në ngritjen e Gurit në vendin ku duhej. Ata u ndien të barabartë, nuk kishte më vend për konflikt, kështu që nuk do të kishte më as luftë e as armiqësi në mes tyre. Kur të gjitha fiset e kapën rroben me "GURIN E ZI"

dhe e çuan te vendi i ndërtimit, i Dërguari [a.s.] e kapi vetë Gurin me dorën e tij të bekuar dhe e vendosi në vendin e vet. Ja, kështu, i Dërguari [a.s.], me mendjen e me urtësinë e tij i dha fund armiqtësisë në fiset e kurejshëve dhe futi paqen në mesin e tyre.

Përmbledhje

Qabja është ndërtuar me urdhrin që Krijuesi i lartësuar i pati dhënë mikut të Tij, Ibrâhîmit dhe djalit të tij, Ismâîlîit – paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi të dy! Por Qabja u shemb nga reshjet e rrëmbyera. Atëherë, fiset arabe vendosën ta rindërtonin. Në punë e sipër shpërthen grindja: kush do ta vinte “GURIN E ZI” në vendin e vet. Ata e lanë çështjen në gjykimin e të drejtit, besnikut Muham’med [a.s.] dhe mbetën të kënaqur me gjykimin e tij, pasi, kështu u mënjanua konflikti.

Diskutim

1 – Plotësoni frazat vijuese:

Allahu e urdhëroi profetin e Tij..... që të ndërtonte Qaben. Dhe ai e ndërtoi atë së bashku me djalin e tij..... që ajo të ishte shtëpi për adhurimin e..... dhe kur fisi Khuzà’a mori drejtimin e punëve të Qabes, futi..... në Qabe.

2 – Cila qe zgjidhja që propozoi i Dërguari [a.s.] për shuarjen e konfliktit për vënien e “GURIT TË ZI” në vendin e vet?

3 – Për çfarë na orienton zgjidhja që dha i Dërguari [a.s.] në lidhje me problemin që lindi në mes fiseve?

4 – Të mbledhurit për të zgjidhur konfliktin, kur panë të Dërguarin [a.s.], thanë: «Ky është.....»

PERGATITJE I PROFETËVE

Mùsàî dhe Ijsàî – paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi të dy! – kanë dhënë sihariq për ardhjen e Muham’medit [a.s.] dhe emri i tij është përmendur në Teuràt e në Ungjill. Edhe jehudët ishin në pritje të një profeti, i cili do përmirësonte botën dhe do të kumtonte mesazhet e Allahut, por ata e prisnin të ishte prej tyre. Kur ai që u dërgua ishte prej arabëve, ata e mohuan dhe e përgënjeshtroan atë. Edhe të krishterët e mohuan atë dhe nuk e pranuan, megjithëse Ijsàî [a.s.] pati dhënë sihariqin për ardhjen e tij, ashtu siç kishte thënë edhe Ungjilli për këtë çështje. Allahu i lartësuar thotë: **«Që ndjekin të dërguarin, profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin e gjejnë të përshkruar (me cilësitë e tij) tek ata në Teuràt e në Ungjill; ai i urdhëron ata**

për punë të mira dhe i ndalon nga punët e këqija; ai lejon për ta ushqimet e shijshme dhe u ndalon atyre gjërat e këqija; ai u heq atyre barrën e rëndë dhe prangat që rëndojnë mbi ta. Ata që i besojnë atij, e nderojnë dhe e ndihmojnë atë; ata veprojnë me dritën që u është zbritur me të: të këtillë janë të shpëtuar.» (*“El A’raf”, 157*) Dhe: «Dhe kur Ijsai, biri i Merjemit tha: ‘o Beni Israilë, unë jam i dërguari i Allahut te ju, jam vërtetues i Teuràtit, që ishte para meje dhe jam përgëzues për një profet që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed’. Por, kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: ‘kjo është magji e hapur’.» (*“Es Saf”, 6*).

Në Ungjillin e Joanit, nxënësit të Mesijhut – para se Ungjilli të revizionohej, Mesijhu jep sihariqin për ardhjen e Muham’medit [a.s.]. Ja si thuhet në këtë Ungjill: «Do të vijë El-Menhan’nà⁽¹⁾;

(1) El-Menhan’nà: Ky është profeti Muham’med [a.s.] në gjuhën surjànije, në të cilën është shkruar Ungjilli i Joanit.

atë do ta dërgojë Allahu te ju me anë të Shpirtit të Shenjtë; ky është ai që vjen nga ana e Zotit dhe ai është dëshmues për mua, e edhe për ju, sepse në kohët e mëparshme ju ishit me mua; këtë unë e them për ju, që kurrë të mos dyshoni.»⁽²⁾

Me gojën e Mesijhut, Ungjilli i Joanit përmend për pasuesit e tij dhe i udhëzon ata për te Profeti i pritshëm që vjen pas tij dhe që është Muham’medi [a.s.]. Mesijhu ka thënë: «Unë kam për t’ju thënë shumë porosi, porse ju nuk keni mundësi t’i mbani ato; dhe, kur të vijë ky shpirt i vërtetë, ai do t’ju drejtojë në të gjitha të vërtetat, sepse ai nuk flet nga vetja, por thotë atë që dëgjon dhe ju njofton për punë që do të vijnë.»⁽³⁾

Këto ishin shkaqet që e bënë Nexh’xhàshiun, mbretin e krishterë të Abisinisë të mendonte rreth profetnisë së Muham’medit [a.s.], pasi dëgjoji fjalën e Xha’fer bin Ebij Tàlibit, kryetari i mërgimtarëve myslimanë në Abisini. Pasi qau vetë dhe bashkë me të qanë edhe dijetarët e krishterë që ishin në kuvendin e tij, kur Xha’feri këndoi suren “Merjem”, mbreti i tha Xha’ferit: «Pa dyshim, kjo dhe ajo me të cilën erdhi Ijsai, kanë dalë nga i njëjti burim drite.»⁽⁴⁾

Përmbledhje

Në Ungjill është sihariqi i Mùsàit dhe i Ijsàit – paqja e shpëtimit i Allahut goftë mbi të dy! – për adhjen e një profeti pas tyre, i cili do përmirësonte botën dhe ky është Muham’medi [a.s.].

Kur’ani ka theksuar praninë e këtij sihariqi. Nexh’xhàshiu, mbreti i krishterë i Abisinisë e ka parë profetninë e Muham’medit [a.s.], ashtu siç e kanë dëshmuar atë edhe një grup dijetarësh të krishterë.

-
- (2) Ibni Hish'shàm, "Es'Sijretu-n'Nebeuij'jeh".
- (3) Inxhijli, pjesa e 16të, pasazhet 12-15.
- (4) Ibni Hishàmi, "Es'Sijretu-n'Nebeuij'jeh", vëll. 1, f. 359-360.

PROFETNIA DHE ZBRITJA E ZBULESËS

Kur Profeti ynë, Muham'medi [a.s.] mbushi dyzet vjet nga jeta e tij e ndritur, Allahu i lartësuar e dërgoi atë profet e udhëzues për në rrugën e drejtë për mbarë njerëzimin. I Larti thotë: **«O Profet, Ne të dërguam ty dëshmues, përgëzues e paralajmërues.» «Dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij e fener ndriçues.»** (*El Ahzàb*, 45-46).

Allahu e kishte përgatitur Profetin [a.s.] dhe e kishte pajisur me edukatën më të bukur; Allahu e kishte pastruar atë nga mëkatet e nga kundërshtimi i urdhrave të Tij qyshkur ai ishte fëmijë, që ai të ishte udhëheqës për në rrugën e drejtë dhe ai ishte i tillë, sa edhe vetë arabët qysh në kohën e padijes, para Islamit e kishin emërtuar me epitelin "i drejti, besniku"; kjo ishte edhe arsyeja që ata i linin gjërat e tyre për ruajtje në dorën e tij në mirëbesim. Profetin [a.s.] e kishte ruajtur Allahu prej veseve të kohës së padijes e prej zakoneve të saja të këqija; Allahu e kishte mbyllur rrugën e veseve për të qyshkur ai ishte fëmijë. Pikërisht për këto që u thanë, imam Aliu thotë: «Allahu e kishte afruar atë pranë vetes, qyshkur ai ishte njomëzak dhe e kishte bërë më të madhin melek prej melekëve të Tij; me atë Allahu udhëzon në rrugën e moraleve më të nderuara e më të bukura të botës, natën e ditën e Tij.»

Shumë kohë para se te Profeti [a.s.] të vinte Xhibrijli dhe para se Allahu ta ngarkonte atë me detyrën e profetnisë, Profeti [a.s.] shkonte në shpellën Hirà, që gjendet në majën më të lartë të një mali pranë Mek'kës; ai shkonte në shpellë vit për vit në muajin Ramazan dhe gjithë muajin qëndronte në shpellë duke bërë adhurim e duke medituar rreth madhështisë së sundimit të qiejve e të Tokës. Në shpellë hante si të varfrit. Ai shkonte në këtë shpellë të bekuar edhe në kohë të tjera, sa herë që gjente rast. Kur vinte fundi i muajit Ramazan, ai kthehej në Mek'kë dhe më së pari drejtohej për në Qabe, bënte Tauaf rreth saj dhe pastaj shkonte në shtëpinë e tij. Para se Xhibrijli [a.s.] të shkonte tek ai në shpellë, Profeti [a.s.] filloi të shihte në gjumë ëndrra të vërteta dhe kjo lloj ëndrre është njëra prej shkallëve të Zbulesës. Koha në të cilën Allahu kishte vendosur në vullnetin e Tij që Muham'medin [a.s.] ta ngarkonte me detyrën e

profetnisë, është viti 610 i kalendarit tone. Pikërisht atë vit ai shkoi në shpellën Hirà në muajin Ramazan dhe mori edhe familjen me vete. Në njëren prej ditëve të këtij muaji të bekuar, Xhibrijli [a.s.] zbriti pranë Profetit [a.s.] dhe i tha: **«Lexo»**. Profeti [a.s.] e pyeti: “^lfarë të lexoj?” Xhibrijli i kërkoi katër herë me radhë që të lexonte, por edhe i Dërguari [a.s.], po aq herë e pyeste: “^lfarë të lexoj?”

Atëherë lexoi vetë Xhibrijli [a.s.] dhe duke iu drejtuar atij tha: **«Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi» «Ai e krijoi njeriun prej një gjaku të mpiksur» «Lexo se Zoti yt është më bujari» «Ai e mësoi** (njeriun të shkruajë) **me laps» «Ai i mësoi njeriut atë që ai nuk e dinte»** (“*El-Alek*”, 1-5). Këto ishin ajetet e para që kanë zbritur prej Kur’anit Kerijm dhe kjo ngjarje shënon fillimet e profetnisë, fillimin e Zbulesës dhe vetë me detyrën e bekuar të profetnisë. Sapo i Dërguari i Allahut u ngarkua me detyrën e profetnisë, erdhi fill te bashkëshortja e tij, Hadijxhe bint Khuvejlid dhe e njoftoi për zbritjen e Zbulesës. Ajo u gëzua për këtë ndodhi, e vërtetoi fjalën e tij dhe i besoi atij; kështu, ajo është gruaja e parë që ka përqaftuar Islamin. Më pas, Profeti [a.s.] njoftoi për çka i kishte ndodhur edhe djalin e xhaxhait të vet, Ali bin Ebij Tàlibin, i cili po rritej dhe po edukohej në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut; ai e kishte marrë Aliun prej babait të tij, Ebù Tàlib qyshkur ishte fare i vogël, atëherë, kur një thatësirë e madhe pati prekur banorët e Mek’kës. Aliu ishte njeriu që i ngjante më shumë Profetit [a.s.] në moral e në cilësi; prandaj Aliu e vërtetoi fjalën e Profetit [a.s.], i besoi atij dhe e pasoi atë. Në këtë kohë, Aliu ishte vetëm dhjetë vjeç, por Aliu është burri i parë që i ka besuar të Dërguarit të Allahut. Pas Aliut e ka pranuar Islamin Zejd bin Hàritheh, i cili ishte skllav i Hadixhes, por ajo ia kishte dhuruar të Dërguarit të Allahut. Ja, kështu u formua bërthama e parë e thirrjes islame dhe shoqëria islame: i Dërguari i Allahut, Hadijxhja, Ali bin Ebij Tàlibi dhe Zejd bin Hàritheh. Zbulesa vazhdoi t’i zbriste të Dërguarit të Allahut dhe veprimi i parë që Xhibrijli [a.s.] i ka mësuar të Dërguarit të Allahut ka qenë Teuhidi fjala e Njëtimimit, besimi se është detyrë të adhurohet është vetëm Allahu. I ka mësuar gjithashtu edhe njohjen e Allahut. Xhibrijli [a.s.] ka marrë abdes para Profetit [a.s.] dhe i ka mësuar mënyrën si merret abdes, pastaj ka falur namaz para tij dhe i ka mësuar faljen e namazit. Edhe i Dërguari i Allahut, nga ana e tij u mësoi së shoqes, Hadijxhes dhe djalit të xhaxhait të tij se si merret abdes dhe si falet namazi. Të parët që kanë falur namaz me të Dërguarin e Allahut kanë qenë Aliu dhe Hadijxhja; janë falur prapa Profetit [a.s.]. Në atë kohë namazi ka qenë dy rekatë për çdo falje.

Përmbledhje

Allahu i lartësuar e ngarkoi Muham’medin [a.s.] të jetë profet për njerëzit, të jetë udhëzues për në rrugën e drejtë për mbarë njerëzimin vetëm atëherë kur ai mbushi dyzet vjet nga jeta e tij e nderuar. Allahu i lartësuar ia ka zbritur

Profetit [a.s.] Kur'anin me anë të Xhibrijlit [a.s.], kur Profeti [a.s.] ishte duke kryer adhurim në shpellën Hirà. Profeti [a.s.] u gëzua shumë dhe ashtu i gëzuar u kthye në shtëpi, njoftoi të shoqen Hadixhe bint Khuvejlid, e cila e vërtetoi fjalën e tij dhe i besoi atij dhe kështu ajo është gruaja e parë që i ka besuar Muham'medit [a.s.], që i ka besuar Profetit [a.s.]. Edhe djali i xhaxhait të Profetit [a.s.], Aliu [r.a.] është burri i parë që i ka besuar atij.

Diskutim

1 – Kujtoni fjalën e Nexh'xhàshiut pasi Xha'fer bin Ebij Tàlibi i këndoi një pjesë nga Kur'ani.

2 – Argumentet që tregojnë profetninë e Muham'medit [a.s.] janë të shumta; me disa nga këto argumente është e mundur të hidhen poshtë në mënyrë rrënjësore thëniet e jehudëve dhe të të krishterëve. Kujtojini këto argumente.

3 – Plotësoni frazat vijuese:

a) Në kohën e padijes, arabët e quanin Profetin Muham'med [a.s.].....

b) Zbulesa i ka zbritur Profetit [a.s.] në shpellën, në vitin..... të kalendarit tonë; melekui që i sillte zbulesën Profetit [a.s.] quhej.....

c) I pari nga burrat që i ka besuar Profetit [a.s.] është..... dhe e para nga gratë që i ka besuar Profetit [a.s.] është.....

d) Besimi i parë që i ka mësuar Xhibrijli [a.s.] të Dërguarit të Allahut [a.s.] është se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, i Cili është detyrë të adhurohet dhe të njihet Teuhijdi; pastaj

4 – Cilat janë àjetet e Kur'ani Kerijmit që kanë zbritur të parat?

THIRRJA NË ISLAM

Ndërsa Zbulesa vazhdote t'i zbriste të Dërguarit [a.s.], edhe i Dërguari i Allahut u bënte thirrje njerëzve në fshehtësi që të pranonin Islamin. Ai ftonte që të besonin se Zot është vetëm Allahu, të Cilit i duhet bërë adhurim dhe duhej lënë e hedhur poshtë adhurimi i idhujve. Thirrja islame ka kaluar nëpër dy etapa.

1 – Etapa në fshehtësi. Në këtë etapë i Dërguari i Allahut u bënte thirrje njerëzve fshehtas që të pranonin Islamin, me qëllim që të formohej fuqia e një grupi besimtarësh, me të cilët do të mundësohej kompaktësia dhe qëndresa ndaj idhujtarëve. Kjo etapë ka vazhduar tre vjet. Gjatë kësaj etape numri i besimtarëve erdhi duke u shtuar, derisa u bënë dyzet veta. Ata kishin një qendër ku mbledheshin në fshehtësi dhe kjo qendër ishte shtëpia e Erkam bin Ebi'l Erkam El-Makhzùmij. I Dërguari i Allahut u mësonte shokëve të tij Kur'anin, namazin, moralin islam, dispozitat e Islamit, i edukonte ata me virtytin, forconte tek ata vendosmërinë dhe durimin për të përballuar mundimet e shtypjen, pasi i Dërguari i Allahut e dinte se kurejshët do të ushtronin mbi atë vetë e mbi shokët e tij llojet më të ashpra të mundimeve e të torturave, ashtu siç kishin vepruar edhe shtypësit e kaluar me të gjithë të dërguarit e me thirrësit për në rrugën e drejtë. Kurejshët do ta luftonin Profetin [a.s.] si armik të tyre, sepse ai kishte qëllim asgjësimin e idhujtarisë që ishte feja e kurejshëve, çka do të ishte edhe asgjësim i interesave të tyre, kurse ata kishin si qëllim të vetëm të sundonin mbi njerëzit dhe të robëronin të pafuqishmit. Këto ishin shkaqet që shtypësit dhe mendjemëdhenjtë e parisë kurejshe do ta luftonin Profetin [a.s.] e nuk do ta pranonin thirrjen e tij, thirrjen për drejtësi, mëshirë e barazi. Profeti [a.s.] takohej me njerëzit fshehtas dhe u bënte atyre thirrje të pranonin Islamin e të hynin në radhët e thirrjes islame. Shokët e të Dërguarit [a.s.], kur do të falnin namaz, shkonin deri në rrethinat e largëta të Mekës; atje faleshin në fshehtësi, që të mos i shihte ndonjë prej idhujtarëve, ndryshe mbi ta do të binin mundimet e idhujtarëve. Një ditë, një grup besimtarësh po falnin namaz jashtë Mek'kës dhe larg syrit të idhujtarëve. Mirëpo disa idhujtarë i zbuluan dhe disa prej tyre i njohën. Menjëherë u sulën mbi besimtarët me të rrahura, por edhe besimtarët iu përgjigjën dhe kështu filluan të rrihen me njëri-tjerin, madje njëri prej besimtarëve e goditi një idhujtar me një kockë deveje dhe filloi t'i rridhte gjak. I Dërguari i Allahut e vazhdonte thirrjen në fshehtësi. Disa veta filluan të pranonin thirrjen e bekuar islame e të organizoheshin në kuadrin e kësaj

thirrjeje. Kur numri i myslimanëve u shtua, njerëzit filluan të flisnin për një profet të ri e për një fe të re.

2 – Etapa e hapur. Kur numri i myslimanëve u shtua dhe lajmi për ekzistencën e Islamit u përhap ndër njerëzit, Allahu i lartësuar e urdhëroi Profetij e Tij që thirrjen ta bënte hapur dhe njerëzit t'i ftonte në Islam sheshit, të kërkonte prej tyre që të hynin në Islam, që të shpëtohej njerëzimi e të përmirësohej gjendja e tyre e besimit, gjendja morale dhe ajo shoqërore që ishte tejet mase e degjeneruar dhe e degraduar. Allahu i lartësuar i zbriti Profetit të Tij ajetin e nderuar, me të cilin e urdhëron që thirrjen ta bënte hapur. Ja dhe ajeti: «Shpalle haptas atë që urdhërohesh dhe mënjanoju prej idhujtarëve!» (“El Hixhr”, 94).

I Dërguari i bën thirrje fisit të vet

Allahu i lartësuar e urdhëroi Profetin [a.s.] që të ftonte të afërmit e tij dhe t'u kërkonte atyre të hynin në Islam. Xhaxhallarët e Profetit [a.s.] të fisit Beni Hàshim në Mek'kë ishin me autoritet të lartë dhe mbanin pozitë komanduese ndër arabët, por edhe arabët nga ana e tyre i respektonin e i nderonin ata, prandaj hyrja e tyre në Islam do të ishte fitore e madhe për Profetin [a.s.] dhe për thirrjen islame; prandaj i Larti e urdhëron profetin e Tij: **«Dhe paralajmëro njerëzit e afërt të fisit tënd!» «Të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pasuan ty!» «Nëse ata (mohuesit) të kundërshtojnë, u thuaj: Unë nuk mbaj përgjegjësi për çka bëni ju.»** (“Esh Shuarà”, 214-216). Kur ky ajet i zbriti të Dërguarit të Allahut, ai thirri imam Aliun [r.a.] dhe e njoftoi se Allahu e urdhëronte që t'i bënte thirrje fisit të tij për të pranuar Islamin; prandaj i kërkoi Aliut që të përgatiste ushqim, pasi kishte qëllim të ftonte bijtë e Abdul-Mut'talibit në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut, që t'u shpjegonte thirrjen në Islam, parimet e saj të mëdha dhe t'u kërkonte atyre që të hynin në Islam. Aliu [r.a.] përgatiti ushqimin, ftoi barkun e Abdul-Mut'talibit që të vinin në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut dhe ata erdhën. Afërsisht bëheshin dyzet burra; ndër ta ishin edhe xhaxhallarët e të Dërguarit të Allahut: Ebù Tàlibi, Hamzai, Ab'bàsi dhe Ebù Lehebi.

Në këtë mbledhje ndodhi një mrekulli e madhe e të Dërguarit të nderuar dhe kjo mrekulli ishte begatia e gjellës: e gjithë gostia e shtruar ishte vetëm një enë me gjellë, e gatuar me një këmbë deleje dhe një tas me qumësht. Kaq gjellë mund ta hante të gjithë vetëm njëri prej tyre; i Dërguari i Allahut mori një copë mish, e kafshoi me dhëmbët e tij të mrekullueshëm dhe e hodhi në anë të tryezës. Edhe të tjerët filluan të hanin, pinë nga qumështi i tasit derisa u ngopën. Pas buke, i Dërguari i Allahut bisedoi me ta dhe u bëri thirrje që të hynin në Islam. Profeti [a.s.] tha: *«O bij të Abdul-Mut'talibit, betohem në Allahun, unë nuk njoh ndonjë djalë arab që të ketë ardhur te njerëzit e tij me atë të mirë që kam*

ardhur unë te ju; unë kam ardhur te ju me mirësi të mëdha të kësaj bote e të Botës tjetër; mua më ka urdhëruar Allahu që t'ju bëj thirrje të besoni Allahun. Cili prej jush do të më ndihmojë mua në këtë punë që të jetë vëllai im, të jetë kujdestari im dhe zëvendësi im ndër ju?» Të gjithë u ngritën nga tryeza. Ndërkaq u hodh Ali bin Ebij Tàlibi, i cili ishte ende fëmijë, pa arritur moshën e pubertetit dhe tha: “Unë, o i Dërguari i Allahut do të jem ministri yt për ato punë.”⁽¹⁾

(1) Et’Taberij, “Tarijkhu-t’Taberij”, vëll. 2, f. 63.

Krahas kumtimit të Zbulesës, i Dërguari i Allahut vazhdonte edhe thirrjen. Një ditë, i Dërguari [a.s.] kishte qëndruar në anën e majtë të Qabes së nderuar, pranë asaj që quhet Hixhri Ismail dhe thirri: «O kurejshë, o arabë, ju bëj thirrje të adhuroni Allahun e të hiqni dorë nga adhurimi i shtatoreve e i idhujve. Ju bëj thirrje të dëshmoni se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut. Përgjigjiuni thirrjes sime që me këtë thirrje të sundoni arabët, për të mirën tuaj! Kjo të jetë fe edhe e joarabëve dhe ju të jeni mbretër në Xhen’net.». Mirëpo, ata u tallën dhe e përqeshën Profetin [a.s.]. Thanë: “U çmend Muham’med bin Abdullahi dhe filluan të talleshin me të e t’i hidhnin fjalë fyese.»⁽²⁾ I tillë ishte i Dërguari [a.s.]: ai u bënte thirrje njerëzve dhe nuk hidhërohej me ata që i shfaqnin armiqësi, ose me ata që e përgënjeshtrojnë dhe talleshin me thirrjen që ai bënte.

Përmbledhje

Pas zbritjes së Zbulesës, i Dërguari [a.s.] filloi të thërriste njerëzit në Islam, në besim e në punë të mira dhe të linin adhurimin e idhujve. Thirrja islame kaloi nëpër dy etapa:

1) *Etapa e fshehtë* që zgjati tre vjet.

2) *Etapa e hapur*, kur Allahu e urdhëroi Profetin e Tij që njerëzve t’ua bënte thirrjen hapur. Allahu e urdhëroi Profetin e Tij të ftonte në Islam njerëzit e afërm të fisit të vet dhe për këtë, Profeti [a.s.] mbledhi të gjithë barkun e Abdul-Mut’talibit dhe u bëri thirrje që ta ndihmonin e ta përkrahnin; por asnjëri prej tyre nuk iu përgjigj thirrjes së tij, me përjashtim të Ali bin Ebij Tàlibit. Megjithatë, i Dërguari [a.s.] e vazhdoi misionin e thirrjes pa u merakosur, as se e përgënjeshtrojnë, as se e tallnin dhe as për faktin se atyre u shtohet mllafi ndaj tij gjithnjë e më shumë.

(2) Et’Taberij, “T’lāmūl-uerā bia’lāmīl-hudā”, f. 39.

Diskutim

1 – Përse i Dërguari [a.s.] u bënte thirrje njerëzve të pranonin Islamin në fshetësi gjatë fillimeve të thirrjes?

2 – Plotësoni frazat vijuese:

Etapa e fshehtë e thirrjes islame ka vazhduar Gjatë kësaj etape, numri i besimtarëve u shtua dhe arriti në Ata caktuan një vend ku mblidheshin në fshehtësi dhe ai vend ishte.....

3 – Flisni shkurtimisht rreth thirrjes që u bëri i Dërguari [a.s.] njerëze të afërm të fisit të tij.

4 – Kur dëshironi t'i bëni thirrje të afërmit tuaj, ose shokut tuaj që ai të angazhohet e të kapet pas Islamit, si do të përfitoni nga mënyra se si e kumtoi i Dërguari [a.s.] shpalljen dhe thirrjen e tij?

VENDOSMËRIA E TË DËRGUARIT

I Dërguari [a.s.] e vazhdoi kumtimin e Shpalljes dhe thirrjen islame, si dhe çlirimin e njerëzve prej padijes, mohimit dhe adhurimit të idhujve pa lënë mënjandë thirrjet e vazhdueshme për të hequr dorë nga idhujt e nga zakonet e kohës së padijes. Zëri i thirrjes u përhap. Njerëzit u njohën me thirrjen dhe me ngadalë filluan të hynin në Islam. Kjo gjë i frikësoi shumë kurejshët se mos

humbnin interesat e veta, pushtetin dhe idhujt e tyre. Kurejshët e ndienin rëndësinë e madhe të thirrjes islame, prandaj ata i shkuan xhaxhait të Profetit [a.s.], Ebù Tàlibit dhe i kërkuan që Muham'medi [a.s.] të hiqte dorë nga ajo thirrje: «Largoje prej nesh djalin e vëllait tënd, - i thanë, - sepse ai po shkatërron ëndrrat tona, shan zotat tanë, po çorodit të rinjtë tanë dhe ka përçarë bashkësinë tonë.» Ebù Tàlibi e thirri të Dërguarin [a.s.] dhe i tha: «O djalë i vëllait tim, njerëzit erdhën tek unë dhe kërkuan që ti të heqësh dorë nga sharja e zotave të tyre.» Profeti [a.s.] i tha: «O xhaxha, unë nuk mund të kundërshtoj Zotin tim.»⁽¹⁾Kurejshët u acaruan shumë nga mospranimi i të Dërguarit [a.s.], sepse tani e morën vesh mirë se ai ishte shumë i vendosur në fenë e tij dhe ishte e pamundur ta bënin që të tërhiqej. Prandaj u mbledhën përsëri dhe shkuan tek Ebù Tàlibi e i thanë: «O Ebù Tàlib, nëse djalin e vëllait tënd e shtyn varfëria të veprojë kështu, ne kemi grumbulluar për të aq pasuri, sa do të ishte më i pasuri i kurejshëve.» Ebù Tàlibi e thirri përsëri Profetin [a.s.] dhe i parashtroi atë që i kishin propozuar kurejshët.

I Dërguari i Allahut iu përgjigj: «O xhaxha, unë nuk kam nevojë për pasuri, por ju përgjigjuni thirrjes sime që të jeni mbretër në këtë botë, mbretër në botën e adhshme dhe që të kenë fenë tuaj arabët e joarabët.»⁽²⁾

(1) Burimi i mësipërm.

(2) Burimi i mësipërm.

Kurejshët erdhën edhe një herë tjetër tek Ebù Tàlibi dhe i thanë se djali i vëllait të tij shante zotat e tyre. Ata i kërkuan Ebù Tàlibit që Muhammedi [a.s.] të hiqte dorë nga zotat e tyre dhe nga thirrja për të besuar vetëm në Allahun, Zotin Një e të Vetëm. Edhe i Dërguari [a.s.] i tha xhaxhait të vet, Ebù Tàlibit: «O xhaxha, sikur ata të më vënë Diellin në krahun e djathtë dhe Hënë në krahun e majtë që unë të heq dorë nga kjo punë, derisa Allahu ta nxjerrë atë mbi çdo gjë, ose të shkrihem e të vdes për këtë punë, kurrë nuk do të hiqja dorë prej saj.»⁽³⁾ Pas kësaj bisede i Dërguari i Allahut qau dhe ndjeu dhimbje prej fyerjeve të kurejshëve. U ngrit të largohej prej Ebù Tàlibit, por ai e thirri e i foli: «Afrohu o djalë i vëllait tim!» I Dërguari i Allahut iu afrua. Ebù Tàlibi i tha: «Shko o djalë i vëllait tim dhe thuaj atë që dëshiron! Betohem në Allahun se unë kurrë nuk do të të dorëzoj ty as për asnjë send.»⁽⁴⁾I tillë që qëndrimi i Ebù Tàlibit për të mbrojtur të Dërguarin dhe për ta ruajtur thirrjen islame; por i tillë që edhe ngulmimi i të Dërguarit [a.s.] në thirrjen e tij; e tillë ishte edhe qëndrueshmëria e tij në fenë e tij dhe në mospranimin e pasurisë e të sundimit në këtë botë. Të gjitha këto ai i bënte në rrugën e besimit të tij e të mesazhit që mbante. Ai i përballi të gjitha trysnitë e djajve mohues dhe armiqësitë e tyre me thirrjen islame për përmirësimin e mbarë njerëzimit dhe shpëtimin e tyre prej padijes, padrejtësisë, prapambetjes,

shkatërrimit e ngatërresave. Një herë tjetër shkoi tek i Dërguari i Allahut Utbeh bin Rebij'ah, i cili ishte nga paria e kurejshëve dhe i tha: «O djalë i vëllait tim! Siç e di, ndër ne, ti je me një pozitë të lartë nga ana e fisit, por ti i solle popullit tënd një problem shumë të madh, ti e përçave bashkësinë e njerëzve tuaj. Më dëgjo mua, unë do të bëj disa propozime. Mbase, ti do të pranosh disa nga ato. Nëse ti dëshiron, ne kemi grumbulluar aq para sa ti do të jesh më i pasuri ndër ne; nëse do nderim, ne të bëjmë të parin tonë dhe nuk vendosim asnjë punë pa ty;

(3) Et'Taberij, "Tàrijkhu-t'Taberij", vëll. 2, f. 67.

(4) Ibni Hishàm, "Es'Sijretu-n'Nebeu'ij'jeh", vëll. 1, f. 283.

përsëri, nëse dëshiron të jeshë mbret, ne të bëjmë mbretin tonë.»⁽¹⁾ I Dërguari [a.s.] i hodhi poshtë me neveri të gjitha këto propozime dhe filloi t'i këndonte Utbes suren "Es'Sexhdeh", por Utbe ndjeu lodhje në shpirt dhe u habit shumë nga ajo që dëgjo. Njëheraz, kuptoi se Muham'medi [a.s.] nuk po kërkonte as pasuri, as autoritet e as pushtet; ai vetëm bënte thirrje për në besimin e vërtetë, ai dëshironte besimin vetëm në Allahun, Zotin Një e të Vetëm, ai dëshironte shpëtimin e njerëzisë nga rruga e humbjes, nga padrejtësia, nga ngatërresat e nga shkatërrimi. E tillë që vendosmëria e të Dërguarit [a.s.] dhe i tillë që singëriteti e përkushtimi i tij ndaj besimit e ndaj Shpalljes që i zbriste.

Mundimet dhe tallja me të Dërguarin

«Thuaje me zë të lartë atë që urdhërohesh dhe mënjano hu prej idhujtarëve!» «Patjetër që Ne të mjaftojmë ty kundër atyre që tallen.» ("El Hixbr", 94-95). Historia e Thirrjes dëshmon se injorantët e çdo kohe e të çdo vendi i janë kundërvënë asaj me kreyeneçësi, me tallje, me përqeshje, me fyerje e me sharje të profetëve, madje edhe me vrasjen e tyre e me torturimin e ithtarëve të profetëve e të atyre që bëjnë thirrje për fenë e Allahut të lartësuar. Idhujtarët i kanë fyer dhe sharë shumë Profetin tonë Muham'medin [a.s.] e shokët e tij. Ata kanë pësuar prej tyre mundimet më të rënda e qesëndisjet më të shpifura.

Por Allahu i mjaftonte Profetin [a.s.] dhe që Ai që i shkatërroi të gjithë qesëndisësit. Ishte paria e kurejshëve që i vinte në lojë Profetin [a.s.] e thirrjen e tij dhe ata ishin: El-As bin Vail Es'Sehmij, Hârith bin Kajs bin Adij Es'Sehmij, El-Esved bin Mut'talib bin Esed, Velijd bin El Mugijreh El Makhzùmij dhe El-Esved bin Abd Jegùth Ez'Zehrij.⁽²⁾ Por Ebù Lehebi ishte njeriu më i ashpër nëfyerje e në armiqësi kundër të Dërguarit [a.s.].

(1) Ibni Hishàm, "Es'Sijretu-n'Nebeu'ij'jeh", vëll. 1, f. 283.

(2) El-Ja'kùbij, "Tàriikhul-Ja'kùbij", vëll. 2, f. 24.

Një ditë, i Dërguari i Allahut po falte namaz dhe rreth tij ishin disa kurejshë. Ata kishin pranë një placentë deveje dhe disa zorrë e plëndësa. "Kush i merr këto, - thanë, - e ia hedh Muham'medit mbi shpinë kur ai të jetë me krye në tokë në sexhde?" U afrua Ukbeh bin Ebij Mu'ijt dhe i hodhi ato ndyrësira mbi shpinën e Profetit [a.s.]. Aty pranë ishte edhe vajza e Profetit [a.s.] Fatimeja, e cila ia hoqi ndyrësitë nga shpina dhe mallkoi atë që e bëri këtë veprim të ulët. I Dërguari [a.s.] iu lut Allahut që Ai të hakmerrej ndaj tyre. Kjo lutje pati pranim të plotë dhe të gjithë ata gjetën vdekjen në luftën e Bedrit, që u zhvillua vitin e dytë pas migrimit të Profetit [a.s.].⁽³⁾

Diskutim

1 – Thoni disa nga mënyrat që përdorën kurejshët për të luftuar të Dërguarin [a.s.] dhe thirrjen islame.

2 – Thoni emrat e krerëve më të rëndësishëm të idhujtarëve të Mek'kës, të cilët e tallnin dhe e qesëndisnin Profetin [a.s.].

3 – Ebù Tàlibi i tha Profetit [a.s.] në 1Pmbrojtje të tij e të thirrjes së tij: "....." Kujtoni fjalët dhe shpjegoni qartë kuptimin e thënies së tij.

4 – Cilat janë mësimet e këshillat që nxjerrim nga vendosmëria e qendrueshmëria e të Dërguarit [a.s.]?

(3) Et'Taberij, "I'làmul-uerà", f. 47, cituar prej Sahijhut të Bukhariut.

KUREJSHËT TORTUROJNË MYSLIMANËT

Kurejshët e panë se i Dërguari [a.s.] po ecte me vendosmëri në thirrjen e tij dhe se shokët e tij jo vetëm ishin të vendosur në besimin e tyre, por ishin dhe shumë të durueshëm në kryerjen e urdhrave të atij besimi. Për më tepër, ata e

panë se Ebù Tàlibi që ishte udhëheqës i kurejshëve, së bashku me të gjithë fisin Beni Hàshim, përveç Ebù Lehebit, ishin në mbrojtje të thirrjes islame e në ruajtje të të Dërguarit [a.s.]. Prandaj, kurejshët filluan të torturonin myslimanët dhe t'i ashpëronin mbi ta presionet e terrorin. Ata po bënin ashtu siç kanë bërë gjithmonë tiranët e kriminelët në kohë të ndryshme gjatë shekujve të historisë që kanë tortuar e kanë vrarë shumë nga pasuesit e profetëve të mëparshëm. Së pari, kurejshët i filluan torturat mbi myslimanët e pafuqishëm, mbi ata muslimanë që nuk kishin as fuqi e as fis që t'i mbronte: ata torturuan rëndë familjen e Jàsirit: torturuan vetë Jàsirin, gruan e tij, Sumej'jen dhe djalin e tyre, Am'màrin. Ebù Xhehli ka bërë mbi ta torturat më të rënda: i rrihte me kamxhik, Sum'mejes i nguli një ushtë dhe e vrau. Kështu, ajo ra dëshmore dhe është dëshmorja e parë e Islamit, ashtu siç u bë dëshmor edhe shoqi, Jàsiri, i cili vdiq nga torturat.

Kurejshët torturuan edhe shokët e tjerë të Profetit [a.s.]: Khab'bàb ibn El-Eretin, Suhajb bin Sinàn Err'Rùmijin, Ebù Fekijheh El-Ezedijn, Amir bin Fehijreh, Bilal Habeshiun dhe burra të tjerë myslimanë e gra të tjera myslimane. Kundrejt ashpërsimit të torturave, fyerjeve e terrorit, myslimanët e pambrojtur treguan durim, vendosmëri e vullnet të hekurt. Vetë Profeti [a.s.] ua forconte atyre qëndrueshmërinë. Ai shkante te familja e Jàsirit kur i torturonin aq rëndë nën nxehtësinë e diellit e mbi prushin e rërës dhe u thoshte: «*Durim, o familja e Jàsirit! Përju është premtuar Xhen'neti.*»

Kurejshët torturonin Bilal Habeshiun, e rrihnin kafshërisht dhe i kërkonin që të mohonte besimin në Allahun dhe thirrjen e të Dërguarit Muham'med [a.s.]: i vinin mbi gjoks një gur të madh, pasi i kishin hequr të gjitha rrobat dhe e linin të shtrirë mbi rërën e nxehtë nën rrezet përvëluese të diellit; ndërkaq, vazhdonin ta rrihnin dhe ta tërhiqnin zvarrë nëpër rërë. Bilali bënte durim dhe thërriste: “Një, Një.” Fyerjet, poshtërimet e torturat ashpësoheshin gjithnjë e më shumë dhe myslimanët e durueshëm e gjithnjë të vendosur kurrë nuk hoqën dorë nga besimi i tyre dhe kurrë nuk e braktisën fenë e Allahut. Kurejshët vrisnin, torturonin e fyenin e poshtëronin cilindo që hynte në Islam. Megjithëkëtë mënxyrë, pavarësisht nga këto metoda makabre, thirrja islame përhapej gjithnjë e më shumë, sepse ishte thirrje për besimin në Allahun, Zotin Një e të Vetëm, për çlirimin e njeriut, për përmirësimin e shoqërisë dhe për të luftuar padijen, mohimin e besëtytnitë. I Dërguari [a.s.] kërkonte durim e qëndrueshmëri prej shokëve të vet dhe me fjalët e tij ua forconte vendosmërinë. Torturat, poshtërimet e shtypja që kurejshët ushtronin mbi myslimanët ashpësoheshin gjithnjë e më shumë. Në këto kushte, një ditë Khab'bàbi bin Eret'i erdhi te Profeti [a.s.] dhe i tha: “Sikur t'i luteshe Allahut të na i largonte këto mundime!” Por i Dërguari i Allahut iu përgjigj: «*Ju po nxitoheni shumë. Nga ata që kanë qenë para jush ka pasur burra, të cilëve u kanë shqyer mishin me krehër bekuri e i kanë sharruar me sharrë; por asgjë nga këto nuk i bëri ata ta*

braktisnin fenë. Allahu do t'u japë mirësi të shumta dhe do të bëjë që kalorësi të udhëtojnë nga San'â deri në Hadremeut e të mos ketë frikë asgjë përveç Allahut...»⁽¹⁾ I Dërguari dëshironte që shokët e tij ta njihnin përvojën e mundimeve. Në rrugën e besimit e të përparimit Allahu do të vinte në provë singëritetin e durimin e tyre. Dhe ata duruan e qëndruan, prandaj shpërblimi i tyre që fitore në këtë botë dhe Xhen'neti me mirësitë e tij të mëdha në Botën tjetër.

(1) El-Ja'kubij, "Tàrikhul-Ja'kubij", vëll. 2, f. 28.

Përmbledhje

1 – Djajtë kurejshë e ndienin rrezikun e thirrjes islame në dëm të fesë së tyre politeiste, ashtu siç ndienin frikën për rrëzimin e pushtetit të tyre mizor. Prandaj ata përdorën metodat më të ndryshme për ta thyer të Dërguarin [a.s.], që ai të hiqte dorë nga thirrja e tij; ata përdorën kërcënimin, frikësimin, joshjen me pasuri e me pushtet, krahas fyerjeve, poshtërimeve e talljeve. Njeriu më i ashpër për poshtërimin e për fyerjet ndaj të Dërguarit të Allahut ka qenë xhaxhai i vet, Ebù Lehebi.

2 – I Dërguari jo vetëm u qëndroi djajve e metodave të djajve, por arriti edhe ta përhapë thirrjen islame me përkushtim të singërtë.

3 – Kurejshët i ashpërsuan shumë torturat e terrorin kundër myslimanëve; por myslimanët qëndruan me durim dhe kurrë nuk e lanë fenë e tyre. I Dërguari [a.s.] kërkonte prej shokëve të tij durim e qëndrueshmëri dhe ai vetë ua forconte atyre vendosmërinë, derisa Allahu i lartësuar i ndihmoi ata dhe thirrja islame u përhap, pavarësisht nga veprimtaria e armiqve dhe sfidat e ndryshme e të shumta.

Diskutim

1 - Kujtoni emrat e atyre shokëve të Profetit [a.s.] që u torturuan dhe ranë dëshmorë në rrugën e Islamit.

2 – I Dërguari [a.s.] shkante te familja e Jàsirit në kohën që ata torturoheshin dhe ai u thoshte atyre:

«.....»

3 – Profeti [a.s.] i dha një mësim për durimin e qëndrueshmërinë njërit prej shokëve të tij dhe ky shok që Khab'bàb ibn El-Eret'ti. Si ishte ai mësim?

MƏRGIMI NƏ ABISINI

Mərgimi i parë

I Dërguari i Allahut ishte nën mbrojtjen e Allahut e të xhaxhait të tij, Ebù Tàlib, e kështu kurejshët nuk mund të ndërmerrenin ndonjë veprim kundër tij për ta vrarë e për ta torturuar, kurse myslimanët e tjerë hiqnin e vuanin nga kurejshët. Kur kurejshët i ashpërsuan shumë mundimet e torturat kundër myslimanëve dhe i Dërguari i Allahut e pa gjendjen e rëndë në të cilën po jetonin shokët e tij, si edhe mizoritë e padrejtësinë që po bëheshin mbi ta, mendoi se ata duhej të largoheshin nga Mek'ka dhe të mërgonin në Abisini, me qëllim që të ruanin fenë dhe jetën e tyre prej mundimeve, torturave e terrorit të banorëve të Mek'kës, kurse vetë i Dërguari [a.s.] do të qëndronte në Mek'kë që të vazhdonte thirrjen e kumtimin e Shpalljes, të përhapte Zbulesën ndër njerëzit dhe ndër ata që i ishin përgjigjur thirrjes së tij. Myslimanët iu bindën urdhrave të Profetit [a.s.] dhe lanë vendin e vet, familjet e pasurinë, ata morën rrugën e mërgimit për të ruajtur fenë e besimin e tyre, sepse ruajtja e fesë është gjëja më e lartë e më shtrenjtë e të gjitha gjërave. I Dërguari i Allahut u tha shokëve të tij: *«Sikur të mërgoni në Abisini, sepse atje ka një mbret dhe askush nuk bën padrejtësi tek ai, derisa Allahu të bëjë një shpëtim e rrugëdalje nga kjo gjendje ku jeni.»*⁽¹⁾ Myslimanët e pambrojtur iu përgjigjën urdhrave të Profetit [a.s.]. Katërmëdhjetë myslimanë morën rrugën e mërgimit: katër gra e dhjetë burra, nën kryesinë e sahabiut luftëtar, Osman bin Madh'un. Në këtë megrim, Osman bin Madh'un kishte me vete edhe gruan. Ky qe mërgimi i parë në Islam për në Abisini, ku kërkuan mbrojtje prej mbretit të saj, Nexh'xhàshiut. Mërgimi i myslimanëve ndodhi në muajin Rexheb të vitit të dytë pasi i

(1) Ibn Ethijr, "El Kàmilu fit'tàrikh", vëll. 2, f. 8, botim i vitit 1385H.

Dërguari [a.s.] kishte shpallur hapur thirrjen e tij të bekuar, ose pas pesë vjetëve që kishte filluar detyra e nderuar e profetnisë. Myslimanët qëndruan në tokën e Abisinisë dy muaj, muajin Sha'ban dhe Ramazan. Më pas u përhap një lajm jo i vërtetë se gjoja idhujtarët ishin pajtuar me myslimanët dhe kështu ata u kthyen në Mek'kë. Por, në fakt ata panë se idhujtarët ishin bërë më të ashpër e më armiqsorë ndaj myslimanve dhe i kishin shtuar edhe më shumë mundimet ndaj tyre. Prandaj myslimanët mërgimtarë nuk patën mundësi të hynin në Mek'kë; ata hynë vetëm atëherë kur i morën nën kujdesje e nën mbrojtjen e tyre disa personaliteve të Mek'kës. Ja kështu përfundoi mërgimi i parë për në Abisini.

Mërgimi i dytë në Abisini

I Dërguari [a.s.] vazhdoi ta përhapte thirrjen islame dhe luftën kundër besimit në idhujtarinë e në zakonet e kohës së injorancës, para Islamit, si dhe kundër moralit të prishur të asaj kohe. Përkrah tij, në këtë veprimtari ishin shokët e tij, besimtarët e durueshëm, mbi të cilët u ashpërsuan edhe më shumë mundimet, torturat e sulmet e hapura të kurejshëve. Në një gjendje të tillë, Profeti [a.s.] u kërkoi myslimanëve për herë të dytë që të mërgonin në Abisini e të ishin nën mbrojtjen e Nexh'xhàshiut, mbretit të drejtë të Abisininë, i cili ishte në fenë e Mesijhut [a.s.], por i donte myslimanët, i ndihmonte e i mbronte. Mbreti quhej As'hamëh. Këtë herë mërguan një grup i madh myslimanësh që nuk kishin mbrojtje, burra e gra, nën kryesinë e Xha'fer bin Ebi Tàlibit [r.a.], djali i xhaxhait të Profetit [a.s.]. Xha'feri ishte një luftëtar i madh në rrugën e Allahut dhe ai luftoi në mbrojtje të Islamit. Në këtë mërgim Xha'feri kishte me vete edhe gruan e tij, Esmà bint Umejs. Më pas, vazhduan prapë të mërgonin myslimanët, derisa numri i tyre arriti në tetëdhjetë e dy burra dhe disa gra, të cilat, duke shoqëruar burrat e vet në rrugën e mërgimit, mbajtën mbi supet e tyre mundimet e ashpërsinë e jetesës në vend të huaj, vetëm e vetëm që të mbronin Islamin dhe të ruanin besimin përkrah burrave të vet. Kështu, ato gra ishin të parat në besim që mërguan në rrugën e Allahut.

Myslimanët në Abisini

Myslimanët arritën në Abisini dhe zunë vend aty nën mbrojtjen e mbretit të saj të drejtë, Nexh'xhàshiut. Kur kurejshët mësuuan se myslimanët kishin zënë vend dhe se ata i mbronte vetë Nexh'xhàshiu, u frikësuan shumë se thirrja islame do të fuqizohej me mbrojtjen që po jepte shteti i Nexh'xhàshiu për përhapjen e Islamit. Prandaj kurejshët vendosën të dërgonin dy nga personalitetet e tyre. Ata u paraqitën te Nexh'xhàshiu për ta bindur atë që t'ua dorëzonte atyre myslimanët dhe të hiqte dorë nga mbrojtja e tyre. Ata kishin ardhur me dhurata të çmuara për Nexh'xhàshiu e për burrat e shtetit të tij, madje sapo mbërritën në Abisini, i paraqitën Nexh'xhàshiut dhuratat që kishin sjellë. Mbreti i pranoi dhuratat e tyre; pastaj ata nisën bisedimet me mbretin për çështjen e emigrantëve, të cilët ia përshkruan mbretit si njerëz naivë dhe agresorë. Ata e nxisnin mbretin për keq kundër myslimanëve me qëllim që ai t'ua dorëzonte kurejshëve, që ata t'i torturonin e pastaj t'i asgjësonin; kështu, do të pengonin përhapjen e thirrjes islame. Nexh'xhàshiu ishte mbret i mençur; ai as nuk u besoi atyre e as nuk iu përgjigj kërkesës së tyre. Në të kundërt, ai u tha atyre: “Qysh do t'jua dorëzoj unë ju ata, në një kohë që ata kanë zgjedhur vendin tim, më preferuan mua për fqinj dhe prandaj u strehuan tek unë dhe nuk shkuan të kërkojnë strehim te ndonjë tjetër?”

Unë ata do t'i thërres e do t'i pyes për fenë e për besimin e tyre, - tha mbreti, - dhe, nëse ata janë ashtu siç thoni ju, atëherë do t'jua kthej; në të kundërt, do t'i lë të jetojnë këtu dhe jam zotuar për mbrojtjen e tyre.” Ndërkaq, Nexh'xhàshiu kërkoi të sillnin pranë tij Xha'fer bin Ebij Tàlibin, kreun e grupit të emigrantëve së bashku me shokët e tij, që t'i pyeste rreth fesë islame. Ata u paraqitën. Nexh'xhàshiu i pyeti ata për fenë e tyre dhe për shkakun e emigrimit, përse ata kishin lënë shtëpitë e veta dhe kishin marrë rrugën për Abisini. Fjalën e mori Xha'fer bin Ebij Tàlibi. Ai tha: «O mbret, ne ishim një popull injorant (i paditur) që adhuronim idhujt, hanim ngordhësirat, bënim punë të shëmtuara, prisnim lidhjet me të afërmit, i bënim keq fqinjët, i fortë prej nesh hante të pafuqishmin; të tillë ishim ne, derisa Allahu çoi ndër ne një të dërguar, të cilit ne i njohim fisin, drejtësinë, besnikërinë dhe nderin. Ai na bëri thirrje të besojmë Allahun, Zotin Një e të Vetëm dhe të adhurojmë vetëm Atë; ai na urdhëroi gjithashtu të shkullim nga zemra shtatoret e gurta që kemi adhuruar ne e të parët tanë, në vend të Allahut; ai na urdhëroi të themi vetëm të vërtetën, të çojmë në vend gjënë e lënë në mirëbesim, të mbajmë lidhje me të afërmit, të sillemi mirë me fqinjët, të heqim dorë nga punët e ndaluara e nga gjakderdhja; ai na ka ndaluar punët e turpshme, rrenën e ngrënien e pasurisë së jetimit, si dhe sharjen në nder të grave të ndershme; ai na ka urdhëruar të adhurojmë vetëm Allahun e të mos i vëmë atij shok e ortak në adhurim; ai na ka urdhëruar të falim namaz, të japin zeqat e të agjërojmë...». Xha'feri vijoi të shpjegonte mesazhin me të cilin kishte ardhur i Dërguari [a.s.] dhe vijoi: «Për të gjitha këto, ne e vërtetuam atë, i besuam atij dhe e ndoqëm në ato që atij i kishin ardhur prej Allahut; kështu, ne adhurojmë vetëm Allahun dhe nuk i vëmë Atij shok e ortak në adhurimin tonë; ne e njohim të ndaluar për ne atë që na është ndaluar dhe njohim të lejuar për ne atë që na është lejuar; për këtë populli është armiqësuar me ne e na kanë torturuar; ata duan që ne të lëmë fenë tonë dhe të na rikthejnë në adhurimin e idhujve, në vend të adhurimit të Allahut të lartësuar; ata duan të na ndalojnë nga feja jonë; prandaj ne morëm rrugën për në vendin tuaj; ne zgjodhëm vendin tuaj dhe nuk zgjodhëm vend tjetër, ishte dëshira jonë të jemi fqinjët tuaj, sepse ne shpresojmë, o mbret, se tek ju nuk do të dhunohemi.» Atëherë, Nexh'xhàshiu i tha: “A ke diçka nga ajo që atij (të Dërguarit, Muham'medit [a.s.]) i ka ardhur prej Allahut?” Xha'feri tha: “Po, kam.” Pa këndoje ta dëgjoj, - i tha Nexhashiu. Xha'feri i këndoi një pjesë nga sureja “Merjem”: **«Kàf. Hà. Jà. Ajn. Sàd»** Nexh'xhàshiu qau; qanë edhe peshkopët që ishin me të. Pastaj Nexh'xhàshiu u tha atyre: «Në të vërtetë, edhe Ijsài me këtë ka ardhur dhe pa dyshim, që kanë dalë nga një ndriçues i vetëm.»⁽¹⁾

(1) Ibn Hishàm, “Es'Sijretu-n'Nebeuij'jeh”, vëll. 1, f. 361

Mbreti i përzuri dy të deleguarit e idhujtarëve. “Kurrë nuk do t’jua dorëzoj, - u tha atyre, -unë do t’i mbroj ata, sepse unë pashë se besimi i tyre në Allahun e lartësuar është i njëjtë me besimin e Mesijhut, Ijsait, në Allahun; është kështu, sepse të gjithë profetët pa përjashtim kanë ardhur prej Allahut me besimin vetëm në Allahun, Zotin Një e të Vetëm, sepse profetët janë mesazhierët e Allahut për te njerëzit.”Ja, kështu i ndihmoi Allahu mërgimtarët dhe i poshtëroi idhujtarët. Myslimanët qëndruan në Abisini të siguruar e të respektuar.Xha’fer bin Ebij Tàlibi së bashku me disa emigrantë të tjerë qëndroi në Abisini deri vitin e shtatë të Hixhretit dhe vetëm në këtë vit u bashkua me të Dërguarin e nderuar [a.s.] në Medinen e ndritur, pas betejës së Khajberit, betejë të cilën e fituan myslimanët nën komandën e imam Ali bin Ebin Tàlibit, vëllait të Xha’ferit. I Dërguari [a.s.] e priti Xha’ferin dhe e puthi në mes dy syve dhe tha: *«Betohem në Allahun, nuk e di për çfarë të jem më i gëzuar, për çlirimin e Khajberit, apo për ardhjen e Xha’ferit.»*⁽²⁾Xha’fer bin Ebij Tàlibi, luftëtari, trimi i sinqertë ndaj Allahut e të Dërguarit të Tij u bashkua me forcat myslimane. Ai ka komanduar myslimanët në luftën e Meunes, kur myslimanët luftuan kundër bizantinëve. Në këtë luftë, në vitin e tetë të Hixhretit, Xha’feri [r.a.] ka rënë dëshmor. I Dërguari i Allahut u hidhërua shumë dhe, kur pa se gratë po qanin për Xha’ferin tha: *«Për burra si Xha’feri le të qajnë gratë!»* Historia e thirrjes islame dëshmon për ne rolin e gruas, si dhe luftën e saj në rrugën e Allahut, krahas emigrimit të saj në këtë rrugë. Ne pamë më sipër se si Sumej’ja, gruaja e Jàsirit ishte dëshmorja e parë e Islamit; gratë janë torturuar dhe kanë mërguar në rrugën e Allahut; ne mësuam se si nëna e besimtarëve, e madhja Hadijxhe bint Khuvejlid [r.a.], gruaja e të Dërguarit të Allahut, ishte pjesëmarrëse në ndihmë të Islamit me pasurinë e saj; po kështu, mësuam për rolin e gruas në përhapjen e thirrjes islame dhe për luftën e saj të ndritur në rrugën e Allahut përkrah burrave.

(2) El-Jàkùbij, “Tàrijkhul-Jàkùbij”, vëll. 2, f. 56.

Përmbledhje

Kur mundimet e kurejshëve ndaj myslimanëve u shtuan, Profeti Muham’med [a.s.] urdhëroi disa prej shokëve të vet të emigronin në Abisini, ku ishte një mbret i drejtë. Emigruan dhjetë burra e katër gra, nën kryesinë e sahabiut të nderuar Osman bin Madh’ùn [r.a.], por pas pak kohe ata u kthyen në Mek’kë. Pastaj myslimanët kanë emigruar në Abisini për herë të dytë, nën kryesinë e Xha’fer bin Ebij Tàlibit [r.a.].Kurejshët çuan një delegacion te mbreti i Abisinisë që t’i kthente myslimanët, por mbreti e hodhi poshtë kërkesën e atij delegacioni dhe myslimanët qëndruan në Abisini derisa u çlirua Khajberi në vitin e gjashtë të Hixhretit.

Diskutim

1 – A vetëm frika nga shtypja e kurejshëve ishte shkaku i vetëm i emigrimit të myslimanëve?

2 – Përse i Dërguari [a.s.] zgjodhi Abisininë që të emigronin myslimanët e shtypur? Përse kurejshët u përpoqën t'i kthenin myslimanët në Mek'kë?

3 – A ka marrë pjesë gruaja myslimane krahas burrave në emigrim dhe në mbrojtje të thirrjes islame? Thoni shembuj!

4 – Luftëtar i madh, njëri ndër thirrësit e Islamit ka kryesuar emigrantët në Abisini gjatë emigrimit të dytë. Thoni emrin e tij e flisni për lidhjen e tij me të Dërguarin e Allahut!

RRETHIMI E BOJKOTI

I Dërguari i Allahut e vazhdoi përhapjen e thirrjes islame fshehtazi dhe hapur. Njëkohësisht, vazhdonte t'i zbriste Zbulesa. Ndërkaq, u shtua numri i myslimanëve. Përkrah Profetit Muham'med [a.s.] qëndruan në mbrojtje të tij e të thirrjes islame Ebù Tàlibi e Hamza bin Abdul-Mut'talibi dhe i gjithë fisi Beni Hàshim me përjashtim të Ebù Lehebit, i cili e përgënjeshtronte dhe e fyente të Dërguarin [a.s.]. Edhe Nexh'xhàshiu u vu në përkrahje të emigrantëve myslimanë me mbrojtjen që u dha atyre. Kurejshët u frikësuan për interesat e tyre, për pushtetin që kishin dhe për pasuritë e veta nga rritja e fuqisë së Islamit dhe e përkrahësve të tij. Pasues të Profetit [a.s.] ishin kryesisht të varfrit, ata që nuk kishin përkrahje dhe skllevërit. Ata i besuan Profetit [a.s.] sepse panë se ai me të vërtetë, ishte shpëtuesi dhe përmirësuesi i njerëzisë. Për të gjitha këto, kurejshët vendosën të vrisnin të Dërguarin [a.s.] dhe të shpëtonin prej tij. Ky lajm shkoi në veshin e Ebù Tàlibit, i cili i paralajmëroi kurejshët dhe ata nga frika u tërhoqën. Ndërkohë, kurejshët menduan të impononin rrethimin e bojkotin, jo vetëm kundër të Dërguarit të Allahut dhe fisit Beni Hàshim, por dhe kundër të gjithë myslimanëve. Për këtë arsye, ata u mbledhën dhe hartuan një shkresë në formën e një akti, me anë të së cilës njoftonin vendimin për të

imponuar rrethimin e bojkotin. Ata shpallnin në atë fletë të shkruar se nuk do të bënin krushqi me Beni Hàshimët, as nuk do të merrnin vajzat e tyre as nuk do të martonin vajzat e veta me ta, nuk do t'u shisnin atyre asgjë e nuk do të blinin prej tyre asgjë; për më tepër, nuk do të lejonin asnjë që t'u shiste Beni Hàshimëve ndonjë gjë. Pasi e shkruan këtë fletë mizore, e varën në Qabe. Fletën e shkruar e kishin nënshkruar tetëdhjetë veta⁽¹⁾ nga paria e

(1) Et'Tabresij ka përmendur në "A'làmul-Uerà" se nënshkruesit e fletës ishin dyzet persona nga paria e kurejshëve.

idhujtarëve. Dora e shkruarit të fletës mizore u paralizua. Kurejshët e rrethuan të Dërguarin e Allahut bashkë me myslimanët në rrugën "Shu'ab"⁽²⁾ të Ebù Tàlibit, së bashku me të gjithë pjestarët e fisit Beni Hàshim e Beni Mut'talib - xhaxhallarët e Profetit [a.s.].

Rrethimi zgjati tre vjet. Gjatë kësaj kohe i Dërguari i Allahut, Ebù Tàlibi dhe Hadixhja shpenzuan pasuritë që kishin për thirrjen islame, por shpenzimi që aq i madh sa nga pasuria e Hadixhes nuk mbeti më asgjë, megjithëse ajo ishte nga më pasanikët e banorëve të Mek'kës. Kurejshët ndalonin edhe futjen e ushqimit për myslimanët, përveç atij ushqimi që e fusnin në fshehtësi disa që ndienin dhembshuri ndaj të rrethuarve dhe njerëzit e tyre të gjakut të afërm. Nga uria, të rrethuarit kanë ngrënë edhe barin e fushës. Por, pavarësisht nga varfëria e uria e madhe, ata duruan në rrugën e besimit e të thirrjes së ndritur islame dhe e përballuan këtë rrethim e bojkot. Sprova e rëndë, që po kalonin i Dërguari [a.s.] dhe ata që ishin me të, kishte arritur kulmin. Por mu në këtë kohë vjen Xhibrijli [a.s.] dhe e njofton të Dërguarin [a.s.] se Allahu kishte lëshuar mizat e tokës ta hanin fletën. Dhe mizat e kanë ngrënë atë, me përjashtim të vendeve ku ishte shkruar emri i Allahut. Menjëherë i Dërguari [a.s.] njoftoi Ebù Tàlibin për këtë lajm. Ebu Ta'libi u gëzua shumë dhe së bashku me Profetin [a.s.] dhe familjen e tij dolën dhe shkuan e qëndruan në Qabe. Ndërkaq, erdhën kurejshët dhe i kërkuan Ebù Tàlibit që të hiqte dorë nga Islami dhe të mos e mbronte as Islamin e as të Dërguarin e nderuar. Ebù Tàlibi u tha atyre që erdhën: "Silleni atë fletën tuaj dhe do të shihni se atë e kanë ngrënë mizat e tokës dhe se për këtë Allahu ka njoftuar Profetin e Tij." Kur ata e sollën fletën, panë se me të vërtetë atë e kishin ngrënë mizat e tokës, përveç vendeve ku ishte shkruar emri i Allahut. Ata u habitën shumë, por megjithatë thanë: "Kjo është magji, e kemi ditur edhe më parë." Kur kurejshët panë të vërtetën që u kishte njoftuar i Dërguari i Allahut, një grup prej tyre që e kishin nënshkruar atë fletë, u shfajsoan dhe e hodhën poshtë atë që patën

(2) Rruga "Shuab" e Ebù Tàlibit në Mek'kë është vendi ku ka lindur Profeti [a.s.], "Mexhme'ul-bahrejn", vëll. 2, f. 90.

vendosur. Ishin të shumtë njerëzit që vërtetuan drejtësinë e të Dërguarit të Allahut dhe i besuan atij. Ja, kështu u thye rrethimi dhe kështu i Dërguari [a.s.] e ata që ishin me të dolën nga rruga ku ishin izoluar. Ja, kështu e fituan myslimanët edhe luftën ekonomike që i patën imponuar idhujtarët.

Përmbledhje

Kur thirrja islame u fuqizua dhe filloi të përhapej në fshehtësi e haptazi, kurejshët u frikësuan shumë; prandaj krerët e kurejshëve u morën vesh me njëri-tjerin dhe vendosën t'i bojkotonin Muham'edin [a.s.] dhe të gjithë ata nga fisi e nga xhaxhallarët e tij që e mbështesnin atë. Kurejshët i izoluan Profetin [a.s.] dhe të gjithë përkrahësit e tij në "Shuabin" – rrugën e Ebù Tàlibit për tre vjet me radhë. Por ata dështuan edhe në këtë veprim, sepse muslimanët dolën nga rrethimi me vendosmëri edhe më të madhe, me besim më të ngulitur dhe më të vendosur në të vërtetën e besimit të tyre.

Xhaxhai i Profetit [a.s.], Ebù Tàlibi ka meritë të veçntë dhe shumë të madhe në mbrojtje të thirrjes islame dhe të vetë Profetit të nderuar – paqja e shpëtimit i Allahut qoftë mbi të.

Diskutim

1 – Ciliat ishin pikat e rrethimit e të bojkotit që krerët kurejshë i shkruan në fletën e tyre?

2 – Vërehet një ngjashmëri e madhe në disa pika të fletës së rrethimit e të bojkotit në luftën e kurejshëve kundër Islamit me disa mënyra rrethimi e bojkoti që praktikojnë Fuqitë e Mëdha ndaj popujve të pafuqishëm në ditët e sotme. Kujtoni njëren nga mënyrat e rrethimit të përmendura më sipër!

3 – Sa kohë zgjati bojkoti e rrethimi i Profetit [a.s.] dhe i përkrahësve të tij? A patën sukses kurejshët? Si qe përfundimi i rrethimit e i bojkotit?

VITI I HIDHËRIMIT

Pasi myslimanët dolën nga rrethimi ekonomik dhe bojkoti shoqëror i kurejshëve, i Dërguari i Allahut humbi në atë vit dy nga ndihmësit e tij më të rëndësishëm: humbi të shoqen, nënën e besimtarëve, të madhen Hadijxhe bint Khuvejlid, e cila qe e para që i besoi Profetit [a.s.], që e vërtetoi Profetin [a.s.] dhe që ajo shpenzoi të gjithë pasurinë e saj të madhe në rrugën e Allahut. Nëna e besimtarëve, Hadijxhja ka ndërruar jetë në moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeç, tre vjet para Hixhretit, në muajin e bekuar të Ramazanit. Humbja e saj i shkaktoi Profetit [a.s.] dëshpërim të thellë e dhimbje të madhe. Kur vdiq

Hadixhja, bija e saj Fatimja filloi të qante e mbështetur në trupin e babait të vet, të Dërguarit të Allahut dhe thoshte: “Ku është nëna ime? Ku është nëna ime?” Me të shpejtë erdhi Xhibrijli tek Profeti [a.s.] dhe e njoftoi: *«Thuaj Fatimes se Allahu ka ndërtuar për nënën tënde një shtëpi prej floriri në Xhen’net, në të cilën nuk ka as zëra të ngritur e as zburmë.»*⁽¹⁾ Tri ditë pas Hadixhes [r.a.], ndërroi jetë edhe Ebù Tàlibi. Ebu`Ta`libi. Kur i Dërguari i Allahut dëgjoi se kishte ndërruar jetë xhaxhai i tij, ndjeu një dhimbje të madhe e të fortë, qëndroi pranë tij, i fërkoj ballin djathtas e majtas dhe tha: *«O xhaxha, rrite një të vogël, u përkujdese për një jetim dhe e ndihmove jetimin të rritur. Prej meje Allahu të shpërbleftë me të mirë!»*⁽²⁾ Pastaj, në kulmin e dhimbjes, i Dërguari i Allahut tha: *«Mbi këtë popull u mblodhën dy pësime të rënda dhe unë nuk di se cili është më i rëndë.»*⁽³⁾ Po në këtë kohë kurejshët filluan t’i ashpëronin fyerjet e armiqësinë e tyre.

(1) El-Jakùbij, “Tàrijkhul-Jakùbij”, vëll. 2, f. 35.

(2) I njëjti burim.

(3) I njëjti burim.

Përmbledhje

Një vit pas përfundimit të rrethimit ekonomik e bojkotit shoqëror të kurejshëve kundër myslimanëve, i Dërguari i Allahut humbi dy mbështetësit e ndihmësit më të rëndësishëm, humbi gruan e tij, nënën e besimtarëve, të madhen Hadixhe dhe xhaxhanë e tij Ebù Tàlibin. Profeti [a.s.] u hidhërua shumë për humbjen e atyre dy vetave dhe atë vit ai e emërtoi “Viti i hidhërimit”.

Diskutim

1 – Kur ndërroi jetë nëna e besimtarëve, e madhja Hadixhe [r.a.]?

2 – Ëfarë tha i Dërguari [a.s.] kur qëndroi para trupit pa jetë të xhaxhait të tij, Ebù Tàlib?

N ٢١٢

Tre vjet para Hixhretit dhe një vit pasi myslimanët dolën nga rrethimi i imponuar, ndërroi jetë Ebù Tàlibi dhe e madhja Hadijxhe, gruaja e të Dërguarit të Allahut. Me vdekjen e Ebù Tàlibit, mbrojtësit të Profetit [a.s.] dhe të thirrjes islame, kurejshët i shtuan mundimet dhe i shpeshatuan rastet e barabarisë së tyre kundër të Dërguarit të Allahut, kundër thirrjes dhe kundër shokëve të tij. Në këto kushte, i Dërguari i Allahu u vu në kërkim të një toke të re ku të përhapte thirrjen e tij dhe dhe të kumtonte përgëzimin për Shpalljen në mjediset e fiseve arabe e të lagjeve të qyteteve, duke shpresuar se do të gjente njerëz që do t'i përgjigjeshin thirrjes së tij, ose se do të arrinte të gjente mbështetje e mbrojtje. Me këtë qëllim, ai shkoi në Tàif që t'i bënte thirrje fisit Thekijf, të cilët ishin banorë të Tàifit. Ai shkoi që t'u parashtronte atyre hyrjen në Islam. Për këtë qëllim, u drejtua tek tre krerë të thekifëve. Profeti [a.s.] u parashtroi atyre thirrjen që të hynin në Islam dhe i përgëzoi me parimet e Shpalljes së Allahut.

Paria e Tàifit u tallën me atë thirrje, e poshtëruan të Dërguarin e nderuar, u tallën me Shpalljen dhe e bënë Profetin [a.s.] të dëgjonte fjalë të rënda. Ata nuk u mjaftuan me qëndrimin armiqësor e me qesëndisjen, por nxitën edhe lolot e fëmijët që ta poshtëronin e ta ndiqnin të Dërguarin [a.s.] dhe ta nxirrnin atë prej vendbanimit të tyre. Aq deshën të tërbuarit e llafazanët që të turrehin kundër Profetit [a.s.]: ata filluan ta gjuanin edhe me gurë e t'i zinin kalimet e rrugëve, me fjalët më të ndyra. I Dërguari [a.s.] i përballoi fyerjet, poshtërimet e mundimet me zemrën e madhe të profetnisë. Mbajtësi i Shpalljes së Allahut dhe besimtari në këtë Shpallje tregoi durim të jashtëzakonshëm. Ai ishte i gatshëm të flijojë në rrugën e Thirrjes. Ai nuk i vinte në peshë poshtërimet, fyerjet e vuajtjet në udhëtimin që po bënte për të përhapur Thirrjen islame dhe luftën në shërbim të saj. I Dërguari ka qenë model i durimit e i sakrificës ndaj poshtërimeve, fyerjeve e dhunës së të gjitha llojeve e formave, ashtu siç ishte model i qëndrueshmërisë në të drejtën e në të vërtetën. I Dërguari [a.s.] u largua

nga Tàifi me vuajtje të mëdha, nga sjellja e keqe e banorëve të tij dhe ashtu i rraskapitur nga udhëtimi, nga lodhja, nga fyerjet e nga mundimet, me këmbë të gjakosura, arriti të hynte në një kopësht që ishte pronë e Utbes dhe Shejbes, djemtë e Rebij'as. U ul nën hijen e një hurme, filloi të meditonte për Zotin e tij e t'i ankohej vetëm Atij për sprovën e rëndë që kaloi: «O Zoti im, Ty të ankohem për pafuqinë time, për aftësitë e mia të pakta. O Zoti im, o më i Mëshirëshmi i mëshiruesve, Ti je Zoti i të pafuqishmëve, Ti je Zoti im. Për ku më bën mbështetem, te një skllav që më pret fytyrëvrenjtur, apo te një armik që ka në dorë çështjen time? Nëse Ti nuk je i zemëruar me mua, unë nuk merakosem, sepse falja Jote është më e gjëra. Unë kërkoj mbrojtje me dritën Tënde, dritë, me të cilën Ti ndriçove errësirat dhe ndreqe punët e kësaj bote e të Botës tjetër. (Bëj që) Mbi mua të mos bjerë zemërimi Yt e as të jenë të lejuara për mua veprime që sjellin zemërimin Tënd!»⁽¹⁾

I Dërguari i Allahut u dëshpërua shumë nga qëndrimi i thekifëve dhe pati frikë se do të dëshpërohej edhe nga barra e Thirrjes; pati frikë gjithashtu, se do t'i dobësohej këmbëngulja për vazhdimin e rrugës së kumtimit të Shpalljes. Por, me gjithë vuajtjet e mundimet, torturat, fyerjet e poshtërimet, ai përsëri ishte i kënaqur dhe plotësisht i sigurt se sa kohë që do të vazhdonte Thirjen, punën e luftën në rrugën e Allahut, Allahu do të ishte i kënaqur prej tij; prandaj ai nuk frikësohej as nga mundimet, as nga përndjekja e as nga qesënditë e talljet, sepse i frikësohej vetëm zemërimit të Allahut dhe pakënaqësisë së Tij. Përderisa ishte i sigurt për këtë, ai meditonte për Zotin e tij dhe i shprehte Atij gjithçka që kishte në shpirt dhe thoshte:

(1) I njëjti burim

«Nëse mbi mua nuk rëndon zemërimi Yt, unë nuk merakosem.» Pamja dhe qëndrimi i tij i rrallë ngjallën tek dy pronarët e kopshtit dashamirësi e mëshirë. Prandaj ata me anë të një shërbyesi të tyre, që quhej Ad'dàs dhe që ishte në fenë e krishtere, i çuan rrush të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Allahut zgjati dorën, e mori rrushin, dhe kur filloi të hante tha: **«Bismil'läh»** - Me emrin e Allahut. Kjo fjalë i shkaktoi habi të madhe Ad'dàsit. Në fakt, atë e ngacmoi kuptimi i besimit që përmbante fjala, si shprehje e një sjelljeje të veçantë dhe si një lidhje që shprehte një shpirt të menduari qiellor, çka ishte e panjohur në besimin e në mendimet e banorëve të Tàifit.

Ad'dàsi foli: «Betohem në Allahun, këtë fjalë nuk e thonë banorët e këtij vendi.»

I Dërguari[a.s.] e pyeti: «Nga cili vend je dhe çfarë feje ke?»

Ai u përgjigj: «Jam i krishterë nga banorët e Ninisë.»

I Dërguari [a.s.] e pyeti përsëri: «Aha, qenke prej fshatit të burrit të mire, Jùnus bin Met'tà?»

Ad'dàsi mbeti i habitur nga kjo fjalë dhe ashtu i habitur, e pyeti të Dërguarin: «Kush ta ka mësuar ty se ç'ishte Jùnusi?»

I Dërguari [a.s.] u përgjigj: «*Ai është vëllai im, ai ishte profet, edhe unë jam profet.*»

Ad'dàsi u gëzua për atë që dëgjoji dhe bashkëbisedimi e qëndrimi i të Dërguarit [a.s.] lanë gjurmë të thellë në shpirtin e tij e prandaj ai filloi të puthte duart e këmbët e të Dërguarit të Allahut. Ndërkaq, Utbeh dhe Shejbeh po vëzhgonin dialogun dhe përgjonin se ç'do të ndodhte dhe njëri për tyre i tha tjetrit: «Shiko se shërbyesi yt po i thotë atij gjëra të këqija kundër teje.»

Utbeh dhe Shejbeh u përpoqën shumë ta bindnin Ad'dàsin se feja e tij ishte më e mirë se feja islame; ata u përpoqën ta ndalonin atë që të mos ndikohej nga thirrja e të Dërguarit, por nuk patën sukses. Ad'dàsi besoi dhe hyri në fenë islame. I Dërguari u kthye, po përveç Ad'dàsit atij nuk i besoi tjetër nga banorët e Tàifit. Megjithatë, Profeti [a.s.] u kthye plot vendosmëri për të ecur përpara në rrugën e thirrjes islame dhe as qëndrimet e ashpra e as pengesat që do të vinin armiqtë nuk do ta ndalonin dot Shpalljen e tij. Profeti [a.s.] u kthye prej Tàifi i brumosur me mësimin më të ndritur në luftën në rrugën e Allahut dhe të thirrjes në rrugën e Allahut të lartësuar. Ai u kthye, por nuk kishte mundësi të hynte në Mek'kë pa mbrojtjen e pa shoqërimin e Mut'am bin Adijit, i cili e shoqëroi si fqinj që ishin dhe e mbrojti të Dërguarin e Allahut.

Përmbledhje

Pas vdekjes së Ebù Tàlibit, xhaxhait të Profetit [a.s.] dhe vdekjes së nënës së besimtarëve, Hadixhes, Kurejshët i shtuan shumë mundimet e egërsinë e tyre kundër të Dërguarit të Allahut, kundër thirrjes islame dhe kundër shokëve të tij. Prandaj, i Dërguari [a.s.] doli nga Mek'ka që të vazhdonte thirrjen islame dhe shkoi në Tàif te fisi Thekijf. Ai i ftoi thekifët në fenë e re, por asnjë njeri nuk iu përgjigj thirrjes së tij, madje ata u tallën dhe e munduan Profetin [a.s.]. Kështu, ai u kthye në Mek'kë, por nuk kishte mundësi të hynte. Ai hyri në Mek'kë vetëm falë dorëzanësisë së Mut'am bin Adijit. Në rrugën e tij të kthimit nga Taifi u takua me një njeri, i cili i besoi profetnisë së tij dhe hyri në Islam.

Diskutim

1 - Kur u shtuan mundimet e kurejshëve dhe armiqësia e tyre kundër Profetit [a.s.] e shokëve të tij dhe si ishte kjo?

2 - A iu përgjigjën thekifët thirrjes islame dhe si e trajtuan ata të Dërguarin [a.s.]?

3 - Si është ndodhia e Profetit [a.s.] me Ad'dàsin?

4 - A u hidhërua i Dërguari i nderuar nga ajo që pësoi prej thekifëve?

5 - Përfitojmë nga ky mësim në fushën e thirrjes në rrugën e Allahut dhe përhapjen e mëtejshme të Islamit?

ISR•JA DHE MI'R•XHI
(Udhëtimi natën dhe ngjitja
në lartësitë e qiejve)

«Ai që është i Plotpushtetshëm e që nuk i mungon asgjë e kaloi robin e Tij në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit në Mesxhidi Aksà, rrethinat e së cilës Ne i kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga argumentet Tona; me të vërtetë, Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.» (“*El Isrà*”, 1).

Njohje

Allahu e ka përveçuar Profetin tonë Muham'medin [a.s.] me mrekulli të shumta, ndër të cilat është edhe mrekullia e Isràsë dhe e Mi'ràxhit. **Isrà** është ecja natën e Profetit Muham'med [a.s.] prej Mek'kës deri në Bejti Makdis me një shpejtësi të madhe, tej kufijve, me të cilët janë përshtatur njerëzit. **Mi'ràxh** është ngjitja në lartësitë e qiejve dhe arritja atje ku nuk është e mundur të arrijë ndonjë njeri pa lejën e Allahut. Isràja dhe Mi'ràxhi kanë ndodhur me fuqinë e Allahut dhe janë dy nga mrekullitë e të Dërguarit të nderuar, Muham'medit [a.s.]. Asnjë njeri nuk e ka mundësinë ta bëjë këtë veprim.

Shpjegim

Ishte në vullnetin e në dëshirën e Allahut që Ai të bënte për Profetin e Tij të nderuar një mrekulli të madhe. Për këtë, Allahu çoi Xhibrijlin [a.s.] te Profeti [a.s.]. Kur erdhi në Mek'kë, Xhibrijli [a.s.] e njoftoi Profetin [a.s.] se Allahu e kishte urdhëruar që të shkonte në Mesxhidil Aksà së bashku me të (Xhibrijlin [a.s.]). Ishte Xhibrijli ai që e nxori Profetin [a.s.] prej Mekës, e hipi mbi Burak (krijesë që i ngjante një kafshe mes mushkës e gomarit) dhe u nisën për në Bejti Makdis me shpejtësi të madhe. Kur arritën në Bejti Makdis, ai e lidhi Burakun në verigën ku e kanë pasë lidhur profetët e tjerë. I Dërguari [a.s.] gjeti aty profetët Ibràhijm, Mùsà dhe Ijsà, si dhe një grup prej profetëve të nderuar të Allahut. I përshëndeti ata me “Selam!” dhe pastaj u përgatit të falte namaz. Xhibrijli e urdhëroi Profetin [a.s.] të falte namaz së bashku me profetët e tjerë dhe ai u priu atyre në faljen e namazit. Pastaj, Xhibrijli [a.s.] u ngjit në lartësitë e qiejve së bashku me Profetin [a.s.]. atje Profeti [a.s.] u njoh me argumentet e mëdha të Allahut; ai pa Xhen'netin e Zjarrin. Pastaj Xhibrijli e ktheu përsëri në Mek'kë brenda asaj nate dhe brenda një kohe të shkurtër. Kur u kthye në Mek'kë nga Bejti Makdisi, Profeti [a.s.] njoftoi kurejshët rreth asaj që i kishte

ndodhur; ata nuk i besuan, madje e braktisi Islamin edhe ai që e kishte besimin e dobët. Kurejshët thanë: “Nëse thua të vërtetën, na e përshkruaj Bejti Makdisin.” Allahu ia shfaq Profetit [a.s.] Bejti Makdisin dhe ai filloi t’ua përshkruajë atyre me të gjitha hollësitë. Atëherë, ata i thanë: “Na thuaj se ku është vargani i deveve tona që janë në rrugë, a i ke parë?” Profeti [a.s.] u tha se devetë ishin në rajonin Ten’ijm, një fshat afër Mek’kës dhe se varganarët ishin duke kërkuar një deve që kishte humbur. Profeti u tha gjithashtu se vargani do të arrinte me lindjen e diellit dhe se në krye printe një deve e kuqe. Kurejshët, me qëllim që ta përgënjeshtrojnë Profetin [a.s.], dolën në hyrje të Mek’kës dhe u ulën të prisnin lindjen e diellit. Kur lindi dielli, njëri prej atyre që ishin pritur, pa devetë që po vinin. Kur vargani arriti, i njoftuan ata se kishte humbur një deve dhe se ata ishin vënë në kërkim të saj. Ja, me këtë mrekulli e vërtetoi Allahu vërtetësinë e Profetit të Tij.⁽¹⁾

Kur’ani kerijmi flet për Isrànë e Mi’ràxhin pikërisht në suren “El-Isrà” dhe në suren “En’Nexhm”, por idhujtarët vazhduan të këmbëngulnin në përgënjeshttrimin e Profetit [a.s.] dhe të mos e besonin fjalën e tij. Mrekullia e Isràsë dhe e Mi’ràxhit ka ndodhur në vitin e shtatë të Hixhretit.

(1) Et’Tabresij, “T’lâmul-Uerâ bi a’lâmil-hudâ”.

Kur kurejshët e panë se Profeti [a.s.] thoshte të vërtetën e prandaj nuk kishin se si ta hidhnin poshtë atë mrekulli, u mbledhën në atë pjesë të Qabes që ata e quanin Dàru-n’Nedueh – kuvendi – dhe aty vendosën të impononin rrethimin e bojkotit kundër të Dërguarit të Allahut dhe kundër fisit Beni Hàshim dhe pasuesve të Profetit; ata vendosën gjithashtu, ta vrisnin Proftin [a.s.] ose të bënin komplot kundër tij. Ebù Tàlibi mbledhi fisin Beni Hàshim dhe hynë në Shu‘ab së bashku me Muham’medin [a.s.] e me shokët e tij. Vetë Ebù Tàlibi qëndroi në rojë të Profetit [a.s.] dhe në ruajtje të tij prej .

MĠRGIMI I TĠ DĠRGUARIT [a.s.] NĠ MEDINE

Allahu i lartësuar e përshkruan për ne emigrimin e të Dërguarit [a.s.] me fjalën e Tij: **«Nëse ju nuk e ndihmoni, atë e ka ndihmuar Allahu, atëherë kur ata që e nxorën atë vetë i dytë dhe kur të dy ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet: ‘Mos u dëshpëro, Allahu është me ne.’ Allahu zbriti në të qetësinë dhe e fuqizoi atë me një ushtri që ju nuk e patë; kurse fjalën e atyre që nuk besuan, Ai e bëri më të ultën; më e larta është fjala e Allahut; Allahu është i Gjithëfuqishmi, më i Urti.»** (*“Et’Tenbeḥ”, 40*). Profeti [a.s.] doli para syve të bandës që i kishin rrethuar shtëpinë dhe po mundoheshin ta vrisnin.

Megjithkëtë, ata nuk e ndien atë, ndërsa dilte duke kënduar ajetin e nderuar: **«Para tyre. Ne kemi bërë një digë dhe një digë mbrapa tyre; Ne ua kemi mbular atyre sytë dhe ata nuk shikojnë.»** (*“JāSijn”, 9*). Rrethuesit qëndruan gjithë natën grumbull dhe po përpiqeshin të suleshin mbi të, por Allahu nuk ua mundësoi realizimin e qëllimit. Në mëngjes, Ali bin Ebi Tālībi u ngrit nga shtrati i të Dërguarit të Allahut dhe kur ata nuk panë të Dërguarin [a.s.], u befasuan dhe pyetën: “Ku është Muham’medi?” Ali bin Ebi Tālībi u tha: «Ju i thatë atij dil prej nesh dhe ai doli prej jush.» Kurejshët panë se i kishin humbur shpresat dhe kishin pësuar disfatë. Megjithatë vendosën të viheshin në kërkim të të Dërguarit [a.s.], që të vinin në jetë krimin e tyre të shëmtuar.

Kurejshët në kërkim të të Dërguarit [a.s.]

Kur kurejshët e kuptuan se i Dërguari i kishte shpëtuar komplotit të tyre, u turrën në drejtim të shkretëtirës në kërkim të tij, por nuk e gjetën dot. Ndërkaq, i Dërguari, me qëllim që t’u largohej kurejshëve, kishte marrë rrugën më të afërt

pranë detit, rrugën që lidh Mek'kën me Medinen. Në këtë migrim atë e shoqëronte Ebù Bekri [r.a.]. Udhëtuan të dy derisa arritën në malin Theur dhe aty u fshehën tri ditë me radhë. Ishte Esmà bint Ebi Bekr [r.a.] ajo që u çonte ushqimin fshehtazi. Pas tri ditësh, i Dërguari [a.s.] dhe shoku i tij, Ebù Bekri [r.a.] dolën nga shpella. Kur kurejshët i humbën shpresat për të gjetur vendin ku mund të ishte i Dërguari [a.s.], vunë një shpërblim të majmë prej njëqind deveshë për atë që do t'u sillte ndonjë lajm. Ky shpërblim i madh joshi edhe një burrë, që quhej Suràka. Suraka shalo i kalin dhe u lëshua në kërkim të të Dërguarit [a.s.]. Por Allahu, i Cili nuk ka nevojë për asgjë dhe është plotësisht i pastër nga mangësitë, bëri që të vinte një mrekulli e madhe për të Dërguarin [a.s.]. Këmbët e kalit të Suràkas u ngulën thellë në tokë. Suràka u nis tri herë radhazi, po përsëri këmbët e kalit futeshin gjithnjë e më thellë në tokë. Atëherë, Suràka i kërkoi ndihmë të Dërguarit të Allahut; ai kërkonte prej tij falje: “O Muham'med, - tha, - unë e mora vesh se ai që i nguli këmbët e kalit tim në tokë, ecte para teje; prandaj lute Zotin tënd që të lirojë këmbët e kalit tim! Betohem për jetën time se, nëse prej meje nuk keni ndonjë të mirë, kurrë nuk do të keni ndonjë të keqe.” Dhe i Dërguari [a.s.] iu lut Allahut që ta lironte kalin e Suràkas. Allahu i lartësuar e liroi kalin, por Suràka nuk e mbajti fjalën dhe u lëshua në kërkim të të Dërguarit të Allahut për herë të dytë. Përsëri i kërkoi falje të Dërguarit [a.s.] dhe përsëri Profeti [a.s.] iu lut Allahut që ta lironte kalin e tij dhe Allahu e liroi kalin. Suràka u kthye për herë të tretë në kërkim të Profetit [a.s.] dhe përsëri këmbët e kalit fundoseshin në tokë. Edhe kësaj here, Suràkah i kërkon falje të Dërguarit [a.s.] dhe kur këmbët e kalit u liruan edhe kësaj here, ai tha: «O Muham'med, ja ku i ke devetë e mia; me devetë është edhe skllavi im; nëse të duhen për t'u hipur, ose ke nevojë për qumësht, merr. Unë po ngul edhe shigjetën e harkut tim si shenjë, unë po kthehem dhe ta përsëris edhe një herë kërkesën.” Por Profeti [a.s.] i tha: *«Nuk kemi nevojë për ato që ke ti.»*⁽¹⁾ Suràka u kthye mbrapsht pasi e pa mrekullinë me sytë e ballit dhe e dëgjoi premtimin e të Dërguarit të Allahut, premtim që e la pa mend dhe i shkaktoi hutim në shpirt. I Dërguari i Allahut i tha atij: *«Si do të dukesh ti, o Suràka kur të stolisesh me byzlykët e Kisrasë?»*⁽²⁾⁽⁰⁾

Me këtë fjalë Profeti [a.s.] dha shenjë për triumfin e Islamit dhe përhapjen e tij në trevat e Persisë, që ishte shteti më i madh i Lindjes në atë kohë.

(1) El-Kulejni, “Err’Rreudatu fil-Kâfij”, f. 263.

(2) Ibn Ethijr, “El-Kâmilu fit’tarijkh”, vëll. 2, f. 105.

(o) El Jà’kùbij, “Tarijkhul Jà’kùbij”, vëll. 2, f. 40; Jàkùbij ka përmendur se Suràka ka folur për mrekullitë e të Dërguarit të Allahut, që ka parë; ai ka thënë gjithashtu, se është takuar me të, por kurejshët e kanë përgënjeshtuar dhe ai që e përgënjeshtroi më shumë ishte Ebù Xhehli. Kurse Ibn Hishàmi ka thënë se Suràka e ka mbajtur të fshehtë takimin me të Dërguarin e Allahut dhe nuk ka folur për asgjë.

NGA MUNDIMET E VUAJTJET E MIGRANTËVE

Migrantët linin Mek’kën njëri pas tjetrit në grupe dhe mbledheshin në Medinen e ndritur për të ndërtuar shoqërinë dhe shtetin, si dhe për të mbartur thirrjen në të gjithë botën. Kurejshët bëheshin gjithnjë e më të egër në torturat e terrorizimin e myslimanëve. Për këtë ata filluan të migronin për në Jethrib burra e gra. Kështu, shumë nga shtëpitë e myslimanëve u mbyllën dhe mbetën të shkretuara, pa njeri brenda që t’i thërrisnin të dashurit e t’i përmendnin poetët. Udhë e thirrjes në Allahun është migrimi dhe lufta në rrugën e Allahut. Ndërkaq, kurejshët shtinin në dorë shtëpitë e pasuritë. Kishin mbetur vetëm fëmijët e të pafuqishmit. Ishin mbyllur shtëpitë e fiseve Beni Madh’un, Beni Xhahsh dhe Beni El Bekijr.

Grabitja e shtëpive dhe e pasurive

Mbahet mend se shtëpia e fisit Beni Xhahsh u braktis nga të gjithë pjesëtarët e fisit: migroi Abdullah bin Xhahsh me familjen e me vëllezërit e tij e shtëpia mbeti bosh të fuste frikën. Kur shtëpia u boshatis nga njerëzit, mbi të u

sulën grabitësit kurejshë. Njerëzit e kishin lënë shtëpinë dhe ishin larguar me nxitim për të ruajtur fenë e tyre; ata morën rrugën e migrimit për hir të Allahut. Shtëpia mbeti si një monument, mbeti një gjuhë që flet e tregon ndodhitë e mizorisë e të shtypjes; ajo tregon për sprovën e rëndë që kaluan të pafuqishmit e ata që nuk kishin përkrahje, por njëherazi, tregon edhe forcën e besimit të myslimanit që nuk njeh përkulje. 'Utbe e ka përjetësuar në vargje këtë ngjarje historike të vogël për nga vëllimi e sipërfaqja, por e madhe për nga e vërteta e kuptimi:

*«Do shtëpi, edhe nëse vazhdon gjatë në mirëqenie,
Një ditë atë do ta zënë pësimet e dëmtimet.»*

Lajmi i grabitjes e i zaptimit të shtëpisë u përhap shumë shpejt, derisa arriti te pronari i saj, i cili u ankua tek i Dërguari i Allahut, por i Dërguari [a.s.] i tha atij: *«A nuk je i kënaqur, o Abdullah që Allahu për këtë shtëpi të të japë një shtëpi më të mirë se ajo në Xhen'net?»* Abdullahi tha: *“Si jo?!”* I Dërguari vazhdoi: *«Kështu do të jetë për ty.»*⁽¹⁾

Kishte ardhur koha që Allahu të derdhte ndihmën për Profetin e Tij dhe Mek'ka u çlirua. Ebù Ahmedi, vëllai i Zejneb bint Xhahshit, me të cilën u martua Profeti [a.s.] më vonë, i parashtroi të Dërguarit të Allahut problemin e kthimit të shtëpisë pronarëve të ligjshëm. Por i Dërguari i Allahut e zvarriti kërkesën e tij, derisa disa nga shokët e Profetit [a.s.] i thanë atij: “O Ebù Ahmed, i Dërguari i Allahut e urren që të kthehen ato pasuri tuajat, për të cilat ju u vutë në sprovë në rrugën e Allahut të lartësuar.” Ebù Ahmedi nuk ia zuri më me gojë të Dërguarit të Allahut problemin e kthimit të shtëpisë.

Ndarja e familjeve myslimane

Historia ka regjistruar edhe lloje të tjera dramash, sprovash të rënda e mundimesh, nëpër të cilat kaluan migrantët, ata thirrës të parë në besimin në Allahun e lartësuar, luftëtarë në rrugën e Allahut dhe të durueshëm në varfëri e në rastet e rrezikut të luftës. Historia i ka regjistruar këto fakte për ne dhe na flet për sprovën e rëndë të një gruaje, e cila së bashku me burrin e saj ka migruar dy herë - në Abisini dhe ndër të parat që ka migruar në Medine. Kjo është Um'm Seleme, gruaja e Abdul Esed bin Hilàlit. Ebù Seleme ishte i pari nga shokët e të Dërguarit të Allahut prej fisit Beni Makhzùm që migroi në Medine dhe ai migroi për në Medine, kur sapo ishte

(1) Ibni Hish'shàm, “Es'sijretu-n'nebevij'jeh”, vëll. 1, f. 145.

kthyer prej migrimit nga Abisinia. Kjo ka ndodhur një vit para Besëlidhjes në Akabe. Kur u vendos që myslimanët të migronin për në Medine, ai mori me vete edhe gruan e tij, Um'm Selemeh,⁽²⁾ e hipi mbi një deve dhe i vuri në

prehër djalin e saj, Seleme. Por atë e pikasën burrat e fisit të saj dhe kur ata mësuan se ajo po migronte bashkë me burrin vet, e ndaluan të shoqin që ta merrte atë në Medine. Dhe, kështu ata ia morën gruan me forcë. Ndërkaq, erdhën aty edhe burrat e fisit Abdul Esed, që ishin fisi i Ebù Selemes, të cilët, kur panë se ata e morën Um'm Selemen bashkë me djalin, u zemëruan dhe u thanë atyre: "Djali i saj është djali ynë dhe nuk lejojmë që ta merrni ju." Filluan të grindeshin për djalin, të cilin e tërhiqnin sa njëri-tjetri, derisa i shkulën dorën dhe vetëm pastaj djalin e morën xhaxhallarët e vet me forcë. Njerëzit e saj e mbanin Um'm Selemen të mbyllur, sepse ajo donte të migronte bashkë me burrin e vet. Mizoria e dhuna bëri që të shpërndahej kjo familje, ashtu siç u shpërndanë edhe shumë familje të tjera. Um'm Seleme [r.a.] tregon: "Burri im, Ebù Seleme u nis me mua për në Medine, por më ndanë nga burri e nga djali im." Ajo vazhdon tregimin: "I do ditë dilja mëngjes për mëngjes dhe rrija në Ebtah, gjithnjë duke qarë. Kështu vazhdova nja një vit. Rastisi që pranë meje të kalonte njëri nga djemtë e xhaxhait tim, të fisit Beni Mugireh. Ai më pa dhe pati mëshirë për mua. U tha njerëzve të fisit Beni Mugireh: 'A nuk e lini këtë të mjeruar të shkojë, e keni ndarë prej burrit e prej të birit.' Ata, - vijon Um'm Seleme - më thanë: 'Nëse dëshiron, shko e bashkohu me burrin tënd!' Pas kësaj edhe ata të fisit Beni Esed më kthyen djalin. I hipa devesë, vura djalin në prehër dhe u nisa të gjeja burrin tim në Medine. Me mua nuk kishte asnjë njeri. Kur arrita në vendin e quajtur Ten'ijm,^(o) takova Osman bin Talha bin Ebi Talha, vëlla i fisit Abdu-d'Dâr. Ai më pyeti: 'Për ku kështu, o bijë e Ebù Um'mej'jes?'

(2) I Dërguari i Allahut është martuar me Um'm Selemeh pas vdekjes së burrit të saj në Medinen e ndritur

(o) Ten'ijm: Emri i një vendi që gjendet larg Mek'kës afërsisht 11 km.

I shpjegova se po shkoja te burri im në Medine dhe ai foli: 'Për Zotin, nuk e kam si të të lë vetëm.' Ndërkaq, mori kapistrën e devesë. Ai u nis së bashku me mua, por betohem në Allahun, nuk kam jam shoqëruar kurrë me ndonjë burrë arab dhe po them se ai është më i ndershmi i të gjithë burrave. Kur mbërrinim në ndonjë vend ku do të ndalonim, ai ulte devenë në gjunjë, pastaj rrinte prapa devesë dhe pasi unë zbrisja, ai e merrte dhe e lidhte devenë në trungun e pemës; pastaj largohej nga unë dhe shkonte të shtrihej nën hijen e pemës; kur vinte koha të niseshim, merrte devenë, e sillte para meje, qëndronte larg meje dhe më thoshte: 'Tani hip!' Pasi të isha rehatuar mbi shpinën e devesë, ai vinte, merrte kapistrën dhe tëhiqte devenë. Kështu ka vepruar derisa më solli në Medine. Kur arritëm në Kubâ, në një fshat të fisit të Amr bin 'Auf më tha: 'Burri yt është në këtë fshat.' Dhe, vërtet, Ebù Seleme kishte qëndruar aty. Këtu Osmani më tha: 'Tani, me bekimin e Allahut hyr!' Pastaj u largua për t'u kthyer në Mek'kë."

Um'm Selemeh thoshte: "Betohem në Allahun, nuk di që ndonjë shtëpi në Islam të ketë pësuar atë që pësoi familja e Ebù Seleme dhe kurrë nuk kam parë shoqërues më të ndershëm se Osman bin Talha." Kështu na flet historia. Ajo na flet për përndjekjet e pionierëve migrantë në rrugën e Allahut, besimtarëve në mesazhin e Islamit, të cilët i përballuan me durim vuajtjet e mërgimit, varfërinë, rrethimin, mundimet, fyerjet e sharjet, torturat, grabitjen e pasurisë, mbajtjen me dhunë të grave e të fëmijëve, ndarjen nga prindërit, ndarjen e çifteve nga të afërmit etj. Por ata, me durimin e me qëndrueshmërinë e tyre shkruan kapitullin më të ndritur të historisë islame, bënë që të forcohen themelet e Islamit në shpirtrat dhe hapën shtegun më të qartë për brezat e bashkësisë islame.

Vetë i Dërguari i Allahut ka migruar i vetëm, që të lëvizte nga një vend në tjetrin për të thirrur në Islam, për të shembur idhujt e kohës së padijes në perandorinë më të fuqishme të kohës së tij, siç ishte perandoria perse e Kistrà bin Hormuzit. Në fakt, ai qysh në atë kohë përgatitej për çlirimin e Persisë dhe për mposhtjen e perandorit Kistrà. I Dërguari i Allahut fliste vetëm me gjuhën e Zbulesës dhe me këtë gjuhë ai shpallte të ardhmen e shkëlqyer të um'metit që beson në Allahun, në Zotin Një e të Vetëm (um'metu-t'teuhijd); me këtë gjuhë ai mbillte në shpirtrat e shokëve të vet shpresën e madhe të triumfit, pavarësisht se hë për hë ishin të pafuqishëm dhe të tjerët bënëin çmos për të mos i lënë që të fuqizoheshin. I Dërguari i Allahut tha plotësisht të vërtetën: myslimanët e çliruan tokën e persëve, triumfuan mbi perandorinë persiane dhe shtinë në dorë kurorën e Kistràsë, stolitë e orenditë e tij të kushtueshme, zotërimet që përfshiheshin nën skeptrin e tij dhe Suràka veshi stolitë e Kistrasë. Në horizontet e Persisë u lartësua thirrja islame, u shua zjarri i mexhusëve (adhuruesve të zjarrit) dhe më pas Persia u bë dhe njëra nga kështjellat e Islamit dhe njëra nga fortesat e besimit në Allahun, në Zotin Një e të Vetëm (Teuhijd).

Përmbledhje

Mbi migrantët u ushtruan mënyrat më të rënda të shtypjes e të mundimeve. Kurejshët grabitën pasuritë e tyre dhe u morën forcërisht shtëpitë. Ata ndanë pjesëtarët e familjeve të migrantëve dhe shumë prej tyre i mbajtën me dhunë, që të mos migronin e të thyenin qëndrueshmërinë e tyre në Islam. Por migrantët nuk u sprapsën dhe vendosmëria e tyre asnjëherë nuk u dobësua: megjithëse lanë pasuritë që kishin, lanë familjet e njerëzit e dashur dhe migruan të ciltër e të përkushtuar për të ruajtur fenë e tyre.

Diskutim

1 – *«do shtëpi edhe nëse i zgjatet koha e mirëqënies,*

Një ditë edhe atë do ta zënë pësimet e humbja.»

Kush e ka thënë këtë vjershë dhe me ç'rast?

2 – Gruaja myslimane ka luajtur rol të madh duke qenë bashkëshoqëruese e besimtarëve migrantë në vuajtjet, në durimin e në qëndrueshmërinë e tyre. Përmendni disa shembuj!

Ahmed bin Xhahsh ka thënë:

«Për tek Allahu e i Dërguari jam drejtuar

dhe cilido që fal namaz,

Për tek Allahu atë ditë fytyra e tij

nuk është shpresëhumbur.»

Kush e ka thënë këtë vjershë. Ëfarë dha ai në rrugën e Islamit?

3 - a) Migrantët kaluan nëpër format më të ashpra të mundimeve e të shtypjes prej idhujtarëve. Përmendni shembuj!

b) Fisni shkurt për vuajtjet e familjes së Ebù Selemes [r.a.] prej idhujtarëve, kur ai deshi të migronte për në Medinen e ndritur.

I DËRGUARI PËRGËZON NËPËR Fiset ME THIRRJEN E TIJ

Edhe pse u ndie keq nga refuzimi që i bënë thirrjes së tij kurejshët dhe banorët e Tàifit, i Dërguari i Allahut u drejtua për kah fiset e tjera arabe duke dhënë përgëzimin e tij me thirrjen islame, pa iu dobësuar vendosmëria dhe pa u tërhequr nga rruga e Allahut. Pavarësisht nga kundërshtimi i ashpër dhe pavarësisht nga vuajtjet e vazhdueshme, Profeti [a.s.], gjithnjë i duruar e me përkushtimin më të lartë, mbante amanetin dhe kumtonte Zbulesën (Shpalljen). Ndërkaq, Kur'ani vazhdonte t'i zbriste pa ndërprerje, çka i jepte siguri dhe i shtonte vendosmërinë, sepse Kur'ani e urdhëronte Profetin [a.s.] ta vazhdonte thirrjen e kumtimit e Shpalljes me urtësi, me këshillë të bukur, e njëheraz, e porosiste të duronte mundimet, sharjet e fyerjet e idhujtarëve.

I Dërguari i Allahut shkoi në disa fise, u takua me to dhe i ftoi në Islam. Ai shkonte nëpër lagjet e tyre dhe nëpër shtëpitë e tyre e u kumtonte thirrjen islame dhe i ftonte në rrugën e drejtë, rrugën e mirëqënies. Ai i përgëzonte ato me të mirat e kësaj bote dhe të Botës tjetër, megjithëse ato e refuzonin thirrjen e tij edhe për shkak se xhaxhai i tij, Ebù Lehebi e ndiqte Profetin [a.s.] nga pas kudo që ai shkonte, duke u gërthitur njerëzve të fiseve: “Muham’medi është gënjeshtar i madh, prandaj mos i besoni!” I Dërguari i Allahut shkoi në fisin Kindeh, hyri në shtëpitë e tyre dhe i ftoi ata në Islam. Ata nuk e pranuan thirrjen e tij. Shkoi në shtëpitë e fisit Beni Hanijfeh. Edhe atyre u parashtrroi Islamin. Ata jo vetëm e përzunë me të keq, por edhe e përgënjeshtroan. Më pas, gjatë periudhës së Haxh’xhit, Profeti [a.s.] u takua me fisin Beni Amir bin Sa’sameh dhe i ftoi ata në Islam e kërkoi që ata të besonin dhe të vërtetonin thirrjen e tij. Njëra nga antaret e atij fisi tha: “Po të të besojmë e të të ndihmojmë ty dhe të arrihet fitorja, ti a na bën ne të parë dhe komandantë pas fitores?” I Dërguari i Allahut nuk e pranoi këtë kusht, por u tha atyre: *«Është në dorën e Allahut dhe Ai e vë atë aty ku dëshiron.»* Atëherë, ata nuk pranuan as të besonin e as të ndihmonin të Dërguarin [a.s.]. “Qysh të të ndihmojmë, - i thane ata, - dhe çështja pas teje të jetë në dorën e një tjetri e jo në dorën tonë?”

Përmbledhje

Kurrë nuk u dobësua vendosmëria e të Dërguarit [a.s.] dhe kurrë nuk u tërhoq ai nga mospranimi i thirrjes islame prej kurejshëve dhe thekifëve, por u drejtua për kah fiset e tjera që t'i ftonte edhe ata në Islam. Edhe pse fiset e refuzuan thirrjen e tij, përsëri ai u bëri thirrje të gjithëve.

Diskutim

1 - Thoni emrat e disa fiseve ku i Dërguari [a.s.] bëri thirrje të hynin në Islam, por ata nuk e pranuan thirrjen e tij.

2 - Thirrja e të Dërguarit të Allahut u prit me mospranim në Mek'kë e në Ta'if, por triumfi i thirrjes dhe përhapja e saj nuk mbeti e mbyllur, pavarësisht mospranimit të tyre?

3 - «Është në dorën e Allahu dhe ai e vë atë ku dëshiron.» Kush e ka thënë këtë fjalë dhe si është ndodhia që ka lidhje me të?

I DËRGUARI [a.s.] TAKOHET ME DELEGACIONIN E JETHRIBIT

Gjatë Haxh'xhit, i Dërguari [a.s.] takohej me delegacionet e arabëve, takohej me pjesëtarë të fiseve dhe me krerë të fiseve, me qëllim që t'u bënte atyre thirrje të hynin në Islam; që të gjithë as nuk e pranonin thirrjen e tij dhe as nuk i përgjigjeshin asaj. Megjithatë i Dërguari [a.s.] tregohej i duruar dhe vazhdonte të bënte thirrje për besim në Allahun me venmdosmëri dhe me besim të patundur. Afërsisht dy vjet para migrimit të tij, gjatë Haxh'xhit, në vendin e quajtur Akabeh, i Dërguari i Allahut u takua me delegacionin e fisit Khazrexh. Ishin gjashtë burra,⁽¹⁾ të ardhur nga Jethribi (Medinia e ndritur). I Dërguari [a.s.] i pyeti ata se cilët ishin dhe ata thanë: "Jemi nga khazrexhët." Profeti [a.s.] u kërkoi atyre të rrinin se donte të bisedonte me ta dhe ata u ulën. I Dërguari [a.s.] e filloi bisedën me ta dhe u bëri thirrje të hynin në Islam; u këndoi edhe një pjesë nga Kur'ani. Fjalët e të Dërguarit [a.s.] si dhe Kur'ani që u këndoi lanë gjurmë në shpirtrat e tyre. Në çast ata bënë lidhjen në mes thirrjes që sapo dëgjuan dhe asaj që kishin dëgjuar prej jehudëve. Jehudët i kërcënonin ata se një profet prej racës së tyre do të shfaqej së shpejti dhe se ata, d.m.th., jehudët do të luftonin kundër tyre me këtë profet dhe se do t'i vrisnin ata. Në atë kohë, armiqësia e grindjet ishin të pranishme në mes arabëve idhujtarë dhe jehudëve

që besonin në një libër qiellor. Jehudët i dinin cilësitë e të Dërguarit [a.s.] dhe shenjat e shfaqjes së tij, sepse i kishin nëpër librat e tyre, por ata besonin se profeti që ata prisnin, patjetër duhej të ishte prej racës së tyre; prandaj i kërcënonin banorët idhujtarë të Jethribit me shfaqjen e këtij profeti.

(1) Thuhet se kanë qenë shtatë burra.

Biseda e të Dërguarit [a.s.] i bëri ata t'i thonë njëri-tjetrit: «Ju e dini mirë, për Allah, se pa dyshim, ai është profeti me të cilin na kërcënojnë jehudët, por ata nuk do të jenë të parët tek ai.»⁽²⁾

Ata e vërtetuan fjalën e tij e i besuan atij; njëkohësisht, e njoftuan për urrejtjen, grindjet e luftërat që kishte ndërmjet dy fiseve arabe, ndërmjet eusëve dhe khazrexhëve dhe i thanë: «Mbase Allahu me ty do t'i bashkojë ata, prandaj le të shkojmë tek ata dhe t'u bëjmë thirrje për çështjen tënde dhe t'u themi atyre se ne t'u përgjigjëm ty për këtë fe; nëse Allahu do t'i bashkojë ata në këtë fe, nuk do të ketë njeri më të dashur se ti...»⁽³⁾

Kështu, filloi të përhapej thirrja islame jashtë Mek'kës dhe kështu, njerëzit nisën të hynin në Islam. Me këtë takim fillon etapa e re e një triumfi i madh për Islamin. Ata burra bënë thirrje në Medine; ata u bënë bartësit e përgëzimit në njerëzit e tyre; ata filluan të përhapnin Islamin në Medine dhe t'u flisnin njerëzve për çka kishin dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut. Në Medine, Islami filloi të përhapej dhe njerëzit nisën të besonin në këtë fe madhështore, për të mirat që gjetën në të; në këtë fe ata gjetën udhëzimin për në rrugën e drejtë dhe pajtimin, gjetën themelet për unitetin e tyre dhe fundin e armiqësisë në mes tyre.

Besëlidhja e parë e Akabesë

Në Jethrib Islami pati përhapje mjaft të madhe. Thirrja islame u bë biseda e shpresa e banorëve të Jethribit. Pas një viti, qysh nga takimi i parë në Mek'kën e nderuar, me rastin e periudhës së Haxh'xhit, ata po përgatiteshin të takoheshin me të Dërguarin e Allahut dhe, ishte dëshira e Allahut që ata të takoheshin me të në vendin e quajtur Akabeh. Ata i dhanë besën të Dërguarit të Allahut dhe lidhën një marrëveshje me të. 'Ubàdeh bin Sàmit tregon: “

(2) Et'Taberij, “Tàrijkhu-t'Taberij”, vëll. 2, f. 86.

(3) Burimi i mësipërm.

Isha ndër dymbëdhjetë burrat e takimit të parë në Akabeh që i dhanë besën të Dërguarit të Allahut si më poshtë: Nuk do t'i bëjmë shok e ortak Allahut askënd e asgjë, nuk do të vjedhim e nuk do të bëjmë imoralitet, nuk do t'i vrasim fëmijët tanë, nuk do të bëjmë shpifje as ndërmjet nesh e as në të tjerët,

nuk do ta kundërshtojmë Profetin në punët e mira. Më tej besëlidhja ishte: Nëse do ta mbani besën e dhënë, do të gëzoni mirësitë e Xhen'netit. Nëse ju e mbani të fshehur fajin deri në Ditën e Gjykimit, çështja juaj është në gjykimin e Allahut; nëse Ai dëshiron, ju dënon dhe nëse do, ju fal...»⁽¹⁾ Kjo marrëveshje është quajtur “Besëlidhja e parë e Akabesë”. Kështu, ata u zotuan para të Dërguarit të Allahut që të besonin Allahun, profetinë e Muham'medit [a.s.], të hiqnin dorë nga punët e liga dhe të bënin punë të mira.

Me qëllim që Islami të ngulitej mirë në shpirtat e tyre, që thirrja islame të përhapej në mjediset e tyre dhe që ata ta kuptonin Islamin mirë e drejt, Profeti [a.s.] dërgoi me ta shokun e tij, Mus'ab bin 'Umejr, që t'i thërriste ata në Islam, t'u mësonte atyre Kur'anin, t'i drejtonte ata në rrugën e drejtë dhe t'i njihte ata me Sheriatin, me dispozitat e ligjit të fesë. Ata u kthyen në familjet e veta. Mus'ab bin 'Umejrin e strehuan në shtëpinë e Es'ad bin Zeràres. Pikërisht nga kjo shtëpi, në Medinen e ndritur, Mus'ab bin 'Umejri filloi t'u këndojë atyre Kur'anin dhe t'u mësojë atyre dispozitat e Islamit. Mus'ab bin 'Umejri është mësuesi i parë në Islam dhe myslimanët e Medines e quanin “lexuesi”. Me ardhjen e Mus'abit në Jethrib, Islami mori një përhapje të gjerë dhe në qytetin e bekuar ndodhi një ndryshim shumë i madh: në besimin, në moralin, në sjelljet dhe në marrëdhëniet në mes njërëzve. Ndryshimi ishte në përputhje të plotë me parimet islame, për të cilat ata i kishin dhënë besën të Dërguarit të Allahut. Hyrja në Islam e disa personaliteteve të mëdha të Medines, pati ndikim shumë të fuqishëm në shoqërinë e qytetit.

(1) Et'Taberij, “Tàrijkhu-t'Taberij”, vëll.: 2, f. 88.

Në Islam hynë edhe dy nga krerët e Medines - Usejd bin Hudejr dhe Sa'd bin Mu'adh.Ja, kështu filloi të formohej shoqëria islame dhe të dilte në dukje forca e Islamit në Medine. Myslimanët e Mek'kës që nuk kishin mbrojtje, filluan të migronin drejt Medines, sa herë që mbi ata ashpërsoheshin mundimet e torturat e kurejshëve. Me urdhër të Profetit [a.s.] dhe me orientimin e tij, ata linin vendin e vet për të ruajtur fenë dhe për t'u bashkuar në Medine me vëllezërit e tyre mikpritës e ndihmëtarë, (ensarët, vendësit). Ensarët prisnin migrantët e Mek'kës, i sistemonin nëpër shtëpitë e veta dhe u jepnin atyre çdo përkrahje e ndihmë.Kur Mus'ab bin 'Umejri pa se Islami u zgjerua në mes eusëve e khazrexhëve, shpirti i dashurisë e i vëllazërisë u përhap në mes tyre dhe gjendja nuk ishte më ajo e para, kur ishin në armiqësi me njëri-tjetrin, i shkroi të Dërguarit të Allahut dhe i dha lajmin e gëzueshëm për këtë fakt.

Përmbledhje

Pas arritjes së gjashtë burrave të fisit Khazrexh, që i dhanë besën të Dërguarit të Allahut, në Jethrib filloi përhapja e Islamit. Vitin e dytë, u nisën dymbëdhjetë burra të takoheshin me të Dërguarin e Allahut në Akabeh, të cilët i dhanë besën dhe lidhën një marrëveshje me të. I Dërguari i Allahut çoi në Medine bashkë me ta Mus'ab bin 'Umejrin, që t'u këndonte atyre Kur'an dhe t'u mësonte dispozitat e Islamit. Me këtë veprim Islami mori një përhapje të gjerë në Jethrib. Marrëveshja u quajt "Besëlidhja e parë e Akabesë".

Diskutim

1 – Cilat ishin parimet islame, për të cilat i dhanë besën dymbëdhjetë ensarët të Dërguarit të Allahut?

2 – a) Cili është thirrësi i parë në Islam në Medinen e ndritur dërguar nga Profeti [a.s.]?

b) A dëshironi të jeni thirrës në Islam siç qe Mus'ab bin 'Umejri dhe përse?

3 – Ndër faktorët e përhapjes së thirrjes islame në Medine ishte edhe hyrja në Islam e disa personaliteteve të mëdha. Kujtoni emrat e dy prej tyre!

4 – A e ndryshoi Islami frymën e armiqësisë e të urrejtjes?

5 – Eusët e khazrexhët ishtin në armiqësi para hyrjes së Islamit në Jethrib. Përdodhi pas hyrjes së tyre në Islam?

Besëlidhja e dytë e Akabesë

Islami ishte përhapur në Jethrib e ishin shtuar ensarët që kishin përqafuar Islamin. Një grup prej tyre biseduan në mes tyre që gjatë kohës së Haxh'xhit të shkonin tek i Dërguari [a.s.]. Me këtë qëllim, ata udhëtuan për në Mek'kë, të maskuar në mesin e mohuesve të popullit të tyre, që edhe ata të shkonin në Mek'kë. Askush nga mohuesit nuk e mori vesh qëllimin e tyre. Ata ishin shtatëdhjetë burra e dy gra. Kur arritën në Mek'kë, u mbodhën me të Dërguarin e Allahut e biseduan me të. I Dërguari (s.a.v.s.) u foli atyre për Islamin, u këndoi pjesë nga Kur'ani kerijmi, pastaj u kërkoi mbrojtje për vete e për thirrjen islame, nëse do migronte për tek ata. Ata ishin në një fjalë - për ta ndihmuar të Dërguarin e Allahut e thirrjen e tij me të gjitha mundësitë dhe për këtë i dhanë besën. Kjo besë u quajt "Besëlidhja e dytë e Akabesë", sepse edhe ajo u bë po në vendin e quajtur Akabeh, pas Besëlidhjes së parë. Në mbarim të bisedimeve, i Dërguari i Allahut u tha atyre: *«Ju jeni si unë dhe unë jam si ju, bëj paqe me atë, me të cilin ju bëni paqe dhe luftoj me atë që luftoni ju.»*⁽¹⁾

Në këtë besëlidhje i Dërguari i Allahut zgjodhi dymbëdhjetë burra prej ensarëve dhe i caktoi kryetarë të njerëzve të tyre. I Dërguari i Allahut u tha atyre: *«Më nxirrni prej jush dymbëdhjetë kryetarë, të cilët të përkujdesen për ju për këto*

punë, ashtu siç mori edhe Mûsâi prej Beni Israijlëve dymbëdhjetë kryetarë!”

(1) Ibn Ethir, “El-Kàmilu fit’Tàriikh”, vëll. 2, f. 98-99. botim i vitit 1385H.

Ata i thanë: “Zgjidh cilin të dëshirosh!” Dhe, Xhibrijli [a.s.] i bëri shenjë për tek ata dhe kështu, i Dërguari [a.s.] i caktoi kryetarët; nëntë veta i zgjodhi prej khazrehëve dhe tre prej eusëve.⁽²⁾

Kështu përfundoi Besëlidhja e Akabesë. Megjithëse kurejshët e zbuluan atë mbledhje historike dhe pavarësisht nga përpjekjet e tyre për t’iu kundërvënë asaj pune të bekuar, Allahu ua ndaloi duart dhe i mbrojti të Dërguarin e shokët e tij.

Qëndrimi i kurejshëve pas Besëlidhjes së dytë të Akabesë

Kurejshët e morën vesh se i Dërguari i Allahut kishte lidhur aleancë me eusët e khazrehët dhe se Jethribi (Medinia e ndritur) ishte bërë kështjellë për myslimanët. Ata mësuan, gjithashtu se thirrja islame kishte gjetur në Jethrib mbështetje e bazë. Kësisoj, kurejshët u frikësuan për interesat e tyre, për tiraninë që ushtronin dhe për idhujtarinë e tyre. Për të gjitha këto, ata i shtuan e i ashpërsuan mundimet e torturat mbi myslimanët. Ata filluan t’i ndalonin myslimanët me forcë, që të mos migronin për në Medine, ngaqë e dinin se i Dërguari i Allahut i kishte urdhëruar ata që të shkonin atje, megjithëse myslimanët edhe më parë patën migruar për të ruajtur fenë e tyre, veç e veç, por edhe në grupe, duke lënë shtëpitë e pasuritë e veta, të cilat kurejshët menjëherë i përvetësonin. Por as ky veprim i tyre nuk e ndali migrimin. Myslimanët vazhdonin të grumbulloheshin në Medine e për pasojë, në këtë qytet po formohej shoqëria islame.

Kur kurejshët panë se thirrja islame po kalonte në një etapë të re dhe ajo po forcohej, po gjente përhapje e përkrahje, u mblodhën në Daru-n Nedueh (Shtëpinë e Kuvendit) e biseduan rreth mënyrës se si t’i rezistonin të Dërguarit të nderuar dhe thirrjes _____

(2) Et’Tabresij, “T’lâmul-Uerâ bia’lâmil-hudâ”, f. 60.

madhështore të Islamit. Disa thanë: “Ta burgosim Muham’medin!”; të tjerë thanë: “Ta nxjerrim jashtë Mek’kës dhe ta internojmë larg tokës sonë! Disa të tjerë e thanë prerë: “Patjetër, duhet ta vrasim.” Së fundi, ranë në një fjalë për ta vrarë të Dërguarin [a.s.]. Për këtë veprim zgjodhën disa nga djemtë e tyre, prej çdo fisi një. Të gjithë së bashku do ta goditnin Muham’medin [a.s.] me shpatat e tyre me një goditje të vetme, kështu që, do të ishin pjesëmarrëse të gjitha fiset në atë vrasje e për pasojë, Beni Hâshimët nuk do të kishin mundësi ta kërkonin gjakun e tij. Kur ata morën vendimin dhe ranë në një fjalë për ta vrarë të

Dërguarin [a.s.], zbriti Xhibrijli te Profeti [a.s.] dhe e njoftoi për komplotin e kurejshëve. Kur'ani kerijmi tregon për atë komplot dhe thotë: **«Kur mohuesit thurnin dredhi kundër teje për të të burgosur, për të të vrarë, ose për të të dëbuar; ata thurnin dredhi, por Allahu është më i miri asgjësues i dredhive.»** (*“El Enfâl”, 30*).

Kur i Dërguari [a.s.] mësoi për këtë kurth, vendosi të largohej e të shkonte në Medine për të vazhduar atje thirrjen e tij, për të ngritur shoqërinë islame dhe për të ndërtuar shtetin e bekuar islam. Pa humbur kohë, i Dërguari [a.s.] filloi të përgatitej për migrim. Ai migroi për në Medine në fillimin e muajit Muharrem, pas trembëdhjetë vjetësh, qysh nga koha kur qe ngarkuar me detyrën e profetnisë. Në shtratin e tij la në gjumë Imam Aliun [r.a.]. Imam Aliu fjeti në shtrojet e të Dërguarit të Allahut derisa e panë kurejshët që po ruanin e vëzhgonin të Dërguarin [a.s.]. Kurejshët kujtonin se i Dërguari i Allahut ishte aty, prandaj as nuk dolën të kërkonin jashtë Mek'kës. Me këtë veprim Imam Aliu [r.a.] është i fljuari i parë për të Dërguarin e Allahut dhe për Islamin. Profeti e kishte lënë që ai t'u dorëzonte të zotëve sendet që kurejshët ia kishin lënë për ruajtje në mirëbesim, duke e porositur që më pas, edhe ai bashkë me Fatimen të niseshin për në Medine e ku do të bashkoheshin me të Dërguarin e Allahut. Në lidhje me këtë ndodhi, Allahu zbriti ajetin me të cilin lavdëron bujtjen e Imam Aliut [r.a.] në shtrojet e të Dërguarit [a.s.].

Ja ajeti: **«Ka njerëz që për kënaqësi të Allahut flijojnë vetveten; Allahu është shumë i mëshirshëm me robtë e Vet.»** (*“El Bekare”, 207*).

Në këtë udhëtim, i Dërguari i Allahut shoqërohej prej Ebù Bekrit [r.a.]. Ai arriti në Medine dhe u strehua. Në Medine, me ndihmën e Allahut, Profeti vazhdoi Thirrjen dhe luftën e tij në rrugën e Allahut.

I Dërguari në Medine

Myslimanët e Medines e kishin marrë vesh se i Dërguari i Allahut ishte nisur për tek ata, prandaj vëzhgonin dhe rrinin në pritje të mbërritjes së tij të begatë. I Dërguari i Allahut u vonua për shkak se u detyrua të fshihej tri ditë në një shpellë e prandaj ishin gjithë frikë dhe u merakosën shumë për të. Ata dilyn pas namazit të sabahut dhe rrinin nëpër hyrjet e Jethribit e qëndronin derisa t'i sfiliste nxehtësia e diellit dhe pastaj ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre.

Një ditë, gjatë ditëve të pritjes, ata, si zakonisht po prisnin ardhjen e të Dërguarit të nderuar, por ata nuk e panë atë dhe kështu, u kthyen nëpër shtëpitë e veta. Ndërsa myslimanët ishin në këtë merak, një jehudi pa dy burra të panjohur dhe pa humbur kohë, u thirri myslimanëve: “Erdhi njeriu që po prisni.” Nxituan menjëherë ensarët. Dhe, ja e panë të Dërguarin [a.s.] ulur nën hijen e një hurme. Sipas disa transmetimeve, ka qenë e hënë. Ensarët u mblodhën rreth tij duke e përshëndetur dhe po garonin se kush e kush do të

ishte mikpritësi i tij. Ndërkaq, ata po bekoheshin duke e parë me sy të Dërguarin e Allahut. I Dërguari i Allahut [a.s.] zgjodhi të ishte mik në shtëpinë e Kulthùm bin Hedmit, nga fisi Beni ‘Amr bin ‘Auf. Në fshatin Kubâ, Ebù Bekri i kërkoi të Dërguarit të Allahut të hynin në Medinen e ndritur, por ai nuk pranoi të largohej nga Kubâ derisa të vinte Ali bin Ebi Tàlibi bashkë me Um’m Ejmenin dhe Fatimen, të cilat kishin migruar së bashku me të dhe ato ishin: Fatimja, vajza e të Dërguarit të Allahut, Fatimja, bija e Esedit, nëna e Ali bin Ebij Tàlibit; Fatimja, vajza e Zubejrit, djalit të Abdul Mut’talibit dhe Fatimja, bija e Hamzait.

I Dërguari i Allahut ndenji në Kubâ, kurse Ebu Bekri u nis për në Medine dhe arriti atje. Kur erdhi Aliu bashkë me gratë, i Dërguari i Allahut e përqafoi dhe qau për të; ai ndiente mëshirë për të, kur shihte gjurmët e lodhjes e të rraskapitjes, kur shihte se ishte aq i dërrmuar, sa i kullonte gjak nga këmbët, ngaqë kishte udhëtuar netve dhe për të mos u zbuluar ditën. I Dërguari [a.s.] ia leu të vrrat e këmbëve me pështymën e tij të bekuar dhe me lejën e Allahut, të vrrat e këmbëve të Aliut u shëruan në çast.

I Dërguari [a.s.] ndërton xhaminë Kubâ

Gjatë qëndrimit në Kubâ, i Dërguari i Allahut ndërtoi xhaminë e Kubâsë sipas propozimit të Am’màr bin Jàsirit. Kjo është xhamia e parë e ndërtuar në Islam. Në këtë xhami, i Dërguari i Allahut ka falur namazin e Xhumasë dhe sipas thënies së disa historianëve, kjo është Xhumaja e parë që ka falur i Dërguari i Allahut.

I Dërguari [a.s.] hyn në Medine

I Dërguari i Allahut qëndroi në Kubâ pesëmbëdhjetë ditë, pastaj i hipi devesë dhe u nis për në Medine. Ishte ditë e Xhuma kur i Dërguari i Allahut hyri në Medine. Atë ditë, ensarët garonin njëri me tjetrin kush e kush të ishte mikpritësi i të Dërguarit [a.s.]. Në çdo lagje të ensarëve, ku kalonte, banorët e lagjes i kërkonin që të zbriste e të shkonte mik tek ata, por ai u thoshte: «I hapni rrugën devesë se ajo është e urdhëruar.»

Vërtet, Profeti [a.s.] ia kishte lëshuar frerët devesë dhe e kishte lënë të ecte në liri të plotë, se e dinte se deveja do të qëndronte mu aty ku kishte vendosur Allahu i lartësuar. Kur deveja arriti në vendin ku sot është xhamia e Profetit, ajo u ul në tokë, afër portës së Ebù Ej’jüb El Ensàriut, njërit prej njerëzve të varfër të Medines. I Dërguari i Allahut zbriti mik në shtëpinë e Ebù Ej’jüb El Ensàriut. Në shtëpinë e tij ka qëndruar derisa përfundoi ndërtimi i Xhamisë së tij të uruar dhe i banesave të tij të pastra.

Ndërtimi i xhamisë së Medines

Pasi i Dërguari i Allahut zuri vend në Medinen e ndritur, në shtëpinë e Ebù Ej'jüb El Ensàriut, puna e parë që ndërmori ishte ndërtimi i xhamisë së tij të bekuar, me qëllim që ajo të ishte qendër mbledhjesh e bashkëpunimi dhe qendër pastrimi e dashurie të ndërsjellë, vendkomada e tij dhe qendra ku do të gjykohej për çështjet që kishin njerëzit në mes tyre; njëherazi, ajo do të ishte selia e administratës së shtetit islam që ai themeloi; xhamia do të ishte, sigurisht vendi ku do të falej namazi e ku do të mbaheshin bisedat fetare, ku do të jepej orientimi e ku do të mësohej Kur'ani dhe Islami, pasi vetëm kështu, do të kishte mundësi i Dërguari [a.s.] të edukonte shokët e tij, t'i mësonte dhe t'i përgatiste ata.

Kjo xhami e nderuar u ndërtua mu në vendin ku u ul deveja e të Dërguarit [a.s.] dhe ku mblidheshin hurmat. Këtë vend Profeti [a.s.] e bleu për dhjetë dinarë, por thuhet edhe se i është dhuruar. Në ndërtimin e xhamisë u mishërua tek të gjithë bashkëpunimi, dhënia përparësi tjetrit dhe mirësia. Vetë i Dërguari i Allahut ka qenë i pari që ka mbartur gurë në krahë për ndërtimin e xhamisë, krah për krah me muhaxhirët dhe ensarët. Xhamia u ndërtua me qerpiç dhe me trungje hurmash e u mbulua me gjethe hurmash.

I Dërguari [a.s.] ndërtoi rreth xhamisë edhe banesat e veta dhe të shokëve të tij. Të gjitha dyert e banesave hapeshin në drejtim të xhamisë. Por, pas njëfarë kohe, i Dërguari [a.s.] i urdhëroi shokët që t'i mbyllnin të gjitha ato dyer, përveç derës së Imam Ali bin Ebi Tàlibit [r.a.], Profeti [a.s.] e la të hapur atë derë në drejtim të xhamisë për respekt të mirësisë së Aliut [r.a.] e në nderim të Aliut. Vendi ku ishin banesat e të Dërguarit [a.s.] përreth xhamisë, vazhdojnë të jenë e të vizitohen edhe sot nga njerëzit. Më vonë, në këto banesa janë vënë dyer të punuara me profile hekuri. Pas disa kohe, i Dërguari [a.s.] e ka rindërtuar Xhaminë e tij dhe e ka zgjeruar. Në ndërtimin e parë xhamia kishte përmasa shtatëdhjetë krahë gjatësi dhe gjashtëdhjetë krahë gjerësi, kurse me zgjerimin e bërë nga i Dërguari [a.s.], xhamia kishte përmasat njëqind krahë gjatësi dhe njëqind krahë gjerësi. Kështu u ndërtua kjo xhami e madhe, kah e cila drejtohen sytë e zemrat e të gjithë besimtarëve.

Vëllazërimi

Nga veprimet e rëndësishme që ndërmori i Dërguari i Allahut kur erdhi në Medinë, ishte vëllazërimi në mes muhaxhirinëve (migrantëve) dhe ensarëve (vendësve). Me këtë veprim të lartë u bënë të qëndrueshme bazat e vëllazërisë e të dashurisë në shoqërinë islame; ashtu siç qe bërë edhe më parë vëllazërimi në mes myslimanëve në Mek'kën e nderuar. I Dërguari i Allahut bëri lidhje vëllazërimi në mes çdo dy vetave dhe ai vetë u vëllazërua me Imam Ali bin Ebi

Tàlibin [r.a.], madje për këtë ngjarje është transmetuar: “Kur i Dërguari i Allahut bëri vëllazërimin në mes shokëve të tij, Aliu tha: “O, i Dërguar i Allahut, e bëre vëllazërimin në mes shokëve të tu, por mua nuk më ke vëllazëruar me asnjë njeri.

Atëherë, i Dërguari i Allahut foli: *«Betohem në Atë që më ka dërguar profet me të Vërtetën se ty të kam lënë në fund për veten time; ti tek unë je në pozitën që ishte Hârûni te Mûsâi, por mbas meje nuk ka më profet; ti je vëllai im, trashëgimtari im, ti je me mua në pallatin tim në Xben’net, së bashku me vajzën time, Fâtimen; ti je vëllai e shoku im.»* Dhe pastaj lexoi ajetin: **«...të vëllazëruar qëndrojnë mbi poltrona përballë njëri-tjetrit.»** (*“El Hixhr”,47*).

Kështu, Profeti i nderuar, Muham’medi [a.s.] vuri themele të forta e të qëndrueshme për ndërtimin e shoqërisë islame. Me këtë vëllazërim ai shkroi një fletë të uruar në mes myslimanëve, ku u shpjegonte atyre në mënyrë konkrete parimet e vëllazërisë, të bashkëpunimit e të miqësisë së vërtetë ndërmjet besimtarëve. Me aktin e vëllazërimit, çdo mysliman e dinte detyrën e përgjegjësinë personale ndaj shoqërisë islame.

Punët më të rëndësishme që bëri i Dërguari [a.s.] fill pasi hyri në Medine

Punët më të rëndësishme që bëri i Dërguari [a.s.] fill pasi hyri në Medine dhe në fillimet e Hixhretit të tij për formimin e shoqërisë islame e për përhapjen e thirrjes islame qenë:

1 – Ndërtimi xhamisë në Kubâ.

2 – Ndërtimi i Xhamisë Profetike

3 – Vëllazërimi në mes muhaxhirëve dhe ensarëve, vëllazërimi i tij me Imam Ali bin Ebi Tàlibin, si edhe shkrimi i fletës për shoqërinë islame të Medines, në të cilin shpjegohej qartë mënyra e vëllazërimit, bashkëpunimit, marrëdhëniet në mes tyre dhe marrëdhëniet me jomyslimanët. Në fakt, ajo fletë ishte një kushtetutë, ishte një akt për organizimin e jetës shoqërore në mes myslimanëve dhe për forcimin e kësaj shoqërie.

4 – Themelimi i shtetit islam.

5 – Shkrimi i një marrëveshjeje në mes tij e jehudinëve që jetonin brenda në Medine dhe të atyre që jetonin rreth saj. Në atë marrëveshje sanksionohej që myslimanët nuk do të sulmoheshin e nuk do të tradhtoheshin dhe në rast lufte, do të kishte bashkëpunim. Por, jehudët e thyen atë marrëveshje dhe siç e kishin zakonet e tyre, i prenë në besë myslimanët. Prandaj, i Dërguari i Allahut [a.s.] për të mbrojtur Islamin, u detyrua të luftonte kundër tyre dhe t’i nxirrte ata jashtë Medines.

6 – Formoi njësitë ushtarake, emëroi komandantët e formacioneve luftarake dhe u dha atyre flamurin e luftës në rrugën e Allahut (xhihàd); sfidoi

idhujtarët dhe i luftoi ata, pasi vazhdimisht ndiehej i hidhëruar që ata jo vetëm nuk e pranonin të Vërtetën, por as nuk hiqnin dorë nga lufta kundër Islamit e myslimanëve.

Përmbledhje

I Dërguari i nderuar Muham'medi [a.s.] e vazhdoi pa ndërprejre thirrjen islame në Mek'kë për trembëdhjetë vjet rresht me urtësi, me këshillën më të bukur, me bashkëbisedim të arsyeshëm e me argumente të forta. Por idhujtarët kurejshë, nën drejtimin e parisë së tyre djallëzore e mendjemadhe nuk e njohën profetinë e tij e këmbëngulën në mohimin e saj; ata përdorën mënyrat më të ndryshme për ta luftuar thirrjen islame, duke filluar me akuzën që i bënin të Dërguarit [a.s.] se na ishte i çmendur e gënjeshtar, qesëndisjen dhe talljen, torturimin barbar të tij dhe të shokëve të tij e deri te vrasja. Në vazhden e mundimeve e të torturave, idhujtarët nuk ngurruan të impononin bojkotin e rrethimin kundër të Dërguarit [a.s.], kundër xhaxhallarëve të tij e kundër atyre që i kishin besuar atij. Më pas, ata vendosën ta vrisnin ose ta burgosnin të Dërguarin [a.s.], por Allahu (xh.sh.) e njoftoi Profetin e Tij me anë të Zbulesës dhe e urdhëroi të migronte në Medine, sepse në atë qytet ai tashmë kishte ndihmës e përkrahës të gatshëm për ta mbrojtur atë dhe Islamin. Profeti [a.s.] migroi për në Medinen e ndritur në fillim të muajit Muharrem. Banorët e Medines e pritën Profetin [a.s.] me gëzim të paparë. Në Medine, i Dërguari i nderuar pati mundësi të formonte shoqërinë islame, shtetin islam e të përhapte thirrjen islame; aty ai formoi edhe ushtrinë e luftëtarëve në rrugën e Allahut dhe me këtë ushtri ai asgjësoi idhujtarinë e djajtë, armiq të Allahut e të njeriut.

Diskutim

1 – Plotësoni frazat vijuese: I Dërguari [a.s.] migroi pasi idhujtarët vendosën..... Në shtrojet e tij fjeti..... Në këtë udhëtim ai shoqërohej nga..... Në rrugë atë e zbuloi..... dhe ndodhi mrekullia fundosjes së këmbëve të kalit të..... në tokë. Hixhreti i tij ka ndodhur në muajin..... pas.....dhjetë vjetësh qysh nga koha e ngarkimit të tij me detyrën e bekuar të profetnisë.

2 – Përse i Dërguari [a.s.] nuk pranoi të hynte menjëherë në Medine, por qëndroi në Kubâ tri ditë?

3 – a) Flisni për ndikimin e vëllazërimit në ndërtimin e shoqërisë islame.

b) Plotësoni frazat vijuese: Puna e parë që bëri i Dërguari[a.s.] pasi hyri në Medine ishte ndërtimi i.....
..... Ai vetë ka marrë pjesë

c) Shpjegoni rëndësinë e madhe të xhamisë në shoqërinë islame.

BETEJA E BEDRIT

Nga jetëshkrimi i të Dërguarit [a.s.] mësuam se thirrja islame në Mek'kë ishte thirrje me fjalë dhe myslimanët kurrë nuk kanë përdorur as armët e as luftën, sepse Allahu i lartësuar nuk i ka urdhëruar për veprime të këtilla; në të kundërt, i Dërguari [a.s.] u bënte thirrje njerëzve me këshillën më të bukur; ai u mësonte e u shpjegonte atyre besimin, moralin dhe dispozitat islame. Vetëm pas Hixhretit të Profetit [a.s.], Allahu i lejoi myslimanët të luftonin dhe kjo për disa arsye:

- 1** – Për të mbrojtur veten e tyre.
- 2** – Për të asgjësuar forcën e djajve, të cilët i pengonin njerëzit të besonin në Allahun e të jetonin nën flamurin e besimit; djajtë kërkonin t'i mposhtnin myslimanët me force e me padrejtësi e t'i skllavëronin ata.
- 3** – Për të përhapur Islamin në të gjitha anët e Tokës, nëse mohuesit nuk i përgjigjeshin thirrjes së udhëzimit për në rrugën e drejtë.

Për të gjitha këto, brenda pak muajve pasi i Dërguari i Allahut kishte hyrë në Medinë, formoi njësitë e ushtrisë e u dha flamurin komandantëve të luftëtarëve në rrugën e Allahut. Pastaj filloi ekspozimi para varganëve të

kurejshëve dhe e para betejë që u zhvillua në mes idhujtarëve e myslimanëve, është beteja e Bedrit. Kjo betejë është zhvilluar në vitin e dytë të Hixhretit, në muajin Ramazan. Myslimanët kishin mësuar se një vargan tregtar kthehej nga Shami për në Mek'kë. Varganin e kryesonte vetë Ebù Sufjani, udhëheqësi e komandanti i idhujtarëve. I Dërguari [a.s.], me synimin që të dobësohej fuqia e idhujtarëve dhe të forcoheshin myslimanët mbi idhujtarët, urdhëroi shokët e tij që t'i zinin rrugën varganit e ta shtinin në dorë, t'i merrnin mallrat e sendet e gjithçka tjetër.

Për këtë qëllim, një grup myslimanësh së bashku me të Dërguarin e Allahut, dolën t'i prisnin rrugën varganit; por Ebù Sufjani, që e kishte marrë vesh planin e myslimanëve, dërgoi me të shpejtë një korrier tek idhujtarët e Mek'kës. Ai kërkonte prej tyre ndihmë për mbrojtjen e varganit. Idhujtarët e Mek'kës u mbledhën dhe përgatitën një ushtri me afro një mijë luftëtarë e u nisën në drejtim të Medines. Ndërkaq, Ebù Sufjani mundi të largohej me shpejtësi dhe kështu ai nuk ra në duart e myslimanëve; njëkohësisht ruajti edhe tregtinë e vet.

Kur kurejshët arritën ku ishin myslimanët, në afërsi të pusit me emrin "Bedr", 160 km. larg Medines së ndritur, vendosën të luftonin me myslimanët. Idhujtarët kurejshë, nga mendjemadhësia e kryeneçësia, nuk pranonin të ktheheshin në Mek'kë pa luftuar. Lufta u zhvillua ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit të bekuar të Ramazanit, vitin e dytë të Hixhretit, mu në Bedr. Myslimanët ishin gjithsej 360 luftëtarë, por Allahu e përkrahu Profetin e Tij; idhujtarët e humbën betejën edhe pse ishin më shumë se dyfishi i myslimanëve e më të pajisur në armatime e në mjete furnizimi. Siç u tha më sipër, ushtria e idhujtarëve kishte afërsisht një mijë luftëtarë, shtatëdhjetë kuaj dhe shtatëqind deve. Në këtë betejë, myslimanët vranë shtatëdhjetë burra prej idhujtarëve dhe zunë rob shtatëdhjetë të tjerë; në këtë betejë u vranë disa nga krerët e heronjtë e idhujtarëve, kurse nga radhët e myslimanëve ranë dëshmorë vetëm katërmëdhjetë veta, gjashtë prej muhaxhirëve dhe tetë prej ensarëve. Heronjtë e betejës nga ana e myslimanëve ishin Imam Aliu [r.a.] dhe Hamza bin Abdul Mut'talibi. Vetëm Imam Aliu [r.a.] ka vrarë atë ditë me shpatën e tij tridhjetë e gjashtë veta nga shtatëdhjetë të vrarët e idhujtarëve, pa folur për ndihmën e tij në vrasjen e trimave të idhujtarëve. Beteja zgjati afërsisht gjysmë dite, sepse pastaj kurejshët ia mbathën nga sytë këmbët. Allahu e theu kryeneçësinë e mendjemadhësinë e tyre dhe ata u kthyen në Mek'kë të poshtëruar e të turpëruar. I Dërguari i Allahut ka falur në Bedr namazin e mbasdites. Pastaj është kthyer në Medinë së bashku me shokët e tij, me plaçkën dhe robërit e luftës. Kjo fitore e madhe pati një efekt me rreze shumë të gjatë veprimi në përhapjen e Islamit e në fuqizimin e tij. Efekti i saj vërtetoi autoritetin e madhështinë e myslimanëve. Lajmi i fitores së madhe u përhap në të gjithë

Gadishullin Arabik. Për pasojë, disa fise nisën të dërgonin delegacionet e tyre te Profeti [a.s.] dhe të hynin në Islam.

Përmbledhje

Allahu i lejoi myslimanët të luftonin sepse mbi ta ishin bërë padrejtësi të mëdha dhe ishin nxjerrë nga shtëpitë e veta. Lufta e Bedrit është beteja e parë që kanë zhvilluar myslimanët kundër idhujtarisë e shtypjes.

Kjo betejë është zhvilluar në vitin e dytë të Hixhretit, ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit Ramazan. Numri i luftëtarëve myslimanë në këtë betejë ka qenë afërsisht treqind e gjashtëdhjetë burra, kurse numri i idhujtarëve ka qenë afërsisht një mijë burra. Në atë betejë, Allahu ka çuar melekët për të ndihmuar myslimanët dhe fitorja u arrit për arsye të besimit, të sinqeritetit e të thjeshtësisë së myslimanëve dhe sigurisht, edhe falë drejtimit e komandimit të urtë të Profetit [a.s.]. Idhujtarët u shpartalluan, thirrja islame u forcua dhe madhështia e myslimanëve u bë realitet.

Diskutim

1- Shpjegoni përse i Dërguari [a.s.] i urdhëroi shokët e tij ta sulmonin varganin tregtar të Ebù Sufjanit?

2 – Thoni arsyet për të cilat Allahu i lejoi myslimanët të luftonin?

3 - a) Cili është heroi më i dalluar i myslimanëve në Betejën e Bedrit?

b) Ku qëndron sekreti i fitores që arritën myslimanët në Betejën e Bedrit, edhe pse ishin të paktë si numër dhe në pajime.

c) A ndikoi fitorja që korrën myslimanët në Betejën e Bedrit në përhapjen e thirrjes islame? Shpjegojeni!

LUFTA ME BENI KAJNUKAT ﷺ

Më sipër u tha se jehudinjtë ishin fqinj me vendbanimet e myslimanëve në Medinen e ndritur. U tha, gjithashtu se ata ishin burim rreziku, spiunazhi, komploti e hipokrizie kundër të Dërguarit [a.s.], kundër myslimanëve dhe kundër thirrjes islame. Pas fitores së myslimanëve kundër idhujtarëve në Betejën e Bedrit, doli hapur urrejtja e smira në shpirtrat e jehudinjve. Ata kishin frikë nga triumfi i Islamit, prandaj e prishën marrëveshjen që kishin bërë me të Dërguarin e Allahut, megjithëse e patën nënshkruar marrëveshjen sapo Profeti [a.s.] kishte ardhur në Medinë. Kur i Dërguari [a.s.] mësoi për këto veprime të jehudinjve, shkoi në tregun e fisit Beni Kajnuka'.⁽¹⁾ Në mbledhjen që organizoi me ta, u bëri thirrje të hynin në Islam me këshillë të bukur e me urtësi, duke u

kujtuar atyre se si Allahu i ndihmoi myslimanët mbi fuqinë e kurejshëve e mendjemadhësinë e tyre në Betejën e Bedrit dhe në fund i paralajmëroi: «*Ruhuni nga ajo që ra mbi kurejshët dhe pranoni Islamin, sepse ju e dini mirë se, me të vërtetë unë jam profet i dërguar.*»⁽²⁾

Jehudinjtë iu përgjigjën Profetit me të keq: «O Muham'med, mos u krekos! Ti u ndeshe me njerëz që nuk kanë haber nga lufta dhe shfrytëzove prej tyre vetëm një rast.»⁽³⁾ Me këtë qëndrim ata e prishën marrëveshjen e lidhur me të Dërguarin [a.s.], sipas së cilës nuk do të kurdiseshin komplete kundër myslimanëve, nuk do të ndihmohej askush kundër myslimanëve dhe do të hiqej dorë nga lufta kundër myslimanëve.

(1) Benu Kajnukatë: Fis jehudi që jetonte afër myslimanëve në Medine dhe merrej me argjendari.

(2) Ibn Ethir, "El-Kàmil fit'Tàriikh", vëll. 2, f. 137.

(3) Burimi i mësipërm.

Ndërsa jehudinjtë po vazhdonin ta refuzonin thirrjen e të Dërguarit të Allahut dhe kërkesën e tij, një grua myslimane kishte ardhur në tregun e Beni Kajnukave dhe kishte hyrë në dyqanin e një argjendari për të blerë bizhuteri. Kur ajo po shihte me vëmendje stolitë, vjen një jehudi dhe i ngre fundin e rrobës mbi shpinë dhe, kur gruaja drejtoi trupin, iu zbuluan kofshët. Jehudët e qesëndisën gruan dhe qeshën e u tallën me të. Ky veprim i ndyrë i jehudëve shkaktoi reagimin e një myslimani që u ndodh aty; ai e pa veten të prekur në sedër, prandaj ai u turr mbi atë jehudinë dhe e vrau.

Qëndrimet në mes jehudëve e myslimanëve po acaroheshin gjithnjë e më shumë, derisa ata shpallën botërisht prishjen e marrëveshjes që kishin nënshkruar me të Dërguarin e Allahut. Kur i Dërguari i Allahut pa këtë qëndrimin armiqsor të jehudinëve dhe prishjen e njëanshme të marrëveshjes nga ana e tyre, u shpalli luftë atyre, sulmoi fshatin e jehudinëve dhe e mbajti të rrethuar pesëmbëdhjetë ditë me radhë, derisa ata u nënshtruan para forcës së myslimanëve. Myslimanët i kapën ata. Pasi i lidhën, deshën t'i ekzekutonin, por ndërhyri kreu i munafikëve (hipokritëve), Abdullah bin Ubej bin Selùli, i cili i kërkoi të Dërguarit të Allahut t'i falte, sepse në kohën e padijes kishin qenë aleatët e tij. I Dërguari i Allahut e hodhi poshtë kërkesën e tij dhe nuk i foli fare; por ai këmbënguli tek i Dërguari i Allahut dhe e kërcënoi se do të ndodhnin ngatërresa. Kur i Dërguari i Allahut e mendoj këtë problem, u tha shokëve të vet: «*Hapuni rrugë atyre, që i mallkoftë Allahu!*»; i mallkoi edhe vetë bashkë me të tjerët. Myslimanët e nxorën këtë fis jehudësh jashtë Medines dhe ata shkuan e zunë vend në një zonë të Shamit, që quhet Edhruat.

Myslimanët morën plaçkën e luftës e pasuritë e tyre dhe i ndanë ndër luftëtarët. Kjo luftë ka ndodhur në muajin Sheu'uâl të vitit të dytë të Hixhretit.⁽⁴⁾ Më pas, i Dërguari [a.s.] u kthye në Medinen e ndritur.

(4) Thuhet se ajo betejë ka ndodhur në muajin Sefer të vitit të dytë të Hixhretit.

Në këtë vit, i Dërguari i Allahut ka falur namazin e Bajramit të Kurbanit me myslimanët dhe është i pari namaz Bajrami që ka falur Profeti [a.s.]. Po në atë vit, i Dërguari i Allahut [a.s.] ka prerë kurban dy dele, thuhet edhe: vetëm një dele. Edhe myslimanët kanë prerë kurbane së bashku me të Dërguarin [a.s.]. I Dërguari [a.s.] është i pari që ka prerë kurban dhe që e kanë parë myslimanët. Kjo luftë shënon fillimin e ndeshjes ushtarake ndërmjet myslimanëve e jehudinjtë. Ajo shënon edhe fillimin e fitores së myslimanëve mbi ta.

Diskutim

1 – Përse i Dërguari i Allahut u shpalli luftë Beni Kajnukave?

2 – Munafikët e çdo kohe janë aleatë të jehudinjtë. Flisni për qëndrimin e njërit prej munafikëve dhe shpjegojeni këtë bashkëpunim.

3 - a) I farë ndikimi pati triumfi i myslimanëve në Betejën e Bedrit mbi jehudinjtë e fisit Beni Kajnuka?

b) Plotësoni frazat vijuese: Pas Betejës së Bedrit, i Dërguari i Allahut u tha Beni Kajnukave: ju paralajmëroj me Allahun

BETEJA E UHUDIT

Pas Betjës së Bedrit kurejshët e ndienin veten të poshtëruar e të fyer në mjediset e arabëve, kurse fuqia e përhapja e Islamit shihej kudo. Prandaj burrat e trimat tyre, vetëm një vit pas Betejës së Bedrit, u mbledhën përsëri dhe vendosën të hakmerreshin ndaj myslimanëve dhe t'i asgjësonin Islamin e myslimanët. Për ta përmbushur këtë synim, ata do të sulmonin myslimanët brenda në Medinen e ndritur. Përgatitjen e tyre e ndihmoi shumë edhe pasuria që kishte sjellë Ebû Sufjani me varganin tregtar (është fjala për atë varganin që nuk e shtinë dot në dorë myslimanët ditën e Bedrit). Njëzëri idhujtarët vendosën: të mos shpenzonin asgjë prej atij vargani se do të ishte vetëm për luftën kundër Muham'medit. Xhaxhai i Profetit [a.s.], Ab'bàsi, e mësoi qëllimin e vendimin e kurejshëve dhe nga Mek'ka i shkroi të Dërguarit [a.s.] një letër, në të cilën e njoftonte se kurejshët kishin qëllim të sulmonin Medinen. I Dërguari [a.s.] e mori letrën dhe njoftoi shokët e tij për përmbajtjen e saj. Të Dërguarit të Allahut i ishte shfaqur në ëndërr se «në shpatën e tij kishte një të çarë, se një deve po therej për të dhe se ai e futi dorën e vet në një mburojë të fortë.»⁽¹⁾ Këtë ëndërr i Dërguari [a.s.] e shpjegoi kështu: një grup prej shokëve të tij do të vriteshin, një burrë prej familjes së tij do ta pësonte dhe se mburoja e fortë ishte Medina.

(1) ٢ndrra e të Dërguarit [a.s.] nuk vonoi të vërtetohej: u vranë një grup prej shokëve të tij, u vra xhaxhai i tij, Hamzai dhe myslimanët pësuan humbje në atë betejë, pikërisht sepse dolën jashtë Medines dhe u ballafaquan me ushtrinë e idhujtarëve jashtë saj. “Tàriikhul-Ja'kùbij”, vëll. 2, f. 47.

I Dërguari [a.s.] këshillohet me shokët e vet

I Dërguari u këshillua me shokët e vet dhe që të gjithë ranë në një fjalë që të luftonin kundër idhujtarëve. I Dërguari [a.s.] – sipas ëndrrës që pa – donte që lufta të zhvillohej brenda në Medine dhe t'i luftonte idhujtarët në hyrje të rrugëve e të rruginave; ndërkaq gratë, të moshuarit e fëmijët do të hidhnin mbi ta gurë e zjarr nga sipër pullazeve të shtëpive dhe kështu ushtria armike do të copëtohej e do të shpartallohej para fuqisë së myslimanëve. Shumë nga sahabët e kundërshtuan mendimin e të Dërguarit të Allahut dhe thanë: Të dalim jashtë Medines dhe atje të luftojmë me ata, nuk kemi përse ta bëjmë qytetin tonë shesh beteje. I Dërguari [a.s.] veshi pajimet luftarake dhe doli së bashku me shokët e tij. Pas pak shokët u penduan dhe i kërkuan Profetit [a.s.] që të ktheheshin në Medine e të luftonin brenda saj, ashtu siç ishte edhe dëshira e

vetë Profetit [a.s.]. Mirëpo i Dërguari [a.s.] e refuzoi tashmë mendimin e tyre: «*Nuk i lejohet një profeti që ka veshur rrobën e luftës, ta heqë atë pa luftuar.*»⁽¹⁾ Kur doli nga Medina, Profeti [a.s.] kishte një mijë luftëtarë. Flamurin e komandën e muhaxhirëve ia dha Imam Aliut [r.a.], kurse flamurin e komandën e ensarëve ia dha Sa'd bin 'Ubâdes [r.a.]. Idhujtarët kishin tre mijë luftëtarë. Komandanti i tyre ishte Ebû Sufjani. Kur myslimanët dolën nga Medina, munafikët, me në krye Abdulla bin Ubej bin Selulin, filluan të lëviznin e të përhapnin fjalë të ndyra dhe së fundi, u tërhoqën nga ushtria.⁽²⁾ Me largimin e tyre dhe ata ishin treqind veta, me të Dërguarin e Allahut mbetëm vetëm shtatëqind luftëtarë.

(1) "El Kâmil fit'Tàrikh", vëll. 2, f. 150.

(2) "Es'Sijretu-n'Nebeuij'jeh" e Ibni Hishàmit, vëll. 2, f. 68.

Ngjarjet e betejës

Dy ushtritë u përballën në malin Uhud. Beteja filloi. I Dërguari i Allahut kishte vënë mbi një bregore në krye të luginës pesëdhjetë harkëtarë nga shokët e tij, me detyrë që ta qëllonin armikun me shigjetat e tyre dhe të mbronin myslimanët, që të mos i sulmonte kush mbrapa shpine; i patën porositur, gjithashtu që të mos e linin pozicionin për asnjë rast. Filloi luftimi. Kur beteja arriti kulmin, myslimanët triumfuan mbi idhujtarët. Atëherë, harkëtarët menduan se tani që myslimanët kishin fituar, mund të mbledhnin plaçkën e luftës. I lanë pozicionet e u turrën të mbledhnin plaçkë lufte. U larguan të gjithë, përveç komandantit të tyre, i cili u tha harkëtarëve: "I Dërguari i Allahut na ka urdhëruar të qëndrojmë në këtë vend dhe kurrë të mos e lëmë atë." Dhe, ai komandant qëndroi aty në pozicionin e tij, derisa ra dëshmor. Kur idhujtarët panë se harkëtarët e braktisën pozicionin dhe se asnjë nuk ishte aty që të mbronin myslimanët, me të shpejtë, ashtu siç ishin, nën komandën e Halid bin Velidit bënë përpara dhe u ranë myslimanëve mbrapa shpine. Ushtria myslimane u thye. Në sheshin e betejës mbeti duke luftuar vetëm i Dërguari [a.s.] me disa prej shokëve të tij. I Dërguari i Allahu u plagos në kërcirin e këmbës e në fytyrë. U vra xhaxhai i tij, Hamza bin Abdul-Mut'talibi, të cilin e goditi në gjoks me ushtë një njeri që quhej Uahshij. Trupin e Hamzait e masakruan, i prenë hundët e veshët, i çanë barkun dhe i nxorën mëlçinë.

Nga urrejtja e saj e thellë, gruaja e Ebû Sufjanit, Hindi, filloi të hapte me dhëmbë mëlçinë e Hamzait. I Dërguari i Allahu ndjeu dhimbje të madhe për çfarë po ngjiste në atë betejë. Shkaku i humbjes së myslimanëve qe se ata nuk iu bindën urdhrave të Profetit të nderuar. Po të mos e kishin kundërshtuar të Dërguarin e Allahut dhe po të kishin qëndruar të luftonin brenda në Medine,

patjetër, do të kishin triumfuar. Ata përsëri do të kishin triumfuar, sikur harkëtarët të mos thyenin urdhrat e të Dërguarit të Allahut.

Myslimanët kthehen të sulmojnë idhujtarët

Pas humbjes që pësuan myslimanët, të nesërmen, Allahu i urdhëroi të shkonin e të luftonin kurejshët. Dhe, myslimanët, ashtu siç ishin, të plagosur e të dërrmuar nga dhimbjet, me trimëri e guxim u nisën të sulleshin mbi idhujtarët, që kurejshëve të mos u shkonte më mendja t'i sulmonin përsëri myslimanët dhe që vetë myslimanët të mos ndiheshin të poshtëruar nga pafuqia e tyre. Të gjithë iu përgjigjën këtij urdhri. I Dërguari i Allahut i dha flamurin e muhaxhirëve Imam Aliut [r.a.] dhe ai e mbajti atë flamur me forcë e me trimëri. Myslimanët vazhduan marshimin deri në Hamrà'u'l Esed, ku synonin të luftonin idhujtarët dhe t'i tregonin botës se ishin të fortë e të fuqishëm për të sulmuar armikun. Mirëpo Ebù Sufjani me ushtrinë e tij ishte kthyer në Mek'kë. E, edhe i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij u kthyen në Medinë. Ja, kështu përfundoi Beteja e Uhudit. Kjo betejë është zhvilluar në vitin e tretë të Hixhretit në muajin Sheu'uàl dhe afërsisht një vit pas Betejës së Bedrit.

Përmbledhje

Beteja e Uhudit është bërë në vitin e tretë të Hixhretit, atëherë, kur idhujtarët, me qëllim që të rikthenin madhësitinë e tyre të rrëzuar përtokë nga myslimanët në Betejën e Bedrit, kishin vënë si qëllim të sulmonin Medinen. Myslimanët dolën të luftonin jashtë qytetit dhe të dyja palët u ballafaquan në malin Uhud. Në fillim triumfuan myslimanët; por ata e humbën betejën kur harkëtarët thyen urdhrat e të Dërguarit [a.s.], lanë pozicionet e veta e u turrën të mblidhnin plaçkë lufte.

Në këtë betejë është vrarë Luani i Allahut, Hamzai, xhaxhai i Profetit të Allahut, e u plagos vetë i Dërguari i Allahut. Pastaj idhujtarët janë kthyer në Mek'kë. Ditën e dytë, Allahu e urdhëroi Profetin e Tij që të gruponte luftëtarët e të ndiqte idhujtarët, që ata të mos e bënin fakt fitoren mbi myslimanët. Dhe, i Dërguari [a.s.] i grumbulloi luftëtarët dhe ndoqi nga pas Ebù Sufjanin, por nuk e arriti dot dhe kështu myslimanët u kthyen në Medinë.

Diskutim

- 1 - a) Shpjegoni shkakun e humbjes së myslimanëve në Betejën e Uhudit?
b) Ëfarë mësimi nxjerrim nga Beteja e Uhudit?
- 2 - a) Kush e filloi sulmin në Betejën e Uhudit dhe përse?
b) Në Betejën e Uhudit ra dëshmor njëri nga heronjtë më të shquar të Islamit. Cili është ky hero? Kush e vrau atë? Ëbënë idhujtarët me trupin e tij pas vrasjes?

3 - Përse Allahu e urdhëroi Profetin e Tij të nderuar që ditën e dytë e pas Betejës së Uhudit t’u bënte thirrje myslimanëve për të luftuar idhujtarët?

DEPORTIMI I FISIT BENI NEDIJR (1)(o)

Kush studion historinë e jehudinëve dhe bashkëveprimin e tyre me të Dërguarin e Allahut e me myslimanët, do të gjejë se ajo është histori e armiqësisë dhe e komplotit kundër myslimanëve. Vetë historia e jehudinëve dëshmon se ata e kanë në karakter prishjen e marrëveshjeve, pabesinë e tradhtinë. Ndër qëndrimet e pabesa të jehudinëve janë dhe komplotet e përpjekjet e tyre për të vrarë të Dërguarin e Allahut e për ta zhdukur atë. Një komplot i tillë ndodhi në fillim të vitit të tretë të Hixhretit, atëherë kur i Dërguari i Allahut shkoi te fisi Beni Nediyr. I Dërguari [a.s.] hyri në qytezën e tyre sipas marrëveshjes që kishte me ta dhe u ul të rrinte rrëzë një muri, që t’u fliste për çështjen e shumës që kërkonin idhujtarët prej myslimanëve për vrasjen e dy vetave. Jehudinjtë u hoqën se ishin të gatshëm dhe i thanë: “Ne të ndihmojmë për çfarë të duash.”

Ndërkaq, disa prej tyre u larguan dhe kurdisën komplotin për të vrarë të Dërguarin e Allahut. Njëri prej tyre do të ngjitej mbi çati dhe që nga lart do të

rrokulliste një gur të madh që të vriste të Dërguarin [a.s.]. Njëri prej krerëve të tyre, Selâm bin Meshkemi, i cili e morri vesh këtë punë, u tha atyre: “Mos veproni, sepse Muham’medi, me siguri e di se ç’do të bëni.” Por ata këmbëngulën në komplotin e tyre dhe nuk e dëgjuan shokun e tyre. Njëri prej tyre u ngjit mbi çati që të lëshonte gurin mbi të Dërguarin e Allahut, por Allahu i lartësuar e njoftoi Profetin e Tij për qëllimin e tyre. I Dërguari u ngrit dhe u tha shokëve të vet: *«Ju qëndroni këtu derisa të vij unë.»* dhe pastaj u nis për në Medinë.

(o) Beni Nedijrët e kanë origjinën e tyre nga fisi arab Xhedhàm, pra ata ishin arabë që kishin përqaftuar fenë e jehudinëve; ata kishin zënë vend në një mal që quhej Nedijr dhe prej atij mali ata morën edhe emrin.

(1) Ibn Ethijr, “El Kàmil fit’Tàriikh”, vëll. 2, “Ngjarjet e vitit të katërt.”

Ndërkaq, shokët po rrinin në pritje të tij. Kur panë se ai u vonua, shkuan ta kërkonin. U takuan me të Dërguarin [a.s.] dhe ai i njoftoi për komplotin e jehudinëve dhe u bëri thirrje myslimanëve për të luftuar. Myslimanët u mbodhën dhe marshuan kundër jehudinëve po atë mbasdite. I Dërguari [a.s.] u kërkoi jehudinëve që të largoheshin dhe të linin shtëpitë e pasuritë për myslimanët. Sapo kreu i munafikëve, Abdullah bin Ubej bin Seluli dhe grupi i tij mësoi për qëllimin e të Dërguarit [a.s.], u lidh me Beni Nedijrët dhe u tha atyre: “Qëndroni dhe i rezistoni Muham’medit e shokëve të tij! Ne jemi me ju. Nëse do të lini shtëpitë tuaja, edhe ne do të largohemi bashkë me ju. Nëse ata luftojnë kundër jush, edhe ne do të luftojmë bashkë me ju.” Por, kur jehudinjtë e hodhën poshtë kërkesën e të Dërguarit të Allahut, atëherë, ai së bashku me shokët u drejtua kundër tyre. Flamurmbajtësi i myslimanëve në këtë marshim ishte Ali bin Ebi Tàlibi [r.a.]. I Dërguari i Allahut i rrethoi e filloi betejën kundër tyre. Megjithëse u vranë mjaft jehudin, munafikët nuk u dhanë atyre asnjë ndihmë. Kur jehudinjtë e panë se ishin të pafuqishëm të rezistonin para të Dërguarit të Allahut, i kërkuan atij paqe dhe ai i trajtoi ata me faljen e tij të premtuar: u dha paqe atyre me kusht që të dorëzonin të gjitha armët dhe të linin për myslimanët florinjte, argjendin, tokat e pasuritë e tjera e do të merrnin vetëm shtroje, mbuloje e ushqim vetëm aq sa mbante një deve. Jehudinjtë ishin të kënaqur me këtë propozim.

U shpërngulën dhe zunë vend në trevat e Shamit. Shpërngulja ishte si dënim për komplotin e pabesinë e tyre. Shpërngulja ishte dënim për kundërvënien e tyre të përherëshme vetëm me të keqe ndaj bamirësisë së Profetit [a.s.]. Myslimanët morën tokat e shtëpitë e tyre si plaçkë lufte. I Dërguari i Allahut ua ndau bagëtinë e jehudinëve vetëm muhaxhirëve, sepse ata, me të vërtetë ishin të varfër e nuk kishin asnjë pasuri; u dha edhe dy ensarëve, të cilët i qenë ankuar të Dërguarit të Allahut se ishin me të vërtetë të varfër. Në

këtë luftë Allahu ka ndaluar (ka bërë haram) për myslimanët pirjen e verës (pijet alkolike).Kjo luftë ka ndodhur në vitin e katërt të Hixhretit dhe ishte një fitore e fuqizim për myslimanët.

Diskutim

1- Jehudinjtë janë të njohur për pabesi e tradhti. Flisni për pabesinë e Beni Nedirëve kundër të Dëguarit të Allahut dhe për përpjekjen e tyre për të komplotuar kundër jetës së tij.

2 - a) Plotësoni frazat vijuese: Selam bin Meshkemi që ishte njëri nga paria e jehudinjtë, i tha popullit të tij, kur ata deshën të vrisnin të Dërguarin [a.s.]: “Mos veproni sepse.....”

b) Si e mësoi i Dërguari [a.s.] komplotin e Beni Nedirëve?

3 - Flisni për fundin që i priste Beni Nedirët prej dorës së myslimanëve?

BETEJA E HENDEKUT

Krahas fitoreve të mëdha që korrën myslimanët kundër idhujtarëve e kundër jehudinjtë, edhe thirja islame u përhap në të gjithë Gadishullin Arabik. Pikërisht për këto arsye filloi bashkëpunimi ndërmjet idhujtarëve e jehudinjtë kundër të Dëguarit të Allahut e shokëve të tij dhe kundër thirrjes islame. Ishte

koha kur jehudët e idhujtarët ranë në marrëveshje të luftonin të Dërguarin e Allahut. Për të vënë në zbatim marrëveshjen me jehudinjtë, idhujtarët mblodhën një ushtri prej dhjetë mijë luftëtarësh. Kjo ushtri, e komanduar prej Ebù Sufjanit, u nis për të sulmuar Medinen dhe për të asgjësuar të Dërguarin e Allahut e shokët e tij, si dhe për të zhdukur shtetin islam e thirrjen islame.

Kur i Dërguari i Allahut e shokët e tij mësuan për këtë sulm, Profeti [a.s.] u këshillua me shokët. Selman Farisiu propozoi që të hapej një hendek i thellë rreth e qark Medines, me qëllim që idhujtarët të pengoheshin për të hyrë në qytet. I Dërguari [a.s.] e miratoi këtë mendim dhe myslimanët e hapën hendekun. Vetë i Dërguari i Allahut ka marrë pjesë në hapjen e hendekut. Ensarët e muhaxhirët, ndërsa punonin për hapjen e hendekut, haheshin me njëri – tjetrin në lidhje me Selmanin dhe thoshin: “Selmani është yni”; por i Dërguari i Allahut u tha: *«Selmani është prej nesh, Ehlî Bejtit»*. Kur erdhën idhujtarët, u befasuan me hendekun. Ata nuk kishin mundësi që ta kapërcenin, prandaj ushtria e tyre e ngriti kampin në anë të hendekut. Megjithëse idhujtarët ndenjën aty disa ditë, nuk e kapërcyen dot hendekun që të fillonin sulmin mbi myslimanët. Vetëm pesë luftëtarë të idhujtarëve mundën ta kapërcenin hendekun në një vend më të ngushtë dhe kështu, ata u hodhën në anën ku ishin myslimanët. Ndër ata që e kapërcyen hendekun ishte më trimi e heroi i idhujtarëve, ‘Amr bin ‘Abdivùdd. Ai, menjëherë u kërkoi myslimanëve dyluftim. Doli Imam Aliu [r.a.], i cili paraprakisht i kërkoi lejë të Dërguarit të Allahut dhe ai e lejoi që të luftonte. Imam Aliu bëri dyluftim me ‘Amrin dhe ishte dëshira e Allahut që Imam Aliu [r.a.] të dilte fitues: e vrau Amr bin Abdivùddin. Imam Aliu [r.a.] tha: “Allahu Ekber”. “Allahu Ekber”, - thanë edhe myslimanët, të gëzuar për fitoren. Ndërkaq, katër shokët e ‘Amrit ua dhanë këmbëve. Kur i Dërguari i Allahut e pa se Imam Aliu doli fitues tha: *«Dyluftimi i Ali bin Ebi Tàlibit me ‘Amr bin ‘Abdivùddin është më i vlefshëm se puna e ym’metit tim deri në Ditën e Kijametit.»*⁽¹⁾ Më pas, Allahu i lartësuar lëshoi mbi ushtrinë e idhujtarëve një furtunë, e cila shkuli tendat e tyre, derdhi e përmbysi enët e ushqimeve, radhët e ushtrisë idhujtare u pështjelluan dhe ata ia dhanë vrapit të shpartalluar. Allahu e bëri realitet ndihmën e Tij për Profetin e Tij të nderuar me shpatën e Aliut [r.a.] dhe me furtunën shkatërruese që lëshoi mbi idhujtarët, si edhe me planin ushtarak të zgjuar të Selmanit. Kjo betejë mori emrin “Beteja e Hendekut”, për arsye të Hendekut që hapën myslimanët për të mbrojtur qytetin e tyre. Është quajtur edhe “Beteja e Grupimeve”, për arsye se grupimet e mohimit e të rrugës së humbjes, të mbledhura nëpër fiset arabe dhe me përkrahjen e mbështetjen e jehudinjtë, nën komandën e Ebù Sufjanit, u turrën që të gjithë të luftonin të Dërguarin e Allahut. Numri i luftëtarëve myslimanë në këtë betejë qe vetëm shtatëqind veta. Kjo betejë është zhvilluar në muajin Sheu’uall të vitit të pestë të

Hixhretit profetik. Ja, kështu u shpartallua ushtria e idhujtarisë, u forcua kampi i besimit dhe triumfuan myslimanët.

Diskutim

1 – Tre ishin faktorët që ndihmuan fitoren e myslimanëve në Betejën e Hendekut. I thoni ata shkurtimisht!

(1) “Mustedreku-s’Sahijhejn”, vëll.3, f. 32; sipas përcjelljes së Sufjan Eth’Theurij, treguar prej Khatib El Bagdadij, në “Tàrikh Bagdàd”, vëll.3, f. 19.

2 – Me ç’rast tha i Dërguari i Allahut ditën e Betejës së Hendekut: «I gjithë besimi u dallua mbi të gjithë idhujtarinë.»? Cili është kuptimi i kësaj fraze?

3 –a) Me kë bënë aleancë kurejshët kundër të Dërguarit të Allahut në Betejën e Hendekut?

b) Kush ishte komandanti i idhujtarëve në këtë betejë? Në ç’vit është zhvilluar ajo?

4 -a) Plotësoni frazat vijuese: I Dërguari tha në lidhje me Selmanin kur myslimanët ishin duke gërmuar hendekun:

«Selmani.....»

b) P’kuptojmë nga fjala e të Dërguarit të Allahut, që u tha më sipër në lidhje me Selmanin? Shpjegojeni këtë çështje shkurtimisht.

LUFTA ME FISIN BENI KUREJDHA⁽¹⁾

Benu Kurejdhat ishin njëri prej fiseve të jehudinje që banonin në Medine, afër myslimanëve. Edhe në mes atij fisi jehudish dhe të Dërguarit të Allahut kishte një marrëveshje paqeje, por ata e thyen marrëveshjen, e tradhtuan të Dërguarin e Allahut dhe në kohën e Betejës së Hendekut ata lidhën aleancë fshehtas me kurejshët kundër myslimanëve. Kur Allahu e ndihmoi Profetin e Tij në atë Betejë dhe kur Profeti [a.s.] po atë mëngjes u largua nga fusha e luftës dhe u kthye në Medine, po atë ditë zbriti Xhibrijli [a.s.] dhe i tha: «Allahu të urdhëron të marshosh kundër fisit Beni Kurejdha». I Dërguari i Allahut urdhëroi njërin prej shokëve të tij që t'u kumtonte myslimanëve fjalët e tij: «*Kush dëgjon dhe bindet, të mos e falë namazin e pasdritës pa arritur te fisi Beni Kurejdha!*».

I Dërguari [a.s.] urdhëroi Imam Aliun [r.a.] të mbante flamurin e luftës në rrugën e Allahut dhe të përparonte në drejtim të Beni Kurejdhave. Në ushtrinë e të Dërguarit të Allahut ishte vetë Profeti [a.s.]. Ushtria u drejtua për të jehudinjtë. Kur Profeti [a.s.] me të tijët arriti në qytezën e tyre, i vuri ata nën rrethim njëzet net me radhë. Jehudinjtë i prenë fare shpresat dhe e panë se ishin të pafuqishëm t'u rezistonin myslimanëve, prandaj iu nënshtruan gjykimit të të Dërguarit të Allahut. I Dërguari, nga ana e tij caktoi gjykatës Sa'd bin Mu'adhin, njërin prej sahabëve të nderuar. Sa'di dha gjykimin e tij: të vriteshin vetëm luftëtarët jehudinj, kurse pasurinë dhe fëmijët e gratë e tyre do t'i merrnin myslimanët.

(1) Shihni te Ibn Ethijri: "El Kâmil fit'Târiikh", vëll. 2, "Ngjarjet e vitit të pestë".

Pas gjykimit, i Dërguari i Allahut i tha Sa'dit: «*I gjykove ata me gjykimin e Allahut, që gjykon nga lartësia e shtatë qiejve.*»⁽²⁾

I Dërguari i Allahut e zbatoi gjykimin që dha Sa'di në lidhje me jehudinjtë dhe kështu myslimanët shpëtuan prej atyre që vetëm komplotonin në bashkëpunim me idhujtarët e munafikët. Kjo fushatë është zhvilluar në vitin e pestë të Hixhretit dhe pasi i Dërguari i Allahut është kthyer nga Beteja e Hendekut.

Diskutim

1 - Shpjegoni qëndrimin e Beni Kurejdhave në luftën e grupimeve! A i qëndruan ata besnikë marrëveshjes që kishin me të Dërguarin e Allahut apo e tradhtuan atë?

2 - Me urdhërin e kujt i luftoi i Dërguari i Allahut Beni Kurejdhat?

3 - Shpjegoni gjykimin e drejtë për Beni Kurejdhat në atë betejë?

PAQJA E HUDEJBIJES

Pas fitoreve të mëdha që korri i Dërguari i Allahut mbi idhujtarët e Mek'kës e mbi jehudinjtë, vendosi të bënte një vizitë në Qabe dhe të kryente 'Umre. U nis për në Mek'kë nga fundi i vitit të gjashtë të Hixhretit, së bashku me një pjesë të myslimanëve.⁽¹⁾ Kishte marrë me vete edhe shtatëdhjetë kokë deve për t'i bërë kurban. Patjetër, ishin edhe të armatosur. Lajmi se po vinte i Dërguari [a.s.] arriti te kurejshët, e ata me shumë shpejtësi përgatitën një ushtri që u drejtua për në zonën nga do të udhëtonte i Dërguari i Allahut me shokët e tij. I Dërguari [a.s.] kishte parë në ëndërr⁽²⁾ sikur kishte hyrë në Qabe, kishte marrë çelësat e saj dhe kishte rruar edhe kokën. Gjatë këtij udhëtimi për të vizituar Qaben, i Dërguari [a.s.] u takua me një burrë, i cili i tha: "O i Dërguari i Allahut, kurejshët janë grumbulluar për të luftuar me ty; ata duan të të ndalojnë, që ti të mos hysh në Mek'kë." I Dërguari i Allahut ndryshoi rrugë dhe vazhdoi udhëtimin derisa arriti në vendin e quajtur Hudejbije, ku qëndroi bashkë me shokët e vet.

Mrekulli të profetnisë së tij

Kur qëndruan në Hudejbije, shokët i thanë Profetit [a.s.]: “O i Dërguar i Allahut, në këtë luginë nuk ka ujë.” I Dërguari [a.s.] i dha njërit prej shokëve të tij një shigjetë dhe e urdhëroi të zbriste poshtë në pusin aty afër, e të gërmonte në pus.

(1) Përcjellësit kanë dhënë njoftime të ndryshme në lidhje me numrin e njerëzve që shoqëronin të Dërguarin [a.s.] në këtë Umre; disa kanë thënë se ishin një mijë e katërqind; të tjerë kanë thënë se ishin më shumë.

(2) “Tàriykhul Ja’kùbij”, vëll. 2, f. 54.

Burri veçroi ashtu siç e kishte urdhëruar Profeti [a.s.]: gërmoi më shigjetë brenda në pus dhe menjëherë shpërtheu ujë me mbushulli, e njerëzit pinë e u freskuan.

Bisedimet me kurejshët

I Dërguari [a.s.] po qëndronte në luginën e Hudejbijes. Ndërkaq, erdhi një burrë i fisit Khuzà’a, i cili ishte prej atyre që e donte dhe e këshillonte të Dërguarin [a.s.]. Ky e njoftoi Profetin [a.s.] për lëvizjen e kurejshëve dhe ngulmimin e tyre për ta vrarë Profetin [a.s.], si dhe për vendimin e tyre për ta ndaluar Profetin të hynte në Mek’kë. I Dërguari i Allahut, Muham’medi [a.s.] i tha atij: *«Ne nuk vimë të luftojmë njeri, por vimë të kryejmë Umre.⁽¹⁾ Në qoftë se ata duan të bëjmë një marrëveshje me kohë të caktuar, ne jemi gati, me kusht që të më lejojnë t’u kumtojnë njerëzve mesazhet e Allahut. Në qoftë se ata nuk pranojnë, do t’i luftoj ata, derisa të arrij fitoren për fenë e Allahut.»* Ai burri i fisit Khuzà’a shkoi dhe u tha kurejshëve çfarë i kishte thënë i Dërguari i Allahut. Pas këtij njoftimi kurejshët dërguan një përfaqësues që të mirëkuptoheshin me të Dërguarin e Allahut.

Besëlidhja e Ridvànit

Profeti [a.s.] dërgoi në Mek’kë Osman bin Af’fânin që të bisedonte me kurejshët, por ata e burgosën Osmanin, madje u përhap lajmi se e kishin vrarë. I Dërguari [a.s.] u zemërua shumë nga veprimi i kurejshëve, të cilët, sipas atij njoftimi, kishin vrarë personin që do të bisedonte me ta në emër të myslimanëve; prandaj tha: “Nuk do t’i lëmë pa i luftuar.” I Dërguari [a.s.] thirri shokët e tij që t’i jepnin besën se do të luftonin dhe ata u mblodhën e i dhanë besën. Kjo besëlidhje u quajt “Besëlidhja e Ridvànit”.

⁽¹⁾ Umra është një vizitë në Mek’kë që bëhet një herë në vit.

(1) Kjo është përmbajtja e fjalës së të Dërguarit të nderuar, Muham'medit[a.s.].

Kur kurejshët panë mundësinë për të bërë paqe me të Dërguarin e Allahut, dërguan tek ai njërin prej njerëzve të vet, Suhejl bin 'Amrin, me mision që ai të zhvillonte bisedime me të Dërguarin e Allahut dhe të nënshkruante me të një marrëveshje paqeje. Ai erdhi tek i Dërguari i Allahut e menjëherë filluan bisedimet. Të dy ranë në një mendje që të lidhej marrëveshja e paqes. I Dërguari i Allahut urdhëroi Imam Aliun [r.a.] që të shkruante marrëveshjen e paqes.⁽²⁾ I Dërguari i Allahut lidhi marrëveshje me idhujtarët për disa çështje, rezultatet e të cilave qenë në të mirë të Islamit e të myslimanëve. Iështjet për të cilat bëri marrëveshje i Dërguari i Allahut me idhujtarët ishin:

1 – Ndalohej i lufta në mes myslimanëve e idhujtarëve për një kohë prej dhjetë vjetësh.

2 – I Dërguari i Allahut ua kthente idhujtarëve cilindo idhujtar që vinte pa leje te myslimanët kurse ai mysliman që shkonte te kurejshët, kurejshët nuk e kthenin.

3 – Kush dëshironte të bënte aleancë me kurejshët ishte plotësisht i lirë të vepronte; kush dëshironte të lidhte aleancë me të

(2) Profeti [a.s.] i tha Aliut: “Shkruaj: ‘Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëmadhit!’”, por Suhejli tha: ‘Ne nuk e njohim këtë, por ti shkruaj: ‘Me emrin Tënd, o Zoti im!’ dhe ai e shkroi. Pastaj i Dërguari i Allahut i tha Aliut: Shkruaj: “Kjo është pagja e lidhur në mes Muham'medit, të Dërguarit të Allahut me Suhejl bin Amrin.”; por përsëri Suhejli tha: ‘Sikur ne të dimë se ti je i Dërguari i Allahut, me siguri që nuk do të të luftonim, por ti shkruaj emrin tënd dhe emrin e babës tënd.’ Atëherë i Dërguari [a.s.] i tha Aliut: “Fshije fjalën “i Dërguari i Allahut”, por Aliu tha se ai kurrë e asnjëherë nuk do ta fshijë atë fjalë, prandaj i Dërguari i Allahut e mori shkresën dhe e me dorën e vet e fshiu fjalën “i Dërguari i Allahut”; pastaj i tha Aliut: «Ti do të sprovohesh për një të ngjashme.», duke aluduar rreth asaj që do të ndodhte në mes Aliut e Muàvijes, të birit të Ebù Sufjanit, pas arbitrimit të çështjeve në Sif'fijn, kur vetë Aliu e hoqi veten nga posti i kalifit dhe abdikoi në favor të Muàvijes». Ibn Ethijr, “El Kàmilu fit'Tàrijkh”, vëll. 2, “Përmendja e Umres në Hudejbije” Dërguarin e Allahut, gjithashtu ishte plotësisht i lirë të vepronte dhe askush nuk e ndalonte.

4 – I Dërguari i Allahut e shokët e tij do të ktheheshin këtë vit në Medine dhe nuk do të hynin në Mek'kë, por ata do të shkonin në Mek'kë vitin e ardhshëm, për të bërë 'Umren.

Rezultatet e paqes

Disa myslimanë u ndien të fyer prej kësaj marrëveshjeje; por në fakt, ata nuk e njihnin mirë urtësinë e profetnisë dhe atë interes të mbuluar që përmbante marrëveshja: Allahu e bëri atë një çlirim shumë të afërt e shumë të rëndësishëm për ta; në sajë të kësaj marrëveshjeje njerëzit u siguruan prej së keqes e prej luftës së kurejshëve dhe filluan të hynin në Islam e t'i besonin të Dërguarit të Allahut në mënyrë të paparë më parë: vetëm gjatë dy viteve që pasuan nënshkrimin e paqes, hynë në Islam aq njerëz sa nuk kishin hyrë gjatë gjithë kohës që kishte vazhduar thirrja islame qysh nga ditët e para. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së paqes, i Dërguari i Allahut, jashtë Mek'kës theri kurbanet, rroi kokën dhe urdhëroi shokët e vet që të bënë siç bëri ai dhe pastaj u kthye në Medinen e ndritur.

Nga rezultatet e kësaj paqeje që edhe aleanca që lidhi fisi Khuzà'a me të Dërguarin e Allahut. Fisi Bekr bin Uàil lidhi aleancë me kurejshët; ndërkaq, fisi Bekr bin Uàil sulmoi fisin Khuzà'a që ishin aleatët e të Dërguarit të Allahut. Në këtë luftë kurejshët i ndihmuan aleatët e tyre, por me këtë veprim ata e thyen marrëveshjen e paqes. Fisi Khuzà'a, me cilësinë e aleatit, i kërkoi ndihmë të Dërguarit të Allahut dhe i Dërguari [a.s.] iu përgjigj kërkesës së tyre. Për këtë qëllim, i Dërguari i Allahut mbledhi një ushtri të madhe dhe në muajin Ramazan të vitit të tetë të Hixhretit u nis për në Mek'kë. Meka u çlirua pa luftë dhe banorët e Mek'kës hynë në Islam. Ja kështu, paqja e Hudejbijes dha kaq rezultate të mëdha e shumë të dobishme për Islamin e për myslimanët.

Përmbledhje

Pas disa fitoreve që i Dërguari i Allahut arriti kundër idhujtarëve e jehudinëve, në vitin e gjashtë të Hixhretit vendosi të vizitonte Qaben e nderuar dhe të kryente 'Umre. Kurejshët mësuuan për ardhjen e të Dërguarit të Allahut dhe me qëllim që të pengonin hyrjen e tij në Mek'kë, me të shpejtë mbledhën një ushtri. I Dërguari i Allahut zhvilloi bisedime me kurejshët; ai u tha atyre se nuk dëshironte luftë, por kishte qëllim vetëm të kryente 'Umre.

Në Hudejbije myslimanët i dhanë besën të Dërguarit të Allahut që të luftonin idhujtarët. Pastaj kurejshët lidhën marrëveshje me të Dërguarin e Allahut që për atë vit ai të kthehej në Medine dhe vitin tjetër të hynte në Mek'kë. Marrëveshja kishte edhe disa çështje të tjera. Paqja e Hudejbijes ndihmoi shumë në përhapjen e Islamit dhe ishte faktori për çlirimin e Mek'kës. Kurejshët e thyen marrëveshjen duke sulmuar aleatët e të Dërguarit [a.s.]. Mek'ka u çlirua pa luftë.

Diskutim

1 - I Dërguari i Allahut pa një ëndërr. Si ishte kjo ëndërr? Kur ajo u bë realitet?

2 - Në ç'vend e bënë myslimanët “Besëlidhjen e Ridvànit” dhe për çfarë problemi e bënë?

3 - Paqja e Hudejbijes erdhi me shumë dobi për Islamin e myslimanët. Kujtoni dy nga ato!

4 - Si ishin kushtet e paqes së Hudejbijes? I thoni ato shkurtimisht?

BETEJA E HAJBERIT

Më lart kemi parë se jehudinjtë ishin fqinjë të myslimanëve në Medine. Pamë, gjithashtu se ata bashkëpunonin me munafikët e idhujtarët kundër të Dërguarit të Allahut, kundër shokëve të tij dhe kundër thirrjes islame.

Pamë, edhe se i Dërguari i Allahut, me qëllim që të shpëtonte prej kompleteve të tyre, i luftoi ata tri herë: në Beni Nedijr, në Beni Kurejdha dhe në Beni Kajnuka'. Pamë, gjithashtu se jehudinjtë i nxisnin idhujtarët që t'i luftonin myslimanët, madje në Luftën e Hendekut, që u zhvillua në vitin e pestë të Hixhretit, ata i shtynë idhujtarët të sulmonin Medinen dhe të luftonin të Dërguarin e Allahut, shokët e tij dhe thirrjen islame. I Dërguari i Allahut kishte dëshirë të shpëtonte prej së keqes së jehudinjve, prej kurtheve e prej spiunazhit të tyre në dëm të Islamit e të myslimanëve. Prandaj, në muajin Muharrem të vitit të gjashtë të Hixhretit, Profeti [a.s.] vendosi të sulmojë gjashtë qytezat e tyre të fortifikuara, që i mbronin njëzet mijë luftëtarë.

Myslimanët erdhën në afërsi të qytezave të jehudinjve dhe beteja filloi. Myslimanët i çliruan ato qyteza me përjashtim të qytezës së Hajberit. Edhe këtë qytezë, i Dërguari i Allahut e rrethoi me ushtrinë e tij. Flamurin ia dha Ebû Bekrit [r.a.] dhe i kërkoi ta çlironte kështjellën; por nuk qe e mundur të arrihej fitorja dhe kështu, ai u kthye pranë të Dërguarit të Allahut. Pastaj Profeti [a.s.] ia dha flamurin 'Umer bin El Khat'tàbit [r.a.], të cilin, gjithashtu e urdhëroi të merrte kështjellën. 'Umeri [r.a.] u mundua shumë, por as ky nuk mundi ta merrte kështjellën dhe përfundimisht, u kthye pranë të Dërguarit të Allahut. Kur i Dërguari i Allahut pa se nuk u mor dot kështjella e Hajberit, tha: «*Nesër do*

t'ia jap flamurin një burri i cili i do Allahun dhe të Dërguarin e Tij; me duart e tij Allahu do ta çlirojë dhe ai nuk i kthen shpinën luftës.»⁽¹⁾

Myslimanët prisnin të mësonin se cili do të ishte ai hero i madh, me duart e të cilit Allahu do të bënte realitet çlirimin e kështjellës? Pas pak i Dërguari i Allahut thirri Imam Aliun [r.a.]. Aliut i ishte mbyllur syri nga mahisja, por i Dërguari [a.s.] ia leu më pështymën e tij dhe deshi Allahu e syri iu shërua. I tha: *«Merre këtë flamur dhe marsho me të derisa Allahu të të mundësojë çlirimin!»* Bukhàriu transmeton:

“I Dërguari i Allahut tha: «Nesër do t'ia jap flamurin një burri, me duart e të cilit Allahu do të mundësojë çlirimin.” Njerëzit e ngrysen atë natë duke menduar se cilit prej tyre do t'ia jepte flamurin. Kur u ngritën, që të gjithë erdhën pranë të Dërguarit të Allahut, duke shpresuar që ai t'u jepte flamurin, por i Dërguari i Allahut pyeti: “Ku është Ali bin Ebi Tàlibi?” Ata i thanë se ishte i sëmurë nga sytë. I Dërguari i Allahut tha që t'ia sillnin aty dhe ai erdhi. Profeti [a.s.] i leu dy sytë me pështymën e tij të bekuar dhe u lut për të. Aliu u shërua dhe nuk kishte më asnjë dhimbje. I dha flamurin. Aliu tha: “O i Dërguar i Allahut, unë do t'i luftoj ata derisa të jenë si ne.” Por i Dërguari [a.s.] i tha: “Marsho përpara derisa të zbresësh në sheshin e tyre, pastaj bëju atyre thirrje të pranojnë Islamin dhe thuaju për detyrimet që kanë ndaj Allahut. Betohem në Allahun, po qe se Allahu do të udhëzojë në rrugën e drejtë me ndërmjetësinë tënde edhe një njeri të vetëm, është shumë më e mirë për ty se sa të kesh një kope të madhe me deve.»⁽²⁾

Aliu [r.a.] mori flamurin dhe përparoi në drejtim të kështjellës. Para tij doli Merhabi, heroi i jehudinëve.

(1) Ibn Hishàm, “Es'Sijretu-n'Nebeu'ij'jeh”, vëll. 3, f. 349; shtypur në Bejrut nga Shtëpia Botuese “Ringjallja e trashëgimisë islame.”

(2) Bukhàriu, “Sahijhul Bukhàrij”, vëll. 5, f. 22, shtypur në Bejrut, Shtëpia Botuese “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”.

Në dyluftimin që ai bëri me Imam Aliun [r.a.], mbeti i vdekur. Pas duelit, Imam Aliu [r.a.] shkuli derën e kështjellës dhe u turr mbi jehudinjtë brenda saj. Së bashku me të sulmuan edhe myslimanët. Kështu, u thye qëndresa e jehudinëve dhe Allahu e bëri realitet çlirimin e asaj kështjelle me duart e tij. Ja, kështu Allahu i lartësuar i bëri pluhur e hi komplotet e jehudinëve dhe kështu mori fund edhe fuqia e tyre ushtarake.

Diskutim

1 - a) Plotësoni fjalën e të Dërguarit [a.s.] ditën e Betejës së Hajberit: *«Flamurin do t'ia jap.....»*

b) Kujt ia dha i Dërguari i Allahut flamurin ditën e Betejës së Hajberit? Cili qe rezultati i Betejës?

2 - a) Sa ishte numri i jehudinëve në atë betejë?

b) Në ç'vit është zhvilluar Beteja e Hajberit?

LUFTA E MU'TES

Pamë se kur myslimanët në Mek'kë qenë të pafuqishëm, migruan për në Abisini nën kryesinë e Xha'fer bin Ebi Tàlibit [r.a.] dhe qëndruan atje disa vjet. Pamë, gjithashtu se Xha'fer bin Ebi Tàlibi [r.a.] u kthye në Medinen e ndritur në vitin e shtatë të Hixhretit dhe ka ardhur tek i Dërguari i Allahut pikërisht ditën e çlirimit të Hajberit. I Dërguari [a.s.] u gëzua shumë për ardhjen e Xha'ferit dhe pasi e puthi në mes dy syve, tha: *«Betobem në Allahun, nuk e di për çfarë të jem më i gëzuar, për çlirimin e Hajberit, apo për ardhjen e Xha'ferit.»*⁽¹⁾

Gjatë kësaj periudhe u shtua shumë rreziku për shtetin islam që themeloi i Dërguari i Allahut në Medinen e ndritur. Tani rreziku vinte nga rumët (bizantinët) që ishin në trevat e Shamit. Rumët ndiqnin fenë e krishterë dhe shteti i tyre përbënte kërcënim të madh kundër thirrjes islame, prandaj i Dërguari [a.s.], me të drejtë kishte frikë për Islamin prej rrezikut që i vinte nga ana e Shamit. Në këto kushte ai vendosi të ndërmernte një fushatë ushtarake kundër rumëve para se ata të sulmonin myslimanët. Qëllimi i kësaj fushate ishte shkatërrimi i dajve sundues e skllavërues në trevat e Shamit, asgjësimi i rrezikut, heqja e pengesave për t'i bërë njerëzit të lirë të besonin në fenë islame dhe për t'i çliruar ata nga dajtë rumë. Për këtë qëllim, në muajin Xhemadil ٤٧ të vitit të shtatë të Hixhretit, i Dërguari [a.s.] përgatiti me shokët e tij një ushtri prej tre mijë luftëtarësh. I Dërguari [a.s.] emëroi për këtë ushtri tre komandantë,

të cilët do të merrnin komandën sipas kësaj renditjeje: Zejd bin Hàrithe [r.a.], Xha'fer bin Ebi Tàlib [r.a.] dhe Abdullah bin Reuàha [r.a.]. Profeti [a.s.] i urdhëroi ata që ushtrinë ta komandonte në

(1) Ibni Ethijr, "Elkàmilu fit'tàrijkh", vëll. 2, f. 234.

betejë Zejd bin Hàrithe [r.a.]; nëse ai do të vritej, komandën do ta merrte Xha'fer bin Ebi Tàlibi [r.a.]; nëse edhe Xha'feri do të vritej, atëherë komandën do ta merrte Abdullah bin Reuàha [r.a.]. I Dërguari i Allahut u përshëndet me ta dhe ushtria u nis të luftonte me rumët. Kur ushtria arriti në vendin e quajtur Meana, që gjendet në trevat e Shamit, dëgjuan se mbreti i rumëve, Herakliu ishte nisur me dyqind mijë luftëtarë në luftë kundër myslimanëve dhe se ushtria e tij përbëhej prej rumëve e arabëve të tij vasalë e armiq të Islamit. Kur mësuan këto lajme, luftëtarët myslimanë qëndruan në atë vend dy ditë, duke menduar për mënyrën se si do të luftonin me armikun, kur ishin aq pak jo vetëm si numër, por edhe me mangësi në pajime, në një kohë kur forcat armike ishin dhjetëra herë më të mëdha. Disa thanë që të nisnin një letër për të Dërguarin e Allahut për ta njoftuar për numrin e madh të ushtrisë armike dhe të qëndronin në pritje të urdhrit të tij. Por në këtë gjendje shpirtërore myslimanëve u dha zemër fjala e komandantit të tyre, Abdulla bin Reuàhas [r.a.]: "O burra! Betohem në Allahun se për atë që ju keni frikë, unë ju them se ju keni dalë këtu të kërkonit të bini dëshmorë dhe ne nuk i luftojmë ata si numër, as si fuqi, por i luftojmë vetëm për këtë fe. Prandaj nisuni, sepse kjo është njëra nga dy veprat më të mira."^(o) Ndërkaq, shokët e tij thanë: «Betohemi në Allahun, ai po thotë të drejtën.» Dhe, ushtria myslimane lëvizi në drejtim të rumëve. Beteja në mes dy ushtrive u zhvillua në fshatin Meune dhe prandaj është emërtuar "Lufta e Meunes". Lufta në mes dy ushtrive sa vinte e bëhej më e ashpër. Myslmanët, edhe pse të paktë në numër, e përballuan luftën me durim. Në luftë e sipër, ra dëshmor Zejd bin Hàrithe [r.a.] dhe flamurin e komandës e mori Xha'fer bin Ebi Tàlibi [r.a.]. Ai luftoi derisa iu pre njëra dorë,^(o) kurse në trup kishte marrë më shumë se tetëdhjetë goditje shpatash e shigjetash.

(o) «Njëra nga dy veprat më të mira» d.m.th. fitore ose rënia dëshmor.

(o) Xha'fer bin Ebi Talibi [r.a.] e mbante flamurin në dorën e djathtë. Kur iu pre dora e djathtë, e mbajti flamurin me të majtën. Kur iu pre edhe dora e majtë, e mbajti flamurin në mes dy parakrahëve derisa ra dëshmor. Në atë kohë ai ishte vetëm tridhjetë e tre vjeç.

Edhe Xha'feri ra dëshmor. Pas tij flamurin e komandës e mori Abdullah bin Reuàha [r.a.]. Edhe ai luftoi kundër rumëve derisa ra dëshmor. Xhibrijli [a.s.] njoftoi të Dërguarin e Allahut që ishte në Medine për çka po ngjiste me myslimanët në betejën e Meunes. I Dërguari i Allahut mblodhi myslimanët dhe

u foli për atë që kishte ngjarë dhe tha: «*Ata - tre dëshmorët - po ngjiten në Xhen'net, të vënë mbi shtretër prej ari.*» Pas Abdullah bin Reuàhas flamurin e komandës e mori Halid bin Veljdi. Ai bëri një manovër tërheqjeje dhe doli nga beteja; pastaj u kthyen në vendin e tyre.

I Dërguari [a.s.] ngushëllon bashkëshorten e Xha'ferit [r.a.]

I Dërguari i Allahut shkoi në shtëpinë e Xha'fer bin Ebi Tàlibit [r.a.] që ta ngushëllonte gruan e tij, Esma bint 'Umejsin se burri i saj kishte rënë dëshmor. Kur pa fëmijët e Xha'ferit, i afroi në gjoksin e tij, u mori erë dhe u lëmoi kokat. Ndërkaq, sytë e tij lotuan. Esmaja që po e ndiqte këtë skenë tha: «Nëna e babai im t'u bëfshin kurban, përse bën kështu me fëmijët e mi, ashtu siç bën për jetimët? Mbase ke ndonjë lajm për Xha'ferin?» Të Dërguarin e Allahut e mposhtën qarjet e forta por tha: «*Allahu e mëshiroftë Xha'ferin!*» Esmaja klithi: «E mjera unë! I mjeri zotëria (burri) im!» Por i Dërguari i Allahut i tha: «*Mos qaj me ligje e as me thirrje luftarake! Gjithçka që ti the, është plotësisht e vërtetë.*» Atëherë ajo thirri: «Oh, or Xha'fer!» Zërin e gruas së Xha'ferit e dëgjo i edhe vajza e të Dërguarit të Allahut, Fatime Zehraja. Ajo erdhi duke thirrur: «Oh për djalin e xhaxhait tim!» Ndërkaq, doli edhe i Dërguari i Allahut duke i përmbajtur të qarat me zor dhe tha: «*Për Xha'ferin le të vajtojnë gratë!*» Pastaj i tha së bijës: «*O Fatime, gatuj edhe për familjen e Xha'ferit! Tani ajo është në hallin e vet.*» Fatimja gatoi për familjen e Xha'ferit tri ditë me rradhë. Pastaj kjo u bë rregull për fisin e Beni Hàshimëve.»⁽¹⁾

(1) El-Jàkùbij, "Tàrijkhul-Jàkùbij", vëll. 2, Beteja e Meutes

Nga kjo betejë ne mësojmë shembujt e rrallë të trimërisë, të durimit dhe të therorisë në luftë me armiqtë, pavarësisht sa të shumtë e të fuqishëm të jenë ata. Në atë Betejë, edhe pse myslimanët nuk korrën fitore, u shënua fillimi i triumfit që do të korrte i Dërguari i Allahut në një luftë tjetër kundër rumëve. ٢٠ Shtë fjala për Luftën e Tebùkut, luftë që u zhvillua vetëm një vit më vonë.

Përmbledhje

Rumët kishin një shtet të fuqishëm në trevat e Shamit që ishte një rrezik i madh për shtetin islam në Medine. Shteti i rumëve ishte gjithashtu pengesë serioze për përhapjen e thirrjes islame në anët e tjera të botës. Për të gjitha këto, i Dërguari i Allahut vendosi t'i luftojë ata në vitin e tetë të Hixhretit, para se ata të sulmonin myslimanët. Për këtë qëllim, i Dërguari i Allahut nisi një ushtri me tre mijë luftëtarë dhe caktoi tre komandantë. Ata qenë Zejd bin Hàrithe [r.a.], Xha'fer bin Ebi Tàlib [r.a.] dhe Abdullah bin Reuàha [r.a.]. Ushtria e rumëve

përbëhej prej dyqind mijë luftëtarësh. Beteja u zhvillua në fshatin Meune. Në atë betejë ranë dëshmorë të tre komandantët. Duke pasur parasysh numrin e paktë të myslimanëve dhe numrin e madh të rumëve, kjo betejë tregoi forcën e besimit dhe të trimërisë. Nga kjo betejë nxjerrim mësim për luftën në rrugën e Allahut, për trimërinë dhe dëshirën për të rënë dëshmor në rrugën e Allahut të lartësuar.

Diskutim

1 - Plotësoni fjalën e të Dërguarit [a.s.] ditën, kur u takua me Xha'ferin në Betejën e Hajberit:

«Betohem në Allahun, nuk e»

2 - Mësuam dallimin e madh në mes fuqisë së myslimanëve dhe fuqisë së rumëve nga ana numerike dhe e pajimeve luftarake; megjithkëtë myslimanët nuk u sprapsën, por zbatuan urdhrin e të Dërguarit të Allahut, sulmuan armikun dhe komandantët e tyre ranë dëshmorë. Ëfarë mësojmë prej kësaj beteje?

3 - a) I Dërguari i Allahut tha: «Për Xha'ferin le të qajnë gratë!» Ëkuptim ka kjo fjalë?

b) Abdullah bin Reuàha [r.a.] u tha shokëve të vet: «...Ne nuk i luftojmë ata si numër, as si fuqi, por i luftojmë vetëm për këtë fe, prandaj nisuni, sepse kjo është njëra nga dy veprat më të mira». Shpjegojeni shkurtimisht këtë thënie!

ILIRIMI I MEK'KËS

Përshkrim

Mek'ka është qyteti ku ka lindur Muham'medi [a.s.] dhe ku i ka zbritur Zbulesa. Në Mek'kë Profeti [a.s.] ka qëndruar trembëdhjetë vjet. Në Mek'kë, për tre vjet radhazi, i Dërguari i Allahut ka bërë thirrje për në Islam fshehurazi dhe pastaj, hapur. Banorët e Mek'kës e kanë pritur thirrjen e tij me armiqësi e me kryeneçësi dhe qenë vetëm një numër i paktë prej tyre që i besuan profetnisë së Muham'medit [a.s.]. Profeti [a.s.] e shokët e tij janë munduar shumë, madje disa prej shokëve të tij janë torturuar e janë vrarë. Ndër të vrarët janë Sumeja dhe Am'màri. Idhujtarët i nxisnin njerëzit kundër të Dërguarit të Allahut. Ata u përpoqën edhe ta vrisnin të Dërguarin [a.s.]. Prandaj ai dhe shokët e tij migruan për në Medinen e ndritur. Mek'ka kishte një pozitë të madhe e të shenjtëruar në shpirtat e arabëve, sepse aty ishte Qabja. Kurejshët ishin sunduesit e Mek'kës dhe ishin fisi më i fuqishëm ndër fiset e tjera arabe; kurejshët gëzonin edhe respektin e privilegjin e kryesisë në shpirtat e arabëve.

Pasi i Dërguari i Allahut migroi për në Medine, idhujtarët bashkë me aleatët e tyre jehudinj e bënë Mek'kën bazë dhe qendër të grumbullimit të forcave antiislame. Nga Mek'ka thureshin komplotet kundër myslimanëve dhe përgatiteshin ushtritë për t'i sulmuar ata. Kështu u veprua edhe për Betejën e Uhudit, e cila u zhvillua në vitin e tretë të Hixhretit, edhe për Betejën e Hendekut që u zhvillua në vitin e gjashtë të Hixhretit. Prandaj çlirimi i Mek'kës ishte domosdoshmëri, për të asgjësuar fuqinë e idhujtarëve e për të shpëtuar nga komplotet që ata kurdisnin në bashkëpunim me jehudinjtë kundër Islamit e Profetit të nderuar të Islamit, Muham'medit [a.s.]. Me çlirimin e Mek'kës, edhe Qabja do të bëhej e lirë e do të pastrohej prej idhujve e shtatoreve, do të bëhej "Shtëpi" adhurimi vetëm për Allahun, Zotin Një e të Vetëm, do të bëhej ashtu siç ishte edhe vullneti i Allahut të lartësuar, do të eliminoheshin djajtë kurejshë bashkë me pushtetin e tyre, sepse idhujtarët kurejshë, jo vetëm që pengonin njerëzit të besonin në Islamin, por ishin pengesë edhe për përhapjen e thirrjes islame ndër fiset arabe.⁽¹⁾

Si u çlirua Mek'ka e nderuar

Sipas marrëveshjes së paqes mes të Dërguarit të Allahut dhe idhujtarëve ndër të tjera, palët kishin rënë në ujdi që secila nga palët nënshkruese gëzonte të drejtën për të lidhur aleanca me çdo fis që të dëshironte. Mbështetur në këtë pikë të marrëveshjes, fisi Khuzà'a bëri aleancë me të Dërguarin e Allahut, kurse fisi Kenàneh bëri aleancë me idhujtarët. Nuk kaloi shumë kohë dhe fisi Kenàneh sulmoi fisin Khuzà'a. Kurejshët ndihmuan aleatin e tyre Kenaneh. Edhe i Dërguari i Allahut u detyrua të ndihmonte aleatin e vet, fisin Khuzà'a, për arsye se kurejshët e thyen marrëveshjen që kishin nënshkruar për një afat kohor prej dhjetë vjetësh. Në këto kushte, i Dërguari i Allahut vendosi të sulmonte kurejshët dhe të asgjësonte idhujtarinë, padijen e agresionin. Për këtë qëllim, ai mbledhi një ushtri të madhe prej afro dhjetë mijë luftëtarësh. Profeti [a.s.] u nis në fshehtësi në drejtim të Mek'kës. Ai veproi kështu me qëllim që kurejshët të mos përgatiteshin për të luftuar. Profeti [a.s.] e nisi marshimin e tij në muajin Ramazan të vitit të tetë të Hixhretit dhe i urdhëroi myslimanët të mos agjëronin; prandaj piu ujë vetë; kurse ata që do të agjëronin, i quajti kryengritës, sepse në këtë rast ata ishin udhëtarë. Ushtria e Profetit [a.s.] zuri vend rreth Mek'kës. Natën, ushtarët ndezën zjarre në vendet që dukeshin mirë në

(1) “El Kàmil fit’Tàrikh” e Ibn Ethijrit, vëll. 2, f. 239; “Tàrijhul Ja’kùbij”, vëll. 2, f. 58; Et’Tabresij në “T’làmul-Uerà”, f. 112.

Mek'kë. Ndërkaq, Ebù Sufjani dhe dy shokët e tij, Hakim bin Hizàmi dhe Bedijl bin Ueraka, kishin dalë të vëzhgonin dhe të merrnin ndonjë lajm në fshehtësi. Kur ata panë zjarret e shumta, çka tregonte edhe për numrin e madh të luftëtarëve, Ebù Sufjanin, udhëheqësi i idhujtarëve, e zuri frika për vete e për pushtetin e tij, e filloi të pyeste shokët e vet për ato zjarre dhe për atë ushtri të madhe. Ab'bàsi, xhaxhai i Profetit [a.s.] dëgjoi se po e thërriste Ebù Sufjani: «'është me këta njerëz kaq të shumtë, o Ebù Fadl?» Ab'bàsi i tha: “Ky është i Dërguari i Allahut, shko tek ai dhe merr sigurinë prej tij!” Ebù Sufjani e gjeti me vend fjalën e Ab'bàsit. Ai shkoi tek i Dërguari [a.s.] së bashku me Ab'bàsin. Ab'basi i kërkoi sigurinë të Dërguarit të Allahut për Ebù Sufjanin. I Dërguari [a.s.], me butësinë e me durimin e tij, e fali atë dhe urdhëroi që të thoshte dy fjalët e dëshmisë. Ebù Sufjani ngurroi të dëshmonte profetninë e Muham'medit [a.s.], por Ab'bàsi i tha: “O Ebù Sufjan, ai do të të vrasë.” Ebù Sufjani pati frikë se mos e vrisnin dhe kështu, pohoi dy dëshmitë.

Ushtria e myslimanëve hyn në Mek'kë

I Dërguari i Allahut urdhëroi xhaxhanë e vet, Ab'bàsin që të merrte Ebù Sufjanin dhe të qëndronte më të në rrugën nga do të kalonte ushtria e

myslimanëve, me qëllim që ta frikësonte atë. Dhe vërtet, kur Ebù Sufjani pa madhështinë e fuqinë e mysliimanëve, i tha Ab'bàsit: «Mbretëria e djalit të vëllait tënd u bë e madhe.» Ab'bàsi ia ktheu: «Ah mor i mjerë, ajo është profetnia.»

Pastaj i Dërguari i Allahut thirri dy shoqëruesit e Ebù Sufjanit, Hakim bin Hizàmin dhe Bedijl bin Uerakan, që tashmë e kishin pranuar e Islamin, e i urdhëroi të shkonin në Mek'kë dhe t'u bënë thirrje banorëve të saj të hynin në Islam. Që të dy thirrën: “Kush hyn në shtëpinë e Ebù Sufjanit, është i siguruar; kush hyn në shtëpinë e Hakim bin Hizamit, është i siguruar; kush mbyll portën e vet e nuk lufton është i siguruar...” I Dërguari i Allahut urdhëroi ushtrinë të hynte në Mek'kë pa luftuar.⁽¹⁾ Ndërkaq Sa'd bin 'Ubadeh, prej ensarëve dhe njëri nga komandantët e ushtrisë islame thirri: “Sot, sot është tragjedia e vrasjeve të shumta. Sot do të merren robër lufte të afërmit.”⁽²⁾ Kur i Dërguari i Allahut dëgjoi thirrjen e Sa'dit, menjëherë urdhëroi Imam Aliun [r.a.] që t'i merrte flamurin dhe të hynte në Mek'kë me të butë dhe pa luftë.

Pas hyrjes në Mek'kë, i Dërguari i Allahut ndaloi në portën e Qabes dhe para gjithë njerëzve tha: «*Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Ai është i Vetëm, Ai e përmbushi premtimin e Tij, ndihmoi robin e Vet dhe shpartalloi forcat e idhujtarisë, Ai është i Vetëm...*». Pastaj, i fali të gjithë banorët e Mek'kës dhe u tha atyre: «Shkoni, jeni të lirë». Pastaj theu të gjitha shtatoret që ishin në Qabe dhe ishin plot treqind e gjashtëdhjetë shtatore idhujsh. Njerëzit filluan të hynin në Islam në grupe. Ja, kështu Allahu shkatërroi kampin e idhujtarisë e të padijes dhe pastroi Mek'kën prej mizorisë, ngatërresave e politeizmit. Ja kështu, Allahu e bëri realitet fitoren e mysliimanëve me durimin e me luftën e tyre në rrugën e Allahut. I Dërguari [a.s.] ka ndenjur në Mek'kë vetëm pak ditë. Pastaj ka shkuar në Tàif dhe pasi e ka çliruar edhe Tàifin është kthyer në Medinen e ndritur. Me rrëzimin e fuqisë së idhujtarisë, në Mek'kë fillon një etapë e re fitoresh dhe e përhapjes së thirrjes islame.

Përmbledhje

Mek'ka është qyteti i shenjtë i kohës së padijes dhe i kohës islame. Në Mek'kë është Qabja e nderuar. Në Mekë i ka zbritur Zbulesa Profetit të nderuar Muham'medit [a.s.]. Në Mek'kë ai Profeti [a.s.] vazhdoi thirrjen trembëdhjetë vjet me radhë fshehurazi dhe hapur, me urtësi e me këshillën më të bukur; porse

(1) Ndodhi një luftim në njërën nga hyrjet e Mek'kës në mes Halid bin Uelidit dhe disa idhujtarëve. Në ato luftime u vranë tre mysliimanë dhe trembëdhjetë idhujtarë.

(2) Ibn Ethijri në “Historinë” e tij, vëll. 2, f. 246.

djajtë e Mek'kës, të pasurit e saj, që ishin njerëz me influencë e mendjemëdhenj, i bënë një rezistencë të madhe thirrjes islame; ata i munduan shumë Profetin [a.s.] dhe shokët e tij. Kur kurejshët vendosën të vrisnin të Dërguarin e Allahut, ai u largua për në Medine. Pikërisht në Medine atë e lejoi Allahu të luftonte dhe ai triumfoi mbi jehudët e idhujtarët e Mek'kës në shumë beteja. Nga fundi i vitit të gjashtë të Hixhretit, i Dërguari [a.s.] nënshkroi me idhujtarët marrëveshjen e “Paqes së Hudejbijes”. Por idhujtarët ndihmuan fisin aleat të sulmonte fisin Khuzà'a që ishte aleat i të Dërguarit të Allahut. Fisi Khuzà'a kërkoi ndihmën e të Dërguarit [a.s.] dhe ai përgatiti një ushtri prej dhjetë mijë luftëtarësh. Me këtë ushtri i Dërguari [a.s.] u nis të çlironte Mek'kën. Kjo ka ndodhur në vitin e tetë të Hixhretit. Banorët e Mek'kës u bindën pa luftë. I Dërguari [a.s.] hyri në Mek'kë fitimtar në muajin Ramazan. Profeti [a.s.] i fali të gjithë mekasit pavarësisht nga mundimet e rënda, shtypjen e madhe dhe agresionin që ata kishin bërë mbi vetë Profetin [a.s.] dhe mbi shokët e tij. Me shkatërrimin e fuqisë së idhujtarëve në Mek'kë, Islami u përhap në të gjithë Gadishullin Arabik dhe u forcua fuqia e myslimanëve. Lirimi i Mek'kës është një mësim i madh për myslimanët e çdo kohe. Ky çlirim shpjegon qartë për ne se si të pafuqishmit që ishin të paktë dhe që u nxorën prej shtëpive të veta, patën mundësi të formonin për veten e tyre një fuqi të madhe dhe të ktheheshin çlirimtarë e fitimtarë vetëm në saje të durimit, të mbrojtjes të së vërtetës dhe besimit.

Diskutim

1 – Përgjeron fjala «*Shkoni, jeni të lirë*», që i Dërguari [a.s.] u tha banorëve të Mek'kës, të cilët e patën munduar atë dhe e patën detyruar të braktiste shtëpinë e të linte vendin të vet?

2 – Cili qe shkaku që i Dërguari i Allahut i bëri thirrje ushtrisë së tij që të nisej për të çliruar Mek'kën?

3 – Ëfarë na mëson ngjarja e çlirimit të Mek'kës, nga e cila myslimanët qenë larguar të frikësuar, por pastaj u kthyen aty të fuqishëm e çlirimtarë?

BETEJA E HUNEJNIT

Më lart pamë se i Dërguari i Allahut e çliroi Mek'kën në vitin e tetë të Hixhretit, ditën e njëzeteshtatë të muajit të bekuar të Ramazanit. Në Mek'kë ai qëndroi disa ditë dhe aty mësoi se fiset Heuazen dhe Thekijf, që banonin në një fshat të Tàifit pranë Mek'kës, kishin rënë në një fjalë që të luftonin të Dërguarin e Allahut dhe kishin thënë: “Ta luftojmë ne të parët, para se të na luftojë ai, ashtu siç luftoi banorët e Mek'kës.” I Dërguari i Allahut mblodhi ushtrinë e tij

me të cilën ai çliroi Mek'kën dhe, siç u tha më sipër ishin dhjetë mijë luftëtarë. Me ata u bashkuan edhe dy mijë të tjerë prej banorëve të Mek'kës, që kishin hyrë në Islam para pak ditësh, pas çlirimit të Mek'kës. Në muajin Sheu'uâl të vitit të tetë të Hixhretit, vetëm pesëmbëdhjetë ditë pas çlirimit të Mek'kës, ata u nisën që të asgjësonin forcat e idhujtarisë e të rrugës së humbjes që kishin bërë gati Thekifët dhe Heuazinët. Kur fiset Heuazin e Thekijf mësuan se myslimanët po përparonin në drejtim të tyre, dolën të përballeshin me ta në luginën Hunejn, pranë Tàifit dhe aty u vunë pritë muslimanëve.

Kur myslimanët panë se ishin shumë në numër, thanë: «Ata kurrë nuk na mundin dot sepse ne jemi shumicë.» Kjo fjalë e lëndoi të Dërguarin e Allahut, sepse ai ndjeu se shpirtrat e tyre ishin mbushur me mendjemadhësi. Prandaj u frikësua për ata se do të shpartalloheshin. Gjatë betejës, idhujtarët e befasuan ushtrinë muslimane në luginën Hunejn: ata kishin ngritur prita kundër myslimanëve. Myslimanët u thyen dhe ia dhanë vrapit nëpër shkretëtirë. Qëndroi vetëm i Dërguari i Allahut bashkë me një grusht besimtarësh: thuhet se ata nuk ishin më shumë se dhjetë veta, ndër ta, xhaxhai i tij, Ab'basi, Ali bin Ebi Tàlibi e të tjerë si këta të dy. I Dërguari i Allahut urdhëroi xhaxhain e tij, Ab'bàsin që t'u bënte thirrje myslimanëve të bënin durim dhe të qëndronin, duke u kërkuar atyre besnikërinë për besën që i kishin dhënë të Dërguarit të Allahut për të mbrojtur atë dhe fenë e tyre. Allahu zbriti melekët për Profetin e Tij dhe për ata që e pasuan atë. I Dërguari i Allahut u bëri thirrje myslimanëve me sa zë kishte që të bënin durim e të qëndronin. Me këtë thirrje u kthyen një numër i madh myslimanësh. Ndërkaq, Imam Aliu [r.a.] bëri përpara në drejtim të flamurbajtësit të Heuazinëve dhe e vrau atë. Idhujtarët u thyen, ushtria e tyre u dromcua dhe Allahu e bëri realitet fitoren për Profetin e Tij. Shumë nga myslimanët që qenë larguar nga beteja, u kthyen dhe u bashkuan me të Dërguarin e Allahut. Pas shpartallimit të idhujtarëve myslimanët zunë shumë bagëti si plaçkë lufte. Allahu i lartësuar zbriti një ajet, ku ai lavdëron besimtarët që qëndruan me të Dërguarin e Allahut dhe i qorton ata që u mbuluan nga mendjemadhësia për fuqinë e tyre në fillim të betejës, po që pastaj u thyen kur lufta u ashpërsua. I Larti thotë: **«Allahu ju ndihmoi në shumë vende, ju ndihmoi edhe në ditën e Hunejnit, kur ju u krekosët me numrin tuaj të madh, por që nuk u vlejti për asgjë, aq sa toka ju dukej e ngushtë me gjithë gjerësinë e saj; pastaj ju kthyet shpinën dhe ikët.» «Pastaj Allahu zbriti qetësinë e Vet në të Dërguarin e Tij e në besimtarët; zbriti edhe një ushtri që ju nuk e shihnit.....»** ("Et Teube", 25-26).

Pas betejës i Dërguari i Allahut u drejtua për në Tàif, duke nisur si pararojë Imam Aliun [r.a.]. Imam Aliu u takua me njërin prej krerëve të Tàifit, i cili komandonte një numër luftëtarësh. Imam Aliu [r.a.] e vrau atë dhe shokët e tij u shpërndanë të shpartalluar. I Dërguari i Allahut e vuri në rrethim Tàifin, sepse në të ishin strehuar idhujtarët pas shpartallimit në luginën Hunejn. I Dërguari i

Allahut e çliroi Tàifin pas disa ditësh rrethimi. Ja, kështu u shpartallua fuqia e fundit e fiseve arabe, aq të ashpra në rezistencën e në luftimin e Islamit e të thirrjes islame. Pas kësaj ngjarjeje fuqia e pushteti i të Dërguarit të Allahut ishte shtrirë në të gjithë Gadishullin Arabik.⁽¹⁾

(1) El Ja'kubij në "Historinë" e tij, vëll. 2, f. 62; "Tàrijkhu Ibnîl Ethijr", vëll. 2, f. 261; "Es Sijretu" i Ibn Hishàmit, vëll. 4, f. 80; "I'làmul Uerà" e Tabersijit, f. 119.

Përmbledhje

Pasi i Dërguari i Allahut çliroi Mek'kën, fiset Heuazin dhe Thekijf që ishin idhujtarë dhe banonin qyetin e Tàifit, në afërsi të Mek'kës, u frikësuan prej fuqisë së myslimanëve; prandaj vendosën të sulmonin myslimanët para se myslimanët t'i sulmonin ata. Në këtë kohë i Dërguari i Allahut vendosi të kryente një sulm kundër tyre dhe tashmë në ushtrinë e tij kishte dymbëdhjetë mijë luftëtarë. Me këtë ushtri Profeti [a.s.] u nis kundër tyre në muajin Sheu'uâl vetëm pesëmbëdhjetë ditë pas çlirimit të Mek'kës. Myslimanëve iu rrit mendja nga numri i tyre i madh dhe thanë: «Ata kurrë nuk na mundin dot se ne jemi shumë.» Kjo fjalë e tyre e lëndoi shumë të Dërguarin e Allahut, pasi e ndjeu se atyre u ishte rritur mendja. Por ata arritën në luginën Hunejn. Atje u befasuan nga sulmi i idhujtarëve dhe ia dhanë vrapit e u shpërndanë; për pasojë, në fushën e betejës mbeti vetëm një numër shumë i vogël prej tyre. Më pas u kthyen të tjerët e u bashkuan me ta. Në përfundim të betejës, myslimanët bënë shumë bagëti si plaçkë lufte. Me asgjësimin e atyre idhujtarëve, u asgjësuan kështjellat më të fuqishme të idhujtarisë e të agresionit kundër Islamit në Gadishullin Arabik.

Diskutim

1 – Përse myslimanët fituan në Betejën e Bedrit kur ishin të paktë dhe u shpartalluan në Hunejn në fillim të betejës, megjithëse ishin shumicë? Shpjegojeni shkurt këtë fakt.

2 – a) Në ç'vit e ka çliruar i Dërguari i Allahut Tàifin?

b) Allahu i qorton myslimanët për mendjemadhësinë e për thyerjen që pësuan në betejën e parë të Hunejnit. Lexoni ajetin e nderuar që zbriti me këtë rast.

c) Si quheshin dy fiset, të cilat i luftoi i Dërguari [a.s.] në betejën e Hunejnit? Përse beteja e Hunejnit u quajt me këtë emër?

LUFTA E TEBËKUT

Shteti islam që themeloi i Dërguari i Allahut në fillim të Hixhretit të tij në Medinen e ndritur, gjendej ndërmjet dy shteteve të mëdha e të fuqishme, shtetit të persëve nga lindja, në trevat e Persisë dhe shtetit të rumëve nga perëndimi, në trevat e Shamit. Kur shteti islam u fuqizua dhe thirrja islame u përhap, myslimanët çliruan Mek'kën dhe asgjësuan forcën armiqësore të jehudinëve. Mbreti i rumëve, Herakliu, pati frikë për shtetin e tij dhe për pushtetin e tij të ndërtuar mbi padrejtësinë e mbi ngatërresat e shkatërrimin; prandaj ai donte të sulmonte myslimanët në shtëpitë e tyre dhe njëkohësisht të asgjësonte Islamin. I Dërguari i Allahut i mori vesh qëllimet e liga të mbretit, prandaj vendosi t'i sulmonte rumët brenda vendit të tyre, para se ata të sulmonin myslimanët. I Dërguari [a.s.] njoftoi shokët e tij për domosdoshmërinë e luftës kundër rumëve, si dhe për detyrën për përgatitjen e fushatës nga ana financiare e pajisjen e luftëtarëve me mjetet luftarake e furnizime; prandaj ai iu vu punës për përgatitjen luftarake të ushtrisë dhe gatishmërinë e saj për të luftuar kundër atyre armiqve.

Ishte kohë vere. Vapa ishte shumë e fortë. Rruga ishte shkretëtirë dhe shumë e gjatë. Armiku kishte më shumë forca se myslimanët. Për më tepër, në atë vit myslimanët u goditën nga një thatësi e tejzgjatur. Megjithatë, i Dërguari i Allahut mblodhi shokët e tij dhe formoi me ta një ushtri që u quajt ushtria “e vështirësisë”.⁽¹⁾ I Dërguari i Allahut u bëri thirrje të pasurve të shfaqnin bamirësinë e tyre për të pajisur e për të furnizuar ushtrinë me para, kuaj, deve etj.

(1) U quajt “ushtria e vështirësisë”, për shkak se njerëzit e kishin shumë të vështirë të marshonin në atë nxehtësi të madhe; për më tepër, ishte edhe koha që mblidheshin të korrat.

Të pasurit shpenzuan në rrugën e Allahut. Ata që kishin besim të dobët kërkuan ndjesë që nuk mund të merrnin pjesë në ushtri. Në lidhje me këtë sjellje të tyre zbritën ajetet e Kur'anit që i qortojnë rëndë ata dhe që i lavdërojnë të sinqertët, të cilët iu përgjigjën thirrjes së të Dërguarit [a.s.]. Edhe të pasurit marshuan së bashku me të Dërguarin [a.s.] që të luftonin në rrugën e Allahut, krahas shpenzimit të pasurisë së tyre.

I Dërguari [a.s.] nis të luftojë rumët

I Dërguari i Allahut la zëvendës të tij në Medine Imam Aliun [r.a.] që të kujdesej për mbrojtjen e saj. Me këtë rast munafikët thanë: «I Dërguari i Allahut nuk kishte dëshirë të dilte nga Medinia së bashku me Ali bin Ebi Tàlibin.» Imam Aliu [r.a.] u ndie i fyer nga këto fjalë, prandaj ngjeshi armët, u bashkua me të Dërguarin e Allahut dhe iu ankua atij për çfarë flisnin dyfytarakët; por i Dërguari [a.s.] i tha: *«Ata gënjejnë. Unë të lashë zëvendësin tim. Kthehu dhe më zëvendëso mua në familjen time e në familjen tënde! A nuk je i kënaqur të jesh tek unë në pozitën që ishte Hàrùni te Mùsà? Por, pas meje nuk ka më profet.»*⁽¹⁾ Imam Aliu [r.a.] u kthye i gëzuar, kurse i Dërguari i Allahut marshoi në krye të myslimanëve për të luftuar rumët. Ky marshim ka ndodhur në vitin e nëntë të Hixhretit, pas kthimit të tij nga lufta e Hunejnit.

Nga mrekullitë e të Dërguarit [a.s.]

Më lart u tha se rruga nga marshonte ushtria e muslimanëve nën komandën e të Dërguarit të Allahut ishte shkretëtirë shkëmbore. U tha, gjithashtu se vera e atij viti qe shumë e nxehtë dhe kur _____

(1) Ibn Ethijr, “El Kàmil fit”Tàriikh”, vëll. 2, f. 277; “Es’Sijretu-n’Nebeuij”jeh” e Ibn Hishàmit, vëll. 4, f. 159. Bukhàriu e transmeton ngjarjen si më poshtë: «A nuk je i kënaqur të jesh tek unë në pozitën që ishte Hàrùni te Mùsà?» “Sahijhu” i Bukhàriut, vëll. 5, f. 24.

myslimanët arritën në El Hixhr, nuk kishin më ujë e prandaj filluan t’i ankoheshin të Dërguarit të Allahut se kishin etje. I Dërguari i Allahut u lut dhe Allahu dërgoi mbi ata një re, e cila lëshoi aq shi, sa atyre u teproi uji dhe pasi pinë të gjithë, e lanë atë vend dhe marshuan në drejtim të rumëve. I Dërguari i Allahut dhe shokët e tij arritën në luginën e Tebùkut. Aty qëndroi me ushtrinë e vet dhe po aty ai lidhi paqe me disa krerë të krishterë.

I Dërguari [a.s.] ka qëndruar në luginën e Tebùkut trembëdhjetë ditë. Meqenëse aty pari nuk u duk asnjë ushtri e rumëve, as e arabëve vasalë të rumëve, ai e la Tebùkun dhe u kthye në Medine. Kjo luftë ka ndodhur në muajin Rexheb të vitit të nëntë të Hixhretit. Ja, kështu myslimanët fituan mbi rumët, pas humbjes që ata paten pësuar afërsisht para një viti në luftën me rumët gjatë luftës së Meunes.

Përmbledhje

Kur myslimanët u fuqizuan dhe Islami triumfoi në Gadishullin Arabik, mbreti i rumëve Herakliu pati frikë për pushtetin e tij të ndërtuar mbi mohimin e padrejtësinë; prandaj ai donte të sulmonte shtetin islam. Por i Dërguari i Allahut mësoi për planet e rumëve dhe vendosi që t’i sulmonte ai rumët para se ata të sulmonin. Kjo ka ndodhur në një vit thatësire të madhe. Megjithëkëtë, i

Dërguari [a.s.] mbledhi shokët e tij, u bëri thirrje të pasurve që të tregonin bamirësinë e tyre e të shpenzonin për luftën në rrugën e Allahut me para, me armë, me deve e me të tjera gjëra. I Dërguari [a.s.] e nisi marshimin në drejtim të rumëve në vitin e nëntë të Hixhretit, d.m.th. afërsisht nëntë muaj para se të ndërronte jetë. Në Medinë i Dërguari [a.s.] la me detyrën e prefektit Imam Aliun [r.a.]. Kjo luftë është quajtur “Lufta e Vështirësisë”. Kur myslimanët arritën në luginën e Tebùkut, ushtria e rumëve nuk erdhi që të luftonte me myslimanët, por erdhën disa nga krerët e krishterë, me të cilët i Dërguari [a.s.] lidhi paqe dhe u kthye fitimtar në Medinë.

Diskutim

1 - a) Përse Lufta e Tebùkut u quajt “Lufta e Vështirësisë”?

b) Përkuptim ka fjala e të Dërguarit të Allahut që i tha Ali bin Ebij Tàlibit [r.a.]: *«Ti tek unë je në pozitën që ishte Hàrùn te Mùsai, por pas meje nuk ka më profet.»*? Shpjegojeni këtë fjalë shkurtimisht.

2 - Ndodhi një mrekulli e të Dërguarit [a.s.] gjatë marshimit të tij për në Tebùk. Flisni për këtë mrekulli profetike.

3 - a) Ku gjendej shteti i rumëve?

b) Cilat janë rezultatet e kësaj lufte? Flisni shkurt për to!

NDODHIA E MUBÀHELES⁽¹⁾

Allahu e bëri realitet fitoren e Profetit të T'ij mbi kurejshët me çlirimin e Mek'kës. Më pas Profeti [a.s.] arriti fitore edhe në Betejën e Hunejnit kundër idhujtarëve të Tàifit. Pas kësaj beteje njerëzit filluan të hynin në Islam në grupe: delegacionet e fiseve arabe filluan të vinin tek i Dërguari i Allahut dhe të shpallnin hyrjen e tyre në Islam. Pas këtyre ngjarjeve, i Dërguari i Allahut u shkroi mesazhe e letra mbretërve e kryetarëve të shteteve, me të cilat u bënte thirrje të hynin në Islam. Ndër ata, të cilëve i Dërguari u shkroi dhe të cilët i ftoi të hynin në Islam, ishin edhe banorët e Nexhranit në Jemen. Ata ishin të krishterë. Ata dërguan te Profeti [a.s.] një delegacion të përbërë nga krerët e tyre, me qëllim që të dialogonin me Profetin [a.s.] dhe të mbronin besimin e tyre të revizionuar për Mesijhun [a.s.]; ata besonin që Mesijhu [a.s.] është bir i Allahut. Kur erdhën në Medine dhe u ulën të bisedonin me të Dërguarin e Allahut, filluan të polemizonin me të dhe të mbronin idhujtarinë e tyre dhe fenë e tyre të devijuar. Allahu i lartësuar i zbriti Profetit të T'ij disa ajete, me të cilat hidhte poshtë mëtimet e tyre të gabuara dhe i ftonte ata t'i nënshtroheshin mubàheles (bèsë). Ja dhe ajeti i nderuar: **«Kush të kundërshton ty në lidhje me atë (Ijsà'në), kur ty të është bërë e ditur e vërteta, ti thuaj: Ejani të thërresim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, ne dhe ju, pastaj me çiltërsi të lutemi për mallkim dhe mallkimi i Allahut qoftë mbi gënjeshtarët!»** (*“li Imràn”, 61*). Pas zbritjes së këtij ajeti, i Dërguari i Allahut u tha krerëve të krishterë: *«Nëse ju nuk besoni e nuk më vërtetoni mua, atëherë ejani të kërkojmë mubàhelen»*

(1) Mubàhele: kur dy palë kundërshtare kërkojnë mallkimin e zbritjen e dënimit për atë që është në të gabuarën. (ballafaqimin me bënë para Allahut) dhe mallkimi i Allahut qoftë mbi gënjeshtarin! Do të rrimë e të presim që të shohim se mbi atë që do të bjerë dënimi e ndëshkimi i Allahut, është në rrugë të gabuar.» Ata i thanë Profetit [a.s.]: «Nesër do të bëjmë mubàhelen me ty.» Pastaj filluan të flisnin kokë më kokë me njëri-tjetrin. Ndërkaq, njëri ndër krerët e tyre tha: “Nëse Muham'medi nesër do të bëjë mubàhelen me ju, me fëmijët e me familjen e tij, kijeni frikë mubàhelen e tij; por nëse ai bën mubàhelen me ju, me shokët e me pasuesit e tij, atëherë bëjeni!” I Dërguari [a.s.] doli në luginën ku kishin lënë fjalë. Për dore mbante Hasanin e Hysenin, prapa vinte vajza e tij, Fatimja, kurse përpara tij printe Ali bin Ebi Tàlibi. Kur të krishterët i panë ata, njëri prej krerëve të tyre, Ebù Hàrithe, foli: «Cilët janë ata

që e shoqërojnë atë?» I thanë: «سَـهْتَهُ دِجَالِي وَخَخَاهِي تَهْ تِيْجْ وَهَـبُرِّي وَهَـبَزَّيْ سَهْ تِيْجْ؛ اَتَا تَهْ دِيْجْ قَهْ كَا پَهْرَ دَوْرَهْ جَانَهْ دِيْجْ دِجْمَتَهْ وَهَـبَزَّيْ سَهْ تِيْجْ، كُورْسَهْ اَجَوْ عَـسْهْتَهْ وَهَـبَزَا وَهَـبَزَّيْ تِيْجْ.

Këta që shihni janë njerëzit e tij më të dashur e më të afërm në zemrën e tij.” I Dërguari i Allahut bëri përpara dhe u ul në gjunjë. Ebù Hàrithe që po e ndiqte me vëmendje tha: «Për Allah, u ul në gjunjë ashtu siç janë ulur edhe profetët kur kanë kërkuar mubàhele.» Prandaj ai u tërhoq nga mubàheleja dhe u foli shokëve të vet: «Në të vërtetë, po shikoj një burrë të guximshëm që kërkon mubàhelen dhe kam frikë se ai është në të vërtetën dhe betohem në Allahun, nuk do të kalojë asnjë vit kur në të gjithë botën të mos ketë as edhe një të krishterë të vetëm që të pijë ujë.» Ata kërkuar ndjesë për mubàhelen. I kërkuar paqe të Dërguarit të Allahut. Porfeti [a.s.] u dha atyre paqe, por kundrejt kësaj, detyroheshin t’u jepnin myslimanëve një kontribut të përvitshëm e të caktuar në parà e në rroba. I Dërguari [a.s.] u dha paqe atyre me qëllim që të përgatiste kushtet për përhapjen e Islamit e njëkohësisht që t’i pengonte që të mos e luftonin Islamin. Kjo ndodhi ua bëri të qartë mohuesve vërtetësinë e profetnisë së tij, si dhe mbështetjen e përkrahjen që do të gjente lutja e tij⁽²⁾.

(2) Et’Tabresij në “I’lâmul Uerâ”, f.136; Ibn Es’Sab’bâg në, “El Fudûlul-muhim’me”, f.23.

I Dërguari [a.s.] dërgon Ali bin Ebi Tàlibin në Jemen

Pas kësaj ngjarjeje, i Dërguari [a.s.] dërgoi në Jemen Ali bin Ebi Tàlibin me detyrë që t’u mësonte atyre Islamin. Kur Ali bin Ebi Tàlibi [r.a.] arriti në Jemen, kishte me vete një letër të Profetit [a.s.] për banorët e Jemenit dhe ai ua këndoi atyre letrën. Kur ata dëgjuan përmbajtjen e letrës, i gjithë fisi Hemdân pranoi Islamin. Aliu [r.a.] i shkroi të Dërguarit [a.s.] dhe e njoftoi për hyrjen në Islam të fisit Hemdân. Kur letra i ra në dorë të Dërguarit të Allahut, pasi e lexoi, bëri sexhde dhe falënderoi Allahun e lartësuar. Më përpara i Dërguari i Allahut kishte dërguar Halid bin Uelidin te banorët e Jemenit që t’u bënte atyre thirrje të pranoheshin Islamin, por ata nuk i qenë përgjigjur thirrjes së tij.⁽¹⁾

Përmbledhje

Pasi muslimanët arritën fitore mbi armiqtë e tyre dhe çliruan Mek’kën e Tàifin, fiset arabe filluan të dërgonin delegacionet e tyre tek i Dërguari [a.s.] që të shpallnin para tij hyrjen në Islam. Edhe i Dërguari [a.s.] filloi t’u shkruante mbretërve e krerëve që t’u bënte atyre thirrje të pranoheshin Islamin.

Ndër delegacionet e ardhura, ishte edhe një i të krishterëve të Nexhranit në Jemen. Ata kërkuar të dialogonin me të dërguarin [a.s.], pasi ata besonin se

Mesijhu [a.s.] është bir i Allahut. Allahu i lartësuar e urdhëroi Profetin e tij që të bënte me ata mubàhele dhe për këtë u caktua dita e nesërme. I Dërguari [a.s.] doli së bashku me të bijën, dy djemtë e saj me të shoqin e vajzës së vet që të bënin mubahelen. Kur dijetarët e krishterë dhe krerët e tyre panë se ai kishte ardhur me njerëzit më të afërm, u frikësuan nga mubàheleja se mos mbi ata do të binte ndëshkimi, prandaj ata u tërhoqën dhe lidhën paqe me të Dërguarin [a.s.].

(1) Et'Tabresij në "I'làmul Uerà", f. 137; Ibn Ethijri në "Tàriikh", vëll. 2, f. 300.

Diskutim

1 - A bënë të krishterët mubàhele me të Dërguarin [a.s.]?

2 - a) A ua tregon mubàheleja jomyslimanëve vërtetësinë e profetnisë së të Dërguarit [a.s.]? Përse?

b) Pas mubàheles i Dërguari i Allahut dërgoi në Jemen Ali bin Ebi Tàlibin [r.a.] që t'u bënte thirrje banorëve të Jemenit që të hynin në Islam. A pati sukses Imam Aliu [r.a.] në detyrën e ngarkuar?

Shpjegojeni!.....

.....

HAXH'XHI I LAMTUMIR ﷺ

Në vitin e dhjetë të Hixhretit i Dërguari i Allahut vendosi të kryente detyrën e shenjtë të Haxh'xhit dhe për këtë ai njoftoi shokët e vet. Ai u bëri thirrje që edhe ata të shkonin të kryenin Haxh'xh së bashku me të. Njerëzit u përgatitën për Haxh'xh. U mbledhën disa dhjetëra mijëra veta, që do të niseshin së bashku me Profetin [a.s.]. Ata e lanë Medinen më njëzet e pesë të muajit Dhul Ka'deh të atij viti dhe u nisën për Haxh'xh. Profeti [a.s.] kishte marrë me vete edhe bagëti që të bënte kurban në Haxh'xh. Vazhduan udhëtimin derisa arritën në vendin e quajtur Dhàtil Halijfeh, shtatë kilometra larg Medines se ndritur. Këtu, i Dërguari i Allahut dhe ata që ishin me të veshën rrobën e Haxh'xhit (ihràmin) dhe pastaj u nisën për në Mek'kë.⁽¹⁾ U tha më parë se edhe Ali bin Ebi Tàlibi së bashku me ushtrinë që komandonte, kishin lënë Jemenin dhe ishin drejtuar për në Mek'kë, me qëllim që edhe ata të kryenin detyrën e Haxh'xhit. Imam Aliun [r.a.] e kishte dërguar në Jemen i Dërguari i Allahut që të ftonte banorët e Jemenit në Islam, t'u mësonte atyre rregullat e ligjet e fesë, të gjykonte çështjet që ata mund të kishin në mes tyre dhe të ishte tek ata përfaqësues i të Dërguarit të Allahut.

Kur i Dërguari i Allahut me njerëzit që e shoqëronin po i afrohej Mek'kës, asaj i ishte afruar edhe Ali bin Ebi Tàlibi [r.a.]. Aliu u takua me të Dërguarin e Allahut, kurse ushtria vazhdoi marshimin. I Dërguari [a.s.] u gëzua shumë për këtë takim⁽²⁾ dhe urdhëroi të vazhdonin udhëtimin për në Mek'kë. Pas takimit me të Dërguarin e Allahut, Imam Aliu [r.a.] u kthye tek ushtria e tij, por pa se ata

(1) El Ja'kùbij, "Tàriikhul Ja'kùbij", vol. 2, f. 109.

(2) "Historia" e Ibn Ethijrit, vëll. 2, f. 302; "Historia" e El Ja'kùbijit, vëll. 2, f. 109; "Plàmul Uerà" f. 137.

kishin veshur ihramet, që ai i kishte sjellë për t'ia dorëzuar të Dërguarit të Allahut për t'ua shpërndarë myslimanëve në mënyrë të barabartë. Aliu [r.a.] u ndie ligsht për këtë veprim që ata kishin bërë. E pyeti njeriun që pati lënë zëvendës të tij në ushtri se përse burrat i kishin veshur ato rroba pa lejën e të Dërguarit të Allahut. Zëvendësi i tha se i kishin marrë hua prej tij që tëhynin në ihram, madje edhe që të zbukuroheshin. Aliu [r.a.] i tha atij: "Ke vepruar shumë

keq, shumë keq kanë vepruar edhe ata”; dhe Aliu [r.a.] urdhëroi që ata t’i hiqnin rrobat. Në urdhërat e tij qe shumë i ashpër.

Kur njerëzit dëgjuan për urdhrin e Aliut [r.a.] që t’i zhvishnin ihramet dhe t’i kthenin aty ku e kishin vendin, ngaqë të gjitha rrobat do të viheshin në Shtëpinë e Pasurisë së muslimanëve (Bejtu’l Mal), u ndien të fyer dhe filluan të ankoheshin për Aliun [r.a.] në mes njëri-tjetrit. Kur i Dërguari i Allahut i mori vesh fjalët e tyre, i erdhi shumë keq dhe urdhëroi një njeri që t’u thoshte njerëzve me zë të lartë: *“Mbajini gjuhët kur të ankoheni për Aliun [r.a.], sepse ai nuk bën lëshime në të drejtën e Allahut!”*⁽³⁾

I Dërguari i Allahut ka hyrë në Mek’kë ditën nga një zonë që quhet Kudà, hipur mbi devenë e tij. Shtetë nisur për në në Qabe. Kur ka parë Qaben, ka ngritur të dyja duart mbi frerin e deveve dhe ashtu, hipur mbi devenë, ka filluar Tauafin para kohës së faljes së namazit të drekës.

I Dërguari [a.s.] u mban këshillë njerëzve

Në këtë Haxh’xh, i Dërguari i Allahut ka bërë disa biseda me njerëzit që t’u shpjegonte muslimanëve shartet e fesë. Ai ka mbajtur bisedë ditën e shtatë të muajit Dhul Hixh’xhe. Një bisedë tjetër e ka mbajtur në Arafat ditën e nëntë. Ka mbajtur një bisedë edhe në Minà. Në këtë bisedë ai ka thënë: *«Allahu ia freskoftë fytyrën atij njeriu që e dëgjon dhe e kupton bisedën time, që e ruan*

(3) “Es’Sijretu-n’Nebeuij’jeh” e Ibn Hishàmit, vëll. 4, f. 29; “T’lâmul Uerà”, f. 137.

atë në mendje dhe pastaj ua kumton atyre që nuk e kanë dëgjuar! Mbase, ai që mbahet për dijetar në çështjet e fesë, nuk është i tillë; mbase një i ditur në çështjet e fesë i mëson fenë një më të dituri se ai vetë; por tre gjëra nuk mund ta mashtrojnë kurrë zemrën e një muslimani: puna e kryer vetëm për hir të Allahut, këshilla për drejtuesit që janë në të drejtën dhe angazhimi me bashkësinë e besimtarëve; nëse ti i thërret ata, ata do të vijnë nga prapa.»⁽¹⁾Në Minà, i Dërguari i Allahut preu nga kurbanet që ishin më shumë se gjashtëdhjetë deve. Pastaj ai urdhëroi Imam Aliun [r.a.] që të priste të tjerat. Prej çdo deveje mori nga një copë mishi dhe i gatoi me ujë e kripë. Hëngrën të gjithë nga kjo gjellë dhe pinë nga supa që përgatitën me mishin e deveve. Pastaj, i Dërguari [a.s.], gjithnjë hipur mbi devenë, bëri edhe gjuajtjen e gurëve.⁽²⁾Pastaj i Dërguari [a.s.] u kthye në Mek’kë, ndaloi te pusi “Zemzem” dhe aty, para njerëzve mbajti një fjalim të rëndësishëm, që u quajt “Fjalimi i Lamtumirës”. Në këtë fjalim, ai shpjegoi parimet e vlerat më të rëndësishme të Islamit dhe vazhdoi t’i këshillonte njerëzit. Në përfundim të fjalimit tha: *«Mbase nuk do të më takoni më kështu siç jam...»*.

Pasi mbaroi të gjitha veprimet e Haxh'xhit, i Dërguari [a.s.] u larguan nga Mek'ka. Ka qenë data tetëmbëdhjetë e muajit Dhul Hixh'xhe kur kanë arritur në vendin e quajtur Gadijr Khum. Këtu Profeti [a.s.] i urdhëroi haxhinjtë të ndalonin. Ishte verë dhe vapa, shumë e nxehtë. Të gjithë haxhinjtë janë grumbulluar dhe i Dërguari [a.s.] u ngjit mbi një minber (podium) të improvizuar dhe mbajti një fjalim të rëndësishëm.

Përmbledhje

Në vitin e dhjetë të Hixhretit i Dërguari i Allahut ka kryer detyrën e Haxh'xhit dhe është Haxh'xhi i vetëm që ai ka kryer gjatë gjithë kohës që ka jetuar në Medine.

(1) “Historia” e Ja'kùbijit, vëll. 2, f. 109.

(2) Burimi i sipërm.

Në atë Haxh'xh Profetin [a.s.] e kanë shoqëruar disa dhjetëra mijëra veta prej shokëve të tij. I Dërguari [a.s.] e ka veshur ihramin në “Xhaminë e Pemës”, që gjendet jashtë Medines, në zonën e quajtur Dhàtil Halijfeh dhe pas disa ditësh ka mbërritur në Mek'kë. Në Mek'kë, ai ka hyrë ditën nga ana e një zone, që quhet Kudà, pastaj ka bërë Tauafin rreth Qabes para kohës së namazit të drekës së asaj dite. Tauafin e ka bërë hipur mbi devenë e tij.

Gjatë Haxh'xhit i Dërguari ka mbajtur fjalime dhe ka dhënë shumë porosi, ndër to, porosia për t'u mbajtur me librin e Allahut e me Sun'netin e tij. Ky Haxh është quajtur “Haxh'xhi i Lamtumirës”, sepse që Haxh'xhi i fundit, në të cilin i Dërguari i Allahut u përshëndet me shokët e tij. Ai ndërroi jetë afërsisht tre muaj pas këtij Haxh'xhi.

Diskutim

1 – Në ç'vit e kreu Haxh'xhin i Dërguari i Allahut? Përse ky Haxh'xh është quajtur “Haxh'xhi i Lamtumirës”?

2 – Si ka bërë i Dërguari [a.s.] Tauafin rreth Qabes së nderuar?

3 – Gjatë Haxh'xhit i Dërguari i Allahut ka mbajtur disa fjalime, me qëllim që t'i mësonte e t'i edukonte myslimanët. A do të thotë kjo se periudha e Haxh'xhit duhet të jetë një kongres islam për ndërgjegjësimin e myslimnaëve, për orientimin e tyre dhe këshillime me njëri-tjetrin?

GRAT^۱ E PROFETIT [a.s.](¹)

Para Islamit, gruaja nuk gëzonte asnjë të drejtë dhe nuk respektohej. Ashtu si popujt e tjerë, edhe arabët i përçmonin gratë dhe i konsideronin ato si plaçkë a pronësi e burrit, madje, ata e trashëgonin gruan, ashtu siç trashëgonin orenditë, kafshët, shtëpitë, tokat etj; kishte prej arabëve që vajzat e veta i varrosnin të gjalla. Kur erdhi Islami, i dha gruas të drejtat e saj, pasi Islami i kushtoi përparësi ndër njerëzit besimit e devotshmërisë. I Larti thotë: **«...më i nderuari prej jush është ai që është më i devotshëm...»** (*“El Huxhuràt”, 13*).

Kur’ani famëlartë i urdhëron burrat që të nderojnë gratë dhe në mes tyre të ketë dashuri e respekt: **«...çoni jetë të mirë me ato...!»** (*En Nisà”, 19*). Dhe: **«Nga argumentet e Tij është se për të mirën tuaj nga vetë lloji juaj, Ai krijoi grate, që ju të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush Ai futi dashuri e mëshirë...»** (*“Err’Rrùm”, 21*). Kur ka porositur i Dërguari i Allahut për grate, ka thënë: *«Më i miri juaj është ai që është i mirë me familjen e vet dhe unë jam më i miri juaj se jam më i miri me familjen time.»* Kurse në Haxh’xhin e Lamtumirës, gjatë fjalimit që mbajti para njerëzve në lidhje me atë, tha: *«O njerëz, këshillohuni me gratë se është më mirë!»*(²) I Dërguari i Allahut ishte shembulli më i përkryer për mirëtrajtimin e bamirësinë ndaj grave të veta.

I Dërguari i Allahut është martuar me njëmbëdhjetë gra, të cilat kanë bashkëjetuar me të me periudha kohore të ndryshme. Ai ka vënë kurorë me dy gra të tjera, me të cilat nuk ka

(1) Ibn Hishàmi, “Es’Sijretu-n’Nebeuij’jeh”, vëll. 4, f. 293.

(2) Ibn Ethijri, “El Kàmil fit’Tàrijkh”, vëll. 2, “Haxh’xhi i Lamtumirës”. bashkëjetuar dhe i ka divorcuar. Ja edhe emrat e grave të Profetit [a.s.]:

1 - Hadixhe bint Huvejlid. ۱shtë gruaja e parë dhe më e madhja e më e dashura për të. Hadixhja ka vdekur para të Dërguarit të Allahut në Mek’kë. Profeti [a.s.] është martuar me Hadixhen para se të ngarkohej me detyrën e

profetnisë. Hadixhja është nëna e të gjithë fëmijëve të Profetit [a.s.], përveç Ibràhimit, nëna e të cilit është koptja Marie (Màrijetul-Kibtij'jeh).

2 - 'ishe bint Ebù Bekr. Ka vënë kurorë me të në Mek'kë dhe është martuar në Medine pas migrimit të tij.

3 - Seude bint Zem'ah bin Kajs.

4 - Zejneb bint Xhahsh.

5 - Um'm Selemeh; ajo quhej Hind bint Ebi Umej'je El Mahzù mij'jeh.

6 - Hafsa bint 'Umer bin El Khat'tab.

7 - Um'm Habijbeh; ajo quhej Remleh bint Ebù Sufjan.

8 - Xhuvejrij'je bint Hàrith El Khuzàij'jeh.

9 - Safij'je bint Haj'j bin Akhtab El Khajberij'jeh.

10- Mejmùneh bint El Hàrith.

11- Zejneb bint Khuzejmeh; ajo është thirrur me epitelin “nëna e të mjeruarve”, për mëshirën e dashamirësinë e saj ndaj të varfërve e të mjeruarve.

Dy grate, me të cilat i Dërguari ka vënë kurorë por pastaj është divorcuar pa bashkëjetuar me ato janë:

1 - Esmà bint Nu'màn El Kindij'jeh.

2 - 'Amreh bint Jezijd El Kilàbijeh.

Martesa e të Dërguarit të Allahut me gratë ka pasur qëllime politike, shoqërore dhe kulturore. Në saje të martesave, Profeti [a.s.] lidhi marrëdhënie të qëndrueshme me fiset arabe; veç kësaj ai i mësonte gratë e veta dhe ato nga ana tjetër u mësonin grave të muslimanëve çështjet e fesë.

VDEKJA E TË DËRGUARIT [a.s.]

Më sipër mësuam se në fjalimin e tij në “Haxh'xhin e Lamtumurës”, i Dërguari [a.s.] dha shenja për shokët e tij se ata mbase nuk do të takoheshin më me të pas atij viti. Dhe vërtet, vetëm pak kohë pas kthimit prej “Haxh'xhit të Lamtumurës”, Profeti [a.s.] filloi të ankohej se ishte sëmure dhe shëndeti erdhi duke i rënë. Kur e ndjeu se me të vërtetë ishte sëmure, një natë doli dhe shkoi në varrezën Bakij'ë, ku varroseshin muslimanët, pranë “Xhamisë së Profetit”. Ai shkoi aty me qëllim që t'i kërkonte Allahut faljen e mëkateve për ta. Kur Profeti [a.s.] u ndal në varrezën Bakij'ë, duke iu drejtuar varreve u foli atyre: *«Page e shpëtim për ju, o banorë të varreve! Urime për ju për atë që jeni bërë, ashtu siç do të bëhen të gjithë njerëzit në varre! Ngatërresat erdhën ashtu siç vijnë shkëndijat në natë të errët, e fundit ndjek të parën, por e fundit është më e keqe se e përparshmja.»*⁽¹⁾ Pas pesë ditësh,

nga minberi i tij, Profeti [a.s.] mbajti një fjalim. Duke iu drejtuar njerëzve, tha: «O njerëz, asnjë të mos mëtojë e asnjë të mos shpresojë! Betohem në Atë që më ka dërguar me të Vërtetën, nuk shpëton asgjë përveç punës së shoqëruar me mëshirën e Allahut. Sikur unë të kisha kundërshtuar, do të isha rrëzuar kokëposhtë. O Zoti im, unë e bëra kumtimin.»⁽²⁾ Këtë fjalë e përsëriti tri here. Pastaj zbriti nga minberi dhe shkoi e hyri në shtëpinë e tij.

Sëmundja po i rëndohej të Dërguarit të Allahut dhe ai ndërroi jetë ditën e dymbëdhjetë të muajit Rebij'ul-Eu'uel. Trupin e tij të bekuar e ka larë Imam Aliu [r.a.] dhe ujë për të larë xhenazen i ka _____

(1) Ibn Hishami, “Es’Sijretu-n’Nebeuij’jeh”, vëll. 4, f. 293.

(2) Et’Tabresij, “I’lâmul Uerâ bia’lâmil-hudâ”, f. 141.

shtënë djali i Ab’bâsit, Fadli. Vetë Imam Aliu [r.a.] e ka qefinosur dhe pastaj u ka bërë zë njerëzve që të falnin namazin e Xhenazes së Profetit [a.s.].

Myslimanët e kanë faluar namazin e Xhenazes së Profetit në grupe nga dhjetë veta dhe pa imam. Ata e kanë faluar namazin e Xhenazes së tij ditën e hënë. Falja në grupe ka vazhduar natën e së martës deri në mëngjes dhe ditën e martë, derisa e kanë falur të gjithë, i madh e i vogël, femra e meshkuj. E kanë falur edhe banorët e rrethinave të Medines. Pastaj Imam Aliu [r.a.], me ndihmën e disa sahabëve, e ka varrosur të Dërguarin e Allahut në dhomën e tij, aty ku është edhe sot varri i tij i ndritur; pra, i Dërguari [a.s.] është varrosur në atë dhomë ku ka dhënë shpirt, pranë xhamisë së tij të bekuar. Varri i ndritur i Profetit [a.s.] vizitohet nga pjesa më e madhe e atyre që kryejnë Haxh’xhin, si dhe nga vizitorë të tjerë, të cilët me lejën e Allahut kërkojnë ndërmjetësimin e tij.